

Republika e Maqedonisë  
Avokati i Popullit

**RAPORTI**  
**VJETOR** *2005*

## **Përmbajtja:**

• <b>Çka e shënoi punën e Avokatit të Popullit gjatë vitit 2005</b>	<b>2</b>
• <b>Marrëdhëniet me publikun dhe bashkëpunimi ndërkombëtar</b>	<b>5</b>
• <b>Viti i pasqyruar me shifra</b>	<b>9</b>
- Tregues të përgjithshëm	10
- Parashtrësia sipas fushave	11
- Hulumtimi sipas parashtrësive	16
- Cenime të konstatuara dhe zvogëlimi i padrejtësive	18
- Qytetarët dhe Avokati i Popullit	20
• <b>Në shërbim të qytetarëve</b>	<b>22</b>
- Përfaqësimi i drejtë dhe adekuat	22
- Mosdiskriminimi	28
- Procedimi policor dhe punë të tjera të rendit	30
- Jurisprudenca	32
- Institucionet ndëshkimore – përmirësuese dhe entet përmirësuese – edukuese	33
- Marrëdhëniet pronësore – juridike	35
- Urbanizëm dhe ndërtimtari	39
- Mjedisi	40
- Marrëdhëniet e punës	42
- Çështjet strehimore	45
- Sigurimi dhe mbrojtja sociale	48
- Sigurimi pensional dhe invalidor	50
- Sigurimi dhe mbrojtja shëndetësore	52
- Të drejtat e fëmijës	54
- Arsimi	59
- Të drejtat e konsumatorëve	61
- Financat	63
- Fusha të tjera	64
• <b>Çka konstatuam dhe çka duhet bërë</b>	<b>65</b>
- Konstatuam	65
- Çka duhet bërë	67
• <b>Avokati i Popullit në vitin 2006</b>	<b>69</b>
• <b>Avokati i Popullit në praktikë</b>	<b>70</b>
• <b>Në Institucion</b>	<b>77</b>

# Çka e shënoi punën e Avokatit të Popullit gjatë vitit 2005

## ■ Metodatat dhe mënyrat e reja të punës së Institucionit

- Vetiniçiativa
- Përcjellja e gjendjeve
- Inspektimi i drejtpërdrejt

Vëmendja ishte përqendruar drejt:

- *Informimit të qytetarëve për kompetencat dhe mundësitë që i ofron Institucioni në drejtim të realizimit të të drejtave të tyre;*
- *Vetiniçiativës, si parim i punës përmes hulumtimit të drejtpërdrejt të gjendjeve nëpër fusha përkatëse;*
- *Marrjes së masave dhe aktiviteteve për analizimin dhe verifikimin e gjendjeve lidhur me parimin e mosdiskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë dhe proporcional;*
- *Shfrytëzimit të instrumentit ekspozim në kritikë publike dhe në funksion të kësaj bashkëpunimit më të afërt me mjetet e informimit publik.*

E gjithë kjo bazohet mbi moton:

Ndihmojmë qytetarët që në mënyrë më të lehtë t'i realizojnë të drejtat dhe liritë e tyre, administrata publike mirëfilli t'u shërbejë atyre, si dhe të avancohet raporti ndërmjet organeve të pushtetit dhe qytetarëve.

Dhe parimet:

Publikisht, me nder dhe profesionalizëm i përcjellim dhe mbikëqyrim veprimet e organeve të pushtetit.

Të njëjtë në relacion me të gjithë.

Profesionistë në punë, të hapur për sugjerime dhe të gatshëm për përsosje të vazhdueshme.

## ■ Shpallja publike e tre emrave të gjyqtarëve

Avokati i Popullit publikisht përmendi emrat e tre gjyqtarëve, ndaj të cilëve kërkoi që Këshilli Gjyqësor Republikan të hap procedurë për verifikimin e përgjegjësive për shkak të punës së tyre joprofesioniste e të pandërgjegjshme dhe mungesës së sjelljes etike.

Rezultati: Këshilli Gjyqësor Republikan hapi procedurë për vlerësimin e profesionalizmit të njërit nga gjyqtarët dhe kjo rezultoi që Kuvendi i Republikës së Maqedonisë ta miratojë propozimin e tij duke e shkarkuar gjyqtarin. Për dy gjyqtarët e tjerë, paraprakisht qe hapur procedura për verifikimin e profesionalizmit dhe ndërgjegjshmërisë gjatë ushtrimit të funksionit të gjyqtarit.



## ■ **Sektori për kontroll të brendshëm dhe standarde profesionale, nuk vepron sipas kërkesave të Avokatit të Popullit**

Mbi bazë të procedurave të zbatuara, Avokati i Popullit konstaton cenime të të drejtave dhe lirive të qytetarëve me privime të paligjshme nga liria, mundim dhe veprime të tjera të vrazhda e jonjerëzore dhe keqtrajtime gjatë kryerjes së autorizimeve zyrtare nga ana e pjesëtarëve të Ministrisë për Punë të Brendshme, dhe për këtë qëllim publikisht i bëri thirrje ministrit për Punë të Brendshme që t'i ndërmerr ta gjitha masat që janë në kompetencë të tij me qëllim të shmangies së dukurive të këtilla.

Njëkohësisht, Avokati i Popullit e njoftoi publikun se ai pengohet në ushtrimin e detyrës sepse Sektori për kontroll të brendshëm dhe standarde profesionale nuk ia dërgon informatat e nevojshme, të cilat i nevojiten për zbatimin e tërësishëm të hetimit.

Sektori për kontroll të brendshëm dhe standarde profesionale edhe më tej vazhdon të pengojë punën e Avokatit të Popullit, duke mos ia dërguar të dhënat dhe informatat që i kërkohen.



## ■ **Gjatë zgjedhjeve lokale u hoqën bilbordet me fotografi të fëmijëve**

Avokati i Popullit i drejtoi kritikë publike kryetarit të Qytetit të Shkupit sepse kishte rënë në dijeni se në Shkup kandidatët e mundshëm për kryetar të Shkupit, kishin vënë bilborde me fotografi të fëmijëve, e që është abuzim i fëmijëve për qëllime politike.

## ■ **Avokati i Popullit kundër mënyrës së arkëtimit të faturave të NP “Ujësjiellësi dhe kanalizimi”**

Avokati i Popullit e njoftoi publikun se drejtori i NP “Ujësjiellësi dhe kanalizimi”, aplikon metoda të jashtëligjshme për t'i arkëtuar kërkesat për shërbimet e kryera, duke kërkuar nga institucione të caktuara që qytetarëve, të cilët nuk e kanë përmbushur detyrimin ndaj tyre, të mos u lëshohen dokumente.

**Rezultati:** NP “Ujësjiellësi dhe kanalizimi” i tërhoqi shkresat, me të cilat nga institucionet kërkohesh që qytetarëve mos u lëshoheshin dokumente, nëse paraprakisht nuk i kishin shlyer faturat e ujit.

## ■ **Përkohësisht pezullohet shembja e barakave sociale në rrugën “Leningradska” në Gostivar**

Avokati i Popullit kërkoi, nga autoritetet lokale të Gostivarit, që përkohësisht ta pezullonin shembjen e filluar të barakave sociale.

Kryetari i Komunës së Gostivarit mbështeti kërkesën e Avokatit të Popullit.

## ■ Anulohen 75 vendime për pushim nga marrëdhënia e punës

Pasi konstatoi se në Ministrinë për Transport dhe Ndërlidhje ishin marrë aktvendimet për pushim nga marrëdhënia e punës, ngaqë një numër i madh i kryetarëve të komunave nuk i kishin nënshkruar kontratat për transferim të nëpunësve shtetërorë nëpër komuna, me çka të drejtat e tyre nga marrëdhënia e punës ishin cenuar, Avokati i Popullit paraqiti Sugjerim pranë Agjencisë për Nëpunës Shtetërorë. Pastaj, Agjencia veproi sipas Sugjerimit dhe mori në konsideratë ankesat e të gjithë punonjësve, ndërsa aktvendimet individuale për pushim nga marrëdhënia e punës i anuloi.

## ■ Avokati i Popullit zgjidhet anëtar i Sekretariatit të ANOF-it

Në Kongresin e IV të Asociacionit Ndërkombëtar të Ombudsmanëve të Vendeve Frankofone në Paris, Avokati i Popullit i Republikës së Maqedonisë, z. Ixhet Memeti njëzëri zgjidhet anëtar i Sekretariatit të Asociacionit të Ombudsmanëve të Vendeve Frankofone.

## ■ Z. Ervan Fuere në Zyrën e Avokatit të Popullit

Avokati i Popullit u takua me përfaqësuesin e ri special të Bashkimit Evropian, ambasadorin z. Ervan Fuere.

Në këtë takim, vlerësim i përbashkët ishte se Institucioni Avokati i Popullit është faktor i rëndësishëm për zhvillimin e Republikës së Maqedonisë, sidomos në procesin për fitimin e statusit, anëtare me të drejtë të plotë e Bashkimit Evropian.

## ■ “Drejtësia megjithatë është e arritshme”

Me këto fjalë një qytetare nga Shkupi iu falënderua Avokatit të Popullit, pasi që pas tre vjetësh sorollatjeje nëpër institucionet shtetërore, me ndërhyrje të Avokatit të Popullit e realizoi të drejtën e vet për banesë vetjake.

## ■ Ngjarje e vitit 2005: Ombudsmani I. Memeti më “i kthjellët”

Barometri i korrupsionit – anketë në të cilën janë përfshirë 19 kryeredaktorë të mediave nacionale, të cilën e ka realizuar “Makfaksi” dhe “Transparencë – Maqedoni”, rezultoi se procedura e Ombudsmanit, përkatësisht publikimi i tre emrave të gjyqtarëve, të cilët kanë punuar në mënyrë joprofesionale dhe të pandërgjegjshme, gjatë vitit 2005 bindshëm është ngjarja më “e kthjellët” në luftën kundër korrupsionit.



# Marrëdhëniet me publikun dhe bashkëpunimi ndërkombëtar

Detyrat e përcaktuara programore për vitin raportues dhe kursi i orientuar kah transparencja dhe hapja më të madhe e Institucionit, me qëllim të të qenit sa më pranë qytetarëve, imponuan qëndrim të ndryshëm dhe krejtësisht të ri të veprimit.

Përkatësisht, edhe përkundër konstatimit të përgjithshëm se Institucioni ka hedhur themele solide për funksionim efektiv, vërehej pozicionimi i tij joadekuat në sistem, në të vërtetë në publik, për sa i përket rëndësisë thelbësore të tij si mekanizëm kontrollues, i domosdoshëm për funksionimin e parimit të sundimit të drejtësisë dhe shtetit ligjor.

Vendosja e një qasjeje më ndryshe, duke shpалosur anët negative të punës së administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore, para së gjithash varej nga hulumtimi studimor i lëndëve dhe inspektimi direkt në punën e organeve, organizatave dhe gjykatave me qëllim të pasqyrimin të qartë dhe objektiv të gjendjeve.

Instrumenti “kritikë publike” shfrytëzohet si presion plotësues me një qëllim të vetëm për t’i shmangur veprimet negative të punës së organeve shtetërore, të cilat janë pengesë për realizimin me kohë dhe me konsekuencë të të drejtave të qytetarëve.



Avokati i Popullit, hapin e këtillë e mori pasi bëri një sërë hulumtimesh të zbatuara mbi procedurat gjyqësore të qytetarëve, të cilët kishin vërejtje se për shkaqe subjektive zvarriteshin procedurat. Gjendja e këtillë u shpалosë në publikë dhe pastaj u ndërmorën masa konkrete nga ana e Këshillit Republikan Gjyqësor.

Aplikimi i instrumentit “kritikë publike” ia arriti qëllimit tërësisht sepse rezultoi me rritjen e besimit të qytetarëve ndaj Institucionit, e që qartë vërehet nga rritja e menjëhershme e numrit të parashtrësive dhe njëkohësisht ndikoi edhe mbi azhurnitetin e organeve gjyqësore gjatë procedimit sipas kërkesave të Avokatit të Popullit. Tendenca e këtillë vazhdoi edhe gjatë gjithë vitit raportues, me përcjellje në vazhdimësi të gjendjeve dhe njoftimin e publikut, që ishte synim i përcaktuar – hapja e plotë e Institucionit me informimin e publikut për të gjitha gjendjet e konstatuara në punën e administratës publike dhe organet e organizatat me autorizime publike.

Nga ana tjetër, kjo kontribuoi edhe për njohjen më të madhe të qytetarëve me Institucionin, për çka flasin edhe të dhënat deri te të cilat erdhi organizata joqeveritare “Kalldërma”, nga hulumtimi i opinionit publik para fillimit të fushatës së mediave (për gjashtë njësitë e reja rajonale të

Avokatit të Popullit), e realizuar me mbështetjen e Misionit të OSBE-së në Republikën e Maqedonisë.

Në të vërtetë, nga hulumtimi i opinionit publik rezultoi se në nivel lokal rreth 80% e qytetarëve kanë pasur njohuri për Institucionin Avokati i Popullit, por përqindja e informimit të nëpunësve shtetërorë ka rezultuar e pakonsiderueshme. Në këtë mënyrë u konfirmua konstatimi i Avokatit të Popullit se nëpunësit shtetërorë për Institucionin kanë informata të pamjaftueshme dhe jo të plota.



Për nevojat e fushatës mediale, në të cilën para së gjithash aktorë kryesorë ishin zëvendësit e sapoemëruar të Avokatit të Popullit, të cilët drejtojnë me zyrat rajonale, nga ana e “Institutit Maqedonas për Media” (MIM) dhe me përkrahjen financiare të Misionit të OSBE-së në Republikën e Maqedonisë, u organizua trajnim për marrëdhënie me publikun.

Në kuadër të fushatës mediale u bë promovimi i zyrave rajonale, e që kontribuoi në drejtim të informimit të qytetarëve për ekzistimin e zyrave të reja

dhe për atë se në to, si shërbim mund t’u ofrohet mbrojtja e të drejtave të tyre.

Me këtë rast u organizuan edhe debate publike, të cilat përveç se nëpër komuna, në të cilat funksionojnë zyrat, fushatë u realizua edhe nëpër komuna të tjera më të mëdha. Debatet publike ishin konceptuar që ta arrijnë edhe segmentin tjetër të domosdoshëm për funksionimin e Institucionit, dhe ky është administrimi në nivel lokal.

Së këtëjmi, përcaktimi kryesor tematik i debateve qenë barrierat gjatë komunikimit ndërmjet Avokatit të Popullit dhe organet e administrimit në nivel lokal, që kontribuoi për zbulimin e problemeve kryesore në këtë plan, si dhe kontribuoi për gjetjen e zgjidhjeve për tejkalimin e tyre, me qëllim të veprimit sipas kërkesave të Avokatit të Popullit.

Fushata e mediave zgjati tre muaj, periudhë kjo në të cilën në nivel nacional dhe lokal u shfaqën klipet televizive për zyrat rajonale të Avokatit të Popullit.

Tentativa për qasje më të madhe deri te qytetarët, gjatë vitit për të cilin raportojmë, rezultoi edhe me “wep – faqen” e re, e cila siguron akses maksimal në bazën të dhënave për punën e Avokatit të Popullit, komunikimin e përditshëm të qytetarëve me Institucionin dhe pranimin e parashtresave përmes postës elektronike. Wep – faqja, qytetarëve dhe organizatave ndërkombëtare u mundëson qasje më të lehtë deri te informatat, sepse përmbajtja e saj mund të lexohet në gjuhën maqedonase, shqipe dhe gjuhën angleze.



Me qëllim të njohjes së qytetarëve me ekzistimin e mundësisë së re të komunikimit me Avokatin e Popullit, u organizua konferencë për shtyp, efekti i së cilës rezultoi menjëherë me pranimin e më tepër parashtresave dhe pyetjeve me anë të postës elektronike, në të cilat shtroheshin çështje për gjendje të caktuara në shoqëri për realizimin e të drejtave të qytetarëve.

Pozicionimi i Avokatit të Popullit në skenën publike të vendit, në masë të madhe varet edhe nga pozicionimi i tij në planin ndërkombëtar, për çka gjatë veprimit dhe komunikimit në këtë fushë vendoset qasje e njëjtë e drejtpërdrejtë dhe më studimore, me vetiniciativë më të madhe dhe angazhim të përkushtuar të Avokatit të Popullit nëpër konferencat ndërkombëtare.

Avokati i Popullit, fillimisht u fokusua tek institucionet e rajonit, nga vetë fakti se bëhet fjalë për vende, të cilat e kanë kaluar rrugën e njëjtë të vështirë të tranzicionit dhe ballafaqohen me sfida dhe vështirësi të njëjta apo të ngjashme.



Kështu, Avokati i Popullit realizoi takime, vizita si edhe ishte nikoqir i Ombudsmanit të Greqisë, Shqipërisë dhe Serbisë e Malit të Zi, ndërsa me Ombudsmanin e Kosovës bëri shkëmbim të kuadrit profesional, me qëllim të shkëmbimit të përvojave të punës të të dy institucioneve.

Në kuadër të bashkëpunimit me zyrën e Ombudsmanit të Greqisë, i cili drejton me Projektin “Eunomia” – përfaqësues të Avokatit të Popullit morën pjesë në seminarin, i cili u mbajt në Prespë – Lemos të Greqisë me

temë: “Mbrojtja e mjedisit”. Pjesëmarrjen në konferencat me karakter ndërkombëtar, gjatë periudhës për të cilën raportojmë, Avokati i Popullit e shfrytëzoi për promovim të institucionit me prezantimin e punës për fusha dhe çështje, të cilat në pjesë më të madhe e prekin shoqërinë maqedonase, por njëherit edhe e ilustronë suksesin e arritur në punën e Avokatit të Popullit.

Në këtë kontekst, zyra e Avokatit të Popullit i prezantoi edhe aktivitetet dhe ngadhënjimet e arritura në planin e mbrojtjes të të drejtave të fëmijëve në nivelin ndërkombëtar, duke u nisur nga fakti se në suaza të institucionit funksionon Seksioni i veçantë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, seksion ky që është edhe anëtar i Rrjetit Evropian të Ombudsmanëve të Fëmijëve.

Duke e çmuar lart tendencën e standardeve të reja të përcaktuara në fushën e të drejtave të njeriut, sidomos standardeve që kanë të bëjnë me diskriminimin racor dhe çdo lloj tjetër të diskriminimit, në Kazan, Federata Ruse, Instituti i Ombudsmanit të Evropës dhe Ombudsmani i Republikës së Tatarstanit, organizuan konferencën ndërkombëtare, në të cilën Avokati i Popullit e prezantoi përvojën maqedonase me ballafaqimin me konfliktet në bazë etnike, me të cilat u ballafaqua vendi ynë.

Duke e pasur parasysh se kjo çështje është me rëndësi thelbësore, në shumë vende me karakter multietnik, përvoja maqedonase gjatë ballafaqimit me këtë lloj të konflikteve zgjoi vëmendje të veçantë te ombudsmanët e institucioneve, anëtarë të Institutit Ombudsman të Evropës dhe fjala e tij u publikua nga ana e kësaj organizate prestigjioze, anëtar i së cilës është edhe Institucioni Avokat i Popullit i Republikës së Maqedonisë.



Prezantim në temë të njëjtë, Avokati i Popullit pati edhe në Konferencën që u mbajt në Novi Sad, e cila qe organizuar nga Zyra e Ombudsmanit të Vojvodinës, ku Ombudsmani i Republikës së Maqedonisë u cilësua si institucion, i cili nga aspekti i zhvillimit dallon nga zyrat e tjera të ombudsmanëve të vendeve të cilat dikur ishin në përbërje të RSFJ-së.



Meqë strategjia e planit ndërkombëtar, para së gjithash bazohet në pjesëmarrjen më aktive në organizatat dhe asociacionet e ombudsmanëve, Avokati i Popullit mori pjesë edhe në Asambleshën e Përgjithshme të Institutit të Ombudsmanit të Evropës, në të cilën u shqyrtua dhe u votua Statuti i ri i këtij Institucioni.

Avokati i Popullit, si anëtar me të drejtë vote, u emërua edhe në Asociacionin Amerikan të Ombudsmanëve, si edhe në Asociacionin e Ombudsmanëve të frankofonisë dhe si rezultat i kësaj mori pjesë në Kongresin e VIII të kësaj organizate frankofone, në të cilën u pranua si anëtarë i Sekretariatit të saj.

Kontaktet e realizuara dhe komunikimi i përditshëm me organizatat ndërkombëtare në vend, veçanërisht me Misionin e OSBE-së në Republikën e Maqedonisë, në masë të madhe e përforcuan pozicionin e Institucionit në planin ndërkombëtar, sidomos nga aspekti i proceseve evropintegruese të Republikës së Maqedonisë, sepse Avokati i Popullit nga ana e bashkësisë ndërkombëtare është pranuar dhe vlerësuar si mekanizëm kontrollues me rëndësi të veçantë, e që qartë u ilustrua në rekomandimet të cilat Republika e Maqedonisë i mori pas marrjes së mendimit të Unioni Evropian për statusin e vendit kandidat.

Kur flasim për këtë çështje, rëndësi të veçantë kanë edhe konstatimet e theksuara nga ana e krerëve të bashkësisë ndërkombëtare në vend, të cilat kanë të bëjnë me “kontestin” ndërmjet Avokatit të Popullit dhe Ministrisë për Punë të Brendshme, e që u paraqit si rezultat i konstatimeve të Avokatit të Popullit se segmenti tejte i rëndësishëm i këtij organi apo i ashtuquajturit mekanizmi i tij kontrollues intern – Sektori për punë të brendshme, refuzon që Avokatit të Popullit t’ia ofrojë të dhënat dhe informatat e nevojshme, gjithnjë duke iu referuar Ligjit për informata të klasifikuara. Veprimi i këtillë i Ministrisë për Punë të Brendshme, nga raporti i fundit i Grupit Ndërkombëtar të Krizave, u quajt “koklavitje ligjore” për të pasur pretekst që Avokatit të Popullit mos t’i jepen informatat.


Reagimet, apo thënë më saktë kritikën e shpalosura në llogari të gjykatave dhe Ministrisë për Punë të Brendshme – dy segmente për të cilat Bashkimi Evropian konsideron se kanë nevojë të madhe për reformim, nga ana e Bashkësisë Ndërkombëtare u mirëpritën, ndërsa Institucioni Avokati i Popullit u karakterizua si korrektues i vërtetë i pushtetit.

Bashkëpunimi me Misionin e OSBE-së në Republikën e Maqedonisë në planin e superstrukturimit të Institucionit, rezultoi me fillimin e Projektit “SIDA”, të përkrahur nga Mbretëria e Suedisë dhe Misioni i OSBE-së në Republikën e Maqedonisë. Ky Projekt, përveçse parashikon pajisjen e zyrave me teknologji informatike, përmban edhe trajnime për profesionalizimin shtesë të kuadrit profesional nga aspekti i arritjes së shkathtësive gjatë hulumtimit të lëndëve sipas standardeve botërore, e që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijëve. Gjatë vitit për të cilin raportojmë, u realizua trajnim për përsosje të shkathtësive për hulumtimin e lëndëve, në të cilin mori pjesë kuadri profesional nga selia e Shkupit si dhe nga zyrat rajonale. Trajnimin e realizoi një specialist dhe sipas Raportit të tij “Evalutiv” filloi zbatimin e Projektit “SIDA”. Projekti do të zbatohet gjatë gjithë vitit 2006 dhe në të do të përfshihet i gjithë kuadri profesional i Institucionit Avokati i Popullit.

## Viti i pasqyruar me shifra

Nëse punën e Avokatit të Popullit, në mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve gjatë vitit 2005, e pasqyrojnë me shifra mund të konstatojmë se në Republikën e Maqedonisë akoma nuk respektohen dhe në mënyrë përkatëse nuk zbatohen tërësisht dispozitat ligjore, dhe kjo si rjedhojë sjellë cenimin e të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës shtetërore dhe organeve e organizatave të cilat kanë autorizime publike.

Funksionimi i shtetit ligjor parashikon ekzistimin e kornizës përkatëse ligjore, institucione efikase dhe profesioniste, si dhe nëpunës ekspertë dhe kompetentë, të cilët në mënyrë të paanshme, objektive dhe të barabartë do ta zbatojnë drejtësinë. Karakteristikat e këtilla, të drejtësisë efektive dhe efikase, munguan edhe gjatë vitit të kaluar e që vërehet nga lloji dhe numri i parashtrësave të parashtruara pranë Avokatit të Popullit.




# 3053

parashtresa të reja

## Tregues të përgjithshëm

Avokati i Popullit, gjatë vitit 2005, ka vepruar gjithsej mbi 3935 parashtresa nga të cilat, për periudhën për të cilën raportojmë, 3053 parashtresa janë parashtruar nga 3440 qytetarë. Në 17 raste Avokati i Popullit me iniciativë të vet hapi procedurë, ndërsa në bisedë janë pranuar 5123 qytetarë si në zyrën në Shkup ashtu dhe në zyrat rajonale, ndërkohë që përgjigje u janë dhënë 7041 telefonatave.

### Grafiku nr.1




Nëse analizohen të dhënat për numrin e parashtresave të pranuar, krahasuar me vitet e kaluara, mund të vërehet se gjatë vitit 2005 numri i parashtresave të parashtruara është rritur për 55.84%. (**Grafiku nr.1, fq.10**)

Kjo i referohet mënyrës dhe metodës së re të punës së Institucionit, si edhe shfrytëzimit të instrumentit: “ekspozim në kritikë publike”, gjithsesi dhe bashkëpunimit më të ngushtë me mediat, si dhe zbatimit të fushatës në media, me të cilën qytetarëve iu dha mundësia më gjerësisht të njihen me kompetencat, rolin dhe rëndësinë e Institucionit Avokati i Popullit në mbrojtjen e të drejtave të tyre kushtetuese dhe ligjore.

### Grafiku nr. 2

#### Parashtresa të pranuar sipas viteve



# 3935


parashtresa sipastë cilave ka vepruar AP

## Parashtresa sipas fushave

Numri më i madh i parashtresave, me të cilat qytetarët kërkuan mbrojtje të të drejtave janë: në fushën e jurisprudencës 976 ose 31.97%; pastaj në fushën pronësore juridike 403 ose 13.20%; në fushën e mbrojtjes të të drejtave gjatë procedimit policor dhe punë të tjera të rendit 391 ose 12.81%; nga fusha e marrëdhënies së punës 315 ose 10.32%; në fushën e urbanizmit dhe ndërtimtarisë 184 ose 6.03%; në fushën e sigurimit pensional dhe invalidor 170 ose 5.59%; në fushën e të drejtave sociale 118, përkatësisht 3.87%; në fushën e të drejtave të konsumatorëve (kompensime komunale dhe kompensime të tjera) 94 ose 3.08%; në fushën e çështjeve strehimore 64 ose 2.10%; në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve 63 ose 2.06%; në mbrojtjen shëndetësore 43 ose 1.41%; në fushën e arsimit, shkencës, kulturës dhe sportit 38 apo 1.24%; në fushën e mjedisit 23 ose 0.75%; pastaj në fushën e financave dhe punën financiare 19 ose 0.62%; në fushën e diskriminimit 6 ose 0.20%; të drejtat e ushtarakëve dhe detyruesve ushtarakë 5 ose 0.16%; të drejtat e bashkësive të cilat nuk janë shumicë 4 ose 0.13%; në fushën e punës doganore 1 ose 0.03%; si edhe në fusha të tjera ku janë parashtruar 136 ose 4.45% parashtresa. **(Pasqyra nr. 2 fq. 14 dhe Grafiku nr. 3 dhe 4 fq. 11)**

### Grafiku nr. 3

Të drejtat nga fusha e jurisprudencës




Pasqyra e parashtresave, të parashtruara sipas fushave, krahasuar me vitin paraprak shënon zvogëlim ose rritje të pa konsiderueshme, përveçse në fushën e jurisprudencës ku numri i parashtresave të parashtruara është rritur për 253.51%. **(Grafiku nr.3 fq.11)**


Numri më i madh i parashtresave kanë të bëjnë me joefikasitetin e gjykatave, përkatësisht zvarritjen e proceseve gjyqësore, ndërsa të tjerat bëjnë vërejtje ndaj akteve dhe veprimeve të ndërmarra dhe miratuara nga ana e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, Ministria e Financave, Ministria për Punë të Brendshme, Ministria për Transport dhe Ndërlidhje, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale dhe organeve të tjera, ndërsa pjesa tjetër e parashtresave ka të bëjë edhe me organet e organizatat që kanë autorizime publike.

### Grafiku nr. 4


Të drejtat nga fusha e marrëdhënieve pronësore – juridike




Të drejtat gjatë procedurës policore dhe punëve tjera të rendit




Të drejtat nga fusha e marrëdhënies së punës




**Të drejtat nga fusha e urbanizimit dhe ndërtimtarisë**




**Të drejtat nga fusha e sigurimit pensional dhe invalidor**




**Të drejtat nga fusha e mbrojtjes sociale**




**Të drejtat e fëmijëve**




**Të drejtat nga fusha e çështjes strehimore**




**Të drejtat e konsumatorëve**




**Të drejtat nga fusha e arsimit, shkencës, kulturës dhe sportit**




**Të drejtat nga fusha e mbrojtjes shëndetësore**




**Të drejtat nga fusha e mjedisit**




**Të drejtat nga fusha e diskriminimit**




**Të drejta nga fusha e financave dhe punës financiare**




**Të drejtat e bashkësive të cilat nuk janë shumicë**



**Të drejtat nga fusha e doganave**



**Të drejtat nga fusha të tjera**



Sipas përkatësisë etnike, nga parashtruesat në të cilat qytetarët janë deklaruar për përkatësinë e tyre etnike, vërehet se numri më i madh i parashtruesve janë maqedonas – 1061 ose 64.00%, 429 ose 25.87% janë pjesëtarë të bashkësisë etnike shqiptare, ndërsa numër më i vogël, përkatësisht 7 ose 0.42% janë paraqitur nga maqedonas – mysliman dhe 1732 ose 51.10% të parashtruesve të parashtrësve nuk e kanë deklaruar përkatësinë e tyre etnike. **(Pasqyra nr. 3 fq. 15)**

**Pasqyra nr. 1**

PASQYRA E PARASHTRËSAVE TË PRANUARA, ZGJIDHURA DHE PARASHTRËSAVE TË TJERA QË PUNOHEN, SIPAS VITEVE																		
	Parashtrësia të bartura nga viti paraprak	Parashtrësia të pranuar gjatë vitit vijues	Numri i parashtrësive	GJITHSEJ që punohen	Mënyra e zgjidhjes								Informata pranë ministrit	Informata pranë Qeverisë së RM-së	Informata pranë organeve dhe organizatave të tjera me autorizime publike	Gjithsej lëndë të zgjidhura	Lëndë që punohen	
					Numri i parashtrësive të pranuar anonime	Konkluzion për pezullimin e procedurës	Me vendime për mosveprim të procedurës	Janë zgjidhur në mënyra të tjera	Cenime të konstatuara									
									Sugjerime, rekomandime dhe mendime të dhëna	Është proceduar pas ndërhyrjes së Avokatit të Popullit	Rastej mbi të cilat AP i ka ndërmarrë të gjitha veprimet ligjore	Nuk është vepruar pas ndërhyrjes së AP						
<b>GJITHSEJ në vitin 2005</b>	882	3053	3440	3935	33	1347	761	84	803	478	26	299	77	225	12	<b>2729</b>	1206	
<b>GJITHSEJ në vitin 2004</b>	1243	1959	2299	3202	25	1145	683	50	569	417	-	152	102	116	33	<b>2320</b>	882	

Sipas vendbanimit të parashtruesve të parashtrësive, numri më i madh i parashtrësive, përkatësisht 1169 janë nga Shkupi, pasojnë mjediset tjera më të mëdha urbane, të cilat me përjashtime të vogla i përgjigjen numrit të qytetarëve sipas numrit të banorëve. **(Pasqyra nr.4, fq.16)**

## Pasqyra nr. 2

PASQYRA E PARASHTRËSIVE TË PRANUARA, ZGJIDHURA DHE PARASHTRËSIVE TË TJERA QË PUNOHEN NGA DATA 01.01.2005 – 31.12.2005																	
	Parashtrësia të pranuar gjatë vitit 2005	Numri i parashtrësive	Numri i parashtrësive të bartura nga viti paraprak	Gjithsej që punohen	Mënyra e zgjidhjes								Informata pranë ministrit	Informata pranë Qeverisë së RM-së	Informata pranë organeve organizatave të tjera me autorizime publike	Gjithsej lëndë të përfunduara	Lëndë që punohen
					Numri i parashtrësive të pranuar anonime	Me konkluzion për pezullim të procedurës	Me vendim për moshapje të procedurës	Të zgjidhura në mënyra të tjera	Cenime të konstatuara								
									Sugjerime, rekomandime dhe mendime të dhëna	Është vepruar pas ndërhyrjes së Avokatit të Popullit	Rastet mbi të cilat AP i ka ndërmarrë të gjitha veprimet ligjore	Akoma nuk është vepruar pas intervenimit të Avokatit të Popullit					
Të drejtat e bashkësive të cilat nuk janë shumicë	4	4	9	13		2	2		1	1					5	8	
Të drejtat gjatë procedurës policore dhe punëve të tjera të rendit	391	415	138	529	2	129	55	7	133	83	9	41	9	1	285	244	
Të drejtat nga fusha e jurisprudencës	976	1093	62	1038	6	385	366	16	84	76		8	1	4	849	189	
Të drejtat e ushtarakëve dhe detyruesve ushtarakë	5	5	8	13		2	3		1	1			1		6	7	
Të drejtat nga fusha e mbrojtjes sociale	118	118	70	188		77	12	3	64	58	2	4	11	3	152	36	
Të drejtat nga fusha e marrëdhënies së punës	315	359	197	512	7	265	50	3	89	53	6	30	6	6	1	384	128
Të drejtat nga fusha e marrëdhënies së strehimit	64	69	56	120		50	16	2	18	13		5	2		81	39	
Të drejtat nga fusha e mbrojtjes shëndetësore	43	44	17	60		22	9		19	17		2			48	12	
Të drejtat nga fusha e sigurimit pensional dhe invalidor	170	171	39	209	2	90	32	1	36	27		9	2	10	152	57	
Të drejtat nga fusha e arsimit, shkencës, kulturës dhe sportit	38	38	10	48		16	9		15	12	1	2	4		1	38	10
Të drejtat e fëmijëve	63	65	12	75		31	1		25	23		2	5	2	2	55	20
Të drejtat nga fusha e urbanizimit dhe ndërtimit	184	218	67	251	4	101	41	41	25	10		15	29		197	54	
Të drejtat nga fusha e mjedisit	23	23	1	24		9	2	1	3	2		1			14	10	
Të drejtat nga fusha e financave	19	19	16	35		9	9		8	3	2	3	1		23	12	
Mbrojtja e të drejtave nga fusha e doganës	1	1		1			1								1	0	
Të drejtat nga fusha e marrëdhënies së pronësorisë – juridike	403	446	100	503		57	63	5	231	61	6	164	3	201	2	192	311
Të drejtat e konsumatorëve	94	195	41	135		48	22	2	36	31		5	2	1	103	32	
Të drejtat nga fusha e diskriminimit	6	6		6		1	2		2			2			3	3	
Të drejtat nga fusha të tjera	136	151	39	175	12	53	66	3	13	7		6	1	1	2	141	34
<b>GJITHSEJ</b>	<b>3053</b>	<b>3440</b>	<b>882</b>	<b>3935</b>	<b>33</b>	<b>1347</b>	<b>761</b>	<b>84</b>	<b>803</b>	<b>478</b>	<b>26</b>	<b>299</b>	<b>77</b>	<b>225</b>	<b>12</b>	<b>2729</b>	<b>1206</b>

**Pasqyra nr. 3**

**PASQYRA E PARASHTRUESVE TË PARASHTRËSAVE  
SIPAS PËRKATËSISË ETNIKE**

		Parashtrësia të pranuar gjatë vitit 2005	Numri i parashtrësive të pranuar anonime	Numri i lëndëve të formuara me iniciativë vetjake	Numri i parashtrësive	PËRKATËSIA ETNIKE								Të tjerë	
						Maqedonas	Shqiptarë	Serbë	Romë	Maqedonas myslimanë	Boshnjakë	Vlleh	Turq		Nuk e kanë deklaruar përkatësinë etnike
						6	7	8	9	10	11	12	13		14
1	Të drejtat e bashkësive të cilat nuk janë shumicë	4			4		2				1			1	
2	Të drejtat gjatë procedurës policore dhe punëve të tjera të rendit	391	2	1	412	77	171	4	4	1	5	3	9	134	4
3	Të drejtat nga fusha e jurisprudencës	976	4	3	1085	331	83	9	13	2	5	2	14	625	1
4	Të drejtat e ushtarakëve dhe detyrësive ushtarakë	5			5	1								4	
5	Të drejtat nga fusha e mbrojtjes sociale	118		1	117	35	25	1	8	1	1		2	43	1
6	Të drejtat nga fusha e marrëdhënieve të punës	315	5	1	350	133	28	2	5		1		2	177	2
7	Të drejtat nga fusha e marrëdhënieve strehimore	64			69	27	3	3			1		4	31	
8	Të drejtat nga fusha e mbrojtjes shëndetësore	43			44	15	9	2		1			1	16	
9	Të drejtat nga fusha e sigurimit pensional dhe invalidor	170	2	1	168	53	35	2		1		1	5	71	
10	Të drejtat nga fusha e arsimit, shkencës, kulturës dhe sportit	38			38	14	3	1	1					19	
11	Të drejtat e fëmijëve	63		4	61	17	9	1						34	
12	Të drejtat nga fusha e urbanizmit dhe ndërtimtarisë	184	4		214	61	13		2	1			2	134	1
13	Të drejtat nga fusha e mjedisit	23		4	19	5	3							11	
14	Të drejtat nga fusha e financave	19			19	5	2	2						10	
15	Mbrojtja e të drejtave nga fusha e doganës	1			1									1	
16	Të drejtat nga fusha e marrëdhënieve pronësore – juridike	403		1	445	202	29	6	5		1	2	8	191	1
17	Të drejtat e konsumatorëve	94			195	43	7	3			1		2	139	
18	Të drejtat nga fusha e diskriminimit	6		1	5				1					4	
19	Të drejta nga fusha të tjera	136	9		139	42	7		2					87	1
<b>20</b>	<b>GJITHSEJ</b>	<b>3053</b>	<b>28</b>	<b>17</b>	<b>3390</b>	<b>1061</b>	<b>429</b>	<b>36</b>	<b>41</b>	<b>7</b>	<b>16</b>	<b>8</b>	<b>49</b>	<b>1732</b>	<b>11</b>



**Pasqyra nr.4**

PASQYRA E PARASHTRESAVE TË PRANUARA							
Numri rendor	Qytete dhe shtete	Numri i parashtresave sipas qyteteve		Numri rendor	Qytete dhe shtete	Numri i parashtresave sipas qyteteve	
		Viti 2004	Viti 2005			Viti 2004	Viti 2005
1	Berovë	6	18	26	Pehçevë	3	3
2	Manastir	88	263	27	Prilep	50	57
3	Bogdanc	-	3	28	Probishtip	14	20
4	Vallandovë	5	3	29	Radovish	22	46
5	Veles	33	77	30	Resnjë	11	13
6	Vinicë	7	6	31	Shkup	1104	1169
7	Dibër	8	12	32	Strugë	12	36
8	Dellçevë	16	22	33	Strumicë	29	169
9	Demir Hisar	7	15	34	Sveti Nikollë	5	15
10	Demir Kapi	1	4	35	Tetovë	64	185
11	Dojran	3	1	36	Shtip	57	173
12	Gjevgjeli	12	27	37	Austri	2	1
13	Gostivar	78	119	38	Itali		2
14	Zletovë	1	-	39	Kosovë	3	7
15	Kavadar	48	56	40	Poloni		1
16	Kërçovë	42	121	41	R. e Shqipërisë	2	3
17	Koçan	28	45	42	R. e Bullgarisë	-	1
18	Kratovë	10	16	43	R. e Kroacisë	-	1
19	Kr.Palankë	17	19	44	R. e Sllovenisë	1	
20	Krushevë	6	14	45	Serbia e Mali i Zi	1	3
21	Kumanovë	85	221	46	Stokholm	1	
22	M.Kamenicë	2	4	47	SHBA		2
23	Mak.Brod	8	10	48	Turqi	1	1
24	Negotinë	16	21	49	Zvicër	1	
25	Ohër	49	48				
<b>GJITHSEJ :</b>						<b>1959</b>	<b>3035</b>

**79,82 %**

hulumtime të  
realizuara të AP-së

### Hulumtimi sipas parashtresave


Pas pranimit të parashtresave, në qoftë se nuk ka pasur nevojë për hulumtime shtesë, veprime menjëherë, ndërsa nëse ka pasur nevojë janë dërguar kërkesa pranë organeve kompetente ose deri te parashtruesit e parashtresave. Në disa raste janë bërë inspektime dhe janë thirrur në bisedë persona zyrtarë dhe persona të tjerë.

Nga gjithsej 3935 parashtresa, janë përfunduar 2729 ose 69.35%, ndërsa sipas 1206 ose 30.65% të parashtresave procedura është në vijim. *(Ilustrimi nr.2, fq.17)*

Nga 2729 parashtresat e përfunduara, 1347 ose 49.39 janë parashtresa sipas së cilave procedura është pezulluar, ndërkaq 761 ose 27,89% janë parashtresa sipas të cilave nuk është hapur procedurë, për 478 ose 17,52% të parashtresave Avokati i Popullit ka konstatuar cenim dhe mbi ato ka vepruar, për 26 ose (0,95%) parashtresa Avokati i Popullit ka konstatuar cenime dhe i ka ndërmarrë të gjitha veprimet e mundshme ligjore, 84 ose 3,08% e parashtresave janë zgjidhur

në mënyra të tjera, ndërsa 33 ose 1,21% janë parashtresa anonime, prandaj dhe janë përfunduar pa procedurë. (Ilustrimi nr.3, fq.17)

### Ilustrimi nr.1




Nga 803 parashtresa, sipas të cilave Avokati i Popullit ka konstatuar cenime kushtetuese dhe ligjore të të drejtave dhe lirive, sipas 478 ose 59.53% është vepruar pas ndërhyrjes së Avokatit të Popullit, për 299 ose 37.24% akoma nuk është vepruar sipas intervenimit të Avokatit të Popullit, ndërsa për 26 raste ose 3.24% Avokati i Popullit i ka ndërmarrë të gjitha veprimet e mundshme.

Gjatë vitit 2005, Avokati i Popullit nga gjithsej 3953 parashtresa veproi mbi 3141 ose 79.82%, ndërsa për 794 parashtresa ose 20.18% nuk ka hapur procedurë. (Ilustrimi nr. 1, fq. 17)

Avokati i Popullit vlerëson se akoma ka qytetarë, të cilët nuk i njohin sa duhet mundësitë e Institucionit.

Nga gjithsej 3141 parashtresa, sipas të cilave Avokati i Popullit ka hapur procedurë, 1935 ose 61.60% kanë përfunduar, ndërsa sipas 1206 ose 38.40% procedura ende vazhdon.


### Ilustrimi nr.2




Parashtresat, sipas të cilave procedura pranë Avokatit të Popullit është ende në vijim, përkatësisht në fazën e hulumtimit, i referohet ndërlikueshmërisë së problemit, nevojës për grumbullimin e më tepër informatave apo provave nga më tepër organe dhe organizata, por për një pjesë të konsideruat të tyre kjo ndodh për shkak të vonesës së përgjigjes, sipas kërkesave të Avokatit të Popullit.

Duhet theksuar se në disa raste, parashtresit e parashtresave kanë reaguar se procedura pranë Avokatit të Popullit zgjatë shumë, ndonëse kjo i referohet pikërisht mosveprimit me kohë apo

### Ilustrimi nr. 3



**Grafiku nr.5**



mosveprimit fare të organeve të administratës shtetërore sipas kërkesave të dërguara nga Avokati i Popullit.

Ndonëse me Ligjin e ri të Avokatit të Popullit, janë caktuar afate të detyrueshme, brenda të cilave organet kompetente duhet t'i përgjigjen Avokatit të Popullit, për fat të keq shpeshherë nuk veprohet brenda afatit të parashikuar.

Nga puna praktike, mund të konstatohet se raporti i personave zyrtarë ndaj kërkesave të Avokatit të Popullit akoma nuk kënaq. Me qëllim të azhurnimit të procedurës dhe për shkak të përmirësimit të gjendjeve, pranë organeve e organizatave me autorizime publike janë dërguar 12 informata, nga të cilat 3 janë pranuar, pranë ministrive kompetente janë dërguar 77 informata, nga të cilat 31 janë pranuar, ndërkaq pranë Qeverisë së Republikës së Maqedonisë janë dërguan 225 informata, nga të cilat vetëm 31 janë pranuar. (**Grafiku nr.5, fq.18**)

**20,41 %**

cenime të  
konstatuara

## Cenime të konstatuara dhe zvogëlimi i padrejtësive


Pas shqyrtimit të parashtrësive, në qoftë se konstatohen cenime të të drejtave kushtetuese dhe ligjore të qytetarëve, Avokati i Popullit me rekomandime, mendime, sugjerime, udhëzime, propozime, kërkesa dhe ndërhyrje të tjera të ngjashme, nga organet kompetente kërkon që të shmangen parregullsitë me qëllim që qytetarët të mund ta realizojnë të drejtën e tyre në mënyrë më ekonomike dhe më efikase.

Në këtë drejtim bëhen edhe ndërhyrjet e Avokatit të Popullit, e që duhet të kontribuojnë për përmirësimin dhe përsosjen te organizatës dhe punës së shërbimeve profesionale në organet e administratës shtetërore dhe në organet e organizatat e tjera me autorizime publike.

Nga numri i përgjithshëm i lëndëve, sipas të cilave gjatë vitit 2005 ka vepruar Avokati i Popullit, në 803 raste janë konstatuar cenime të të drejtave kushtetuese dhe ligjore të qytetarëve. Nga ky numër në 478 raste (59.53%) organet e administratës shtetërore dhe organet e organizatat me autorizime publike, kanë vepruar pas ndërhyrjes së Avokatit të Popullit, për 299 të rasteve

(37.24%) procedura është në vijim, ndërsa për 26 (3.24%) të rasteve Avokati i Popullit i ka shfrytëzuar të gjitha mundësitë ligjore. **(Ilustrimi nr. 4, fq. 19)**


**Ilustrimi nr.4 Cenime të konstatuara gjatë vitit 2005**



Numri më i madh i cenimeve të konstatuara, gjatë vitit 2005, i takojnë fushës së marrëdhënieve pronësore – juridike 231 ose 28.77%, nga të cilat për 61 raste ose 26.41% organet dhe organizatat me autorizime publike kanë vepruar pas ndërhyrjes së Avokatit të Popullit. Pasojnë parashtrësit nga fusha e procedurës policore ku janë konstatuar cenime në 133 të rasteve ose 16.56%, nga të cilat në 83 ose 62.41 të rasteve janë pranuar ndërhyrjet e Avokatit të Popullit; në fushën e marrëdhënieve të punës, cenime janë konstatuar në 89 ose 11.08% të rasteve, nga të cilat në 53 ose 59.55 është vepruar pas ndërhyrjes së Avokatit të Popullit; në fushën e jurisprudencës 84 ose 10.46% nga të cilat në 76 ose në 90.48% të rasteve është vepruar etj.

Nga numri i përgjithshëm i cenimeve të konstatuara, numri më i madh i mosveprimit sipas sugjerimeve, mendimeve të shprehura dhe rekomandimeve të Avokatit të Popullit janë nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë, Ministria e Financave, Ministria për Punë të Brendshme, Ministria e Transportit dhe Ndërlidhjeve etj. **(Ilustrimi nr.5, fq.19)**

**Ilustrimi nr.5 Organet, të cilat në numrin më të madh të rasteve akoma nuk kanë vepruar sipas intervenimeve të AP**




Numri më i madh i cenimeve të konstatuara të qytetarëve, sikurse edhe gjatë viteve të kaluara, ka të bëjë me cenime ligjore dhe cenime të dispozitave procedurale, përkatësisht të zvarritjeve të procedurave, me të cilat qytetarët i realizojnë të drejtat e tyre. Nga numri i përgjithshëm, thuhet se në 80% të rasteve janë konstatuar cenime të cilat kanë të bëjnë me zvarritjen e procedurave administrative dhe gjyqësore. Me fjalë të tjera, në mbi 80% të rasteve,

organet kompetente nuk i kanë respektuar afatet e vendimmarrjes sipas kërkesave të qytetarëve, ndërsa në një numër të konsideruar kanë keqpërdorur institutin “heshtje” të administratës.

Për shmangien e cenimeve të konstatuara, Avokati i Popullit pranë organeve kompetente paraqiti 403 intervenime, në mesin e të cilëve: 76 rekomandime, 309 udhëzime, 6 mendime dhe 12 sugjerime. Krahas kësaj, Avokati i Popullit paraqiti 8 kërkesa pranë Avokatit Publik, të cilat kishin të bënin me hapje të procedurës për shkak të verifikimit të përgjegjësisë ndëshkimore, një iniciativë dërgoi pranë Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për ndryshimin e ligjeve, më tepër propozime dërgoi për hapje të procedurave disiplinore kundër personave përgjegjës ose personave zyrtarë nëpër organet dhe organizatat. **(Grafiku nr.6, fq.20)**

**Grafiku nr. 6**



**5123**  
qytetarë të  
pranuar në bisedë

## Qytetarët dhe Avokati i Popullit

Avokati i Popullit në zyrën në Shkup si edhe në zyrat rajonale në: Manastir, Kërçovë, Tetovë, Kumanovë, Shtip dhe Strumicë praktikoi pranimin e përditshëm të qytetarëve me çrast ai, zëvendësit e tij apo punonjësit e shërbimit profesionalë, në bisedë kanë pranuar mbi 5123 qytetarë, ndërsa pas bisedave të zhvilluara, nëse është dyshuar se ka cenim të të drejtave, janë hartuar shënime zyrtare sipas të cilave pastaj veprohej ose qytetarët janë udhëzuar se ku dhe në ç'mënyrë mund t'i realizojnë të drejtat e tyre.

Zyra e Avokatit të Popullit në Shkup ka pranuar numrin më të madh të parashtresave, përkatësisht 2168. Në zyrën e Avokatit të Popullit në Manastir janë pranuar 222 parashtresa, 112 parashtresa janë pranuar në Kërçovë, 139 në Strumicë, 118 në Tetovë, 138 në Shtip dhe 156 parashtresa janë pranuar në zyrën e Kumanovës. **(Pasqyra nr.5, fq.21)**

**Pasqyra nr.5**

<b>PASQYRA E LËNDËVE TË PRANUAA NË ZYRAT E AVOKATIT TË POPULLIT</b>								
<i>Parashtresa të pranuar në zyrat e Avokatit të Popullit</i>								
	<b>Shkup</b>	<b>Manastir</b>	<b>Kërçovë</b>	<b>Strumicë</b>	<b>Tetovë</b>	<b>Shtip</b>	<b>Kumanovë</b>	<b>GJITHSEJ</b>
Të drejtat e qytetarëve të cilët nuk janë shumicë	4							4
Të drejtat nga procedimi policor dhe punë të tjera të rendit	285	19	12	11	23	10	31	391
Të drejtat nga fusha e jurisprudencës	659	78	37	62	30	67	43	976
Të drejta të ushtarakëve dhe detyruesve ushtarak	4	1						5
Të drejtat nga fusha e mbrojtjes sociale	79	15	1	3	6	6	8	118
Të drejtat nga fusha e marrëdhënies së punës	255	15	16	5	11	7	6	315
Të drejta nga fusha e çështjeve strehimore	51		2	3	1	4	3	64
Të drejtat nga fusha e mbrojtjes shëndetësore	32	2		5	1	2	1	43
Të drejtat e sigurimit pesnional dhe invalidor	106	16	13	6	14	5	10	170
Të drejtat nga fusha e arsmi, shkencës, kulturës dhe sportit	33	1			1	2	1	38
Të drejtat e fëmijëve	56	2		1	1	1	2	63
Të drejtat nga fusha e urbanizmit dhe ndërtimtarisë	121	16	3	16	12	9	7	184
Të drejtat nga fusha e mjedisit	15		1	2	2		3	23
Të drejtat nga fusha e financave	16	1		1			1	19
Të drejtat nga fusha e doganës						1		1
Të drejtat nga fusha e marrëdhënieve pronësore - juridike	264	42	21	15	13	15	33	403
Të drejtat e konsumatorëve	71	3	2	8		5	5	94
Të drejtat nga fusha e diskriminimit	6							6
Të drejtat nga fusha të tjera	111	11	4	1	3	4	2	136
<b>G J I T H S E J:</b>	<b>2168</b>	<b>222</b>	<b>112</b>	<b>139</b>	<b>118</b>	<b>138</b>	<b>156</b>	<b>3053</b>

# Në shërbim të qytetarëve

0,13 %

nga numri i  
përgjithshëm i  
parashtresave të  
pranuara

## Përfaqësimi i drejtë dhe adekuat

Me Programin e punës, për vitin 2005, njëra nga detyrat për realizimin e aktiviteteve të planifikuara ishte dhe analiza e zbatimit të parimit të caktuar kushtetues të përfaqësimit të drejtë dhe adekuat në organet e shtetit, në njësitë e vetadministrimit lokal dhe në institucionet e tjera publike.

Duke vepruar sipas aktiviteteve të planifikuara dhe me qëllim të shqyrtimit të plotë të gjendjes së përfaqësimit të drejtë dhe adekuat, Avokati i Popullit gjatë vitit 2005 bëri analizë në të gjitha institucionet mbi të cilat vepron me kompetencë.

Konkretisht, u kërkuan të dhëna të hollësishme sa i përket gjendjes së përfaqësimit të drejtë dhe adekuat, strukturës së punonjësve mbi bazë nacionale, përfaqësimit në përqindje të pjesëtarëve të bashkësive dhe punësimeve të realizuara dhe të projektuara.

Njëkohësisht, Avokati i Popullit kërkoi edhe të dhëna për sa i përket zbatimit të nenit 17, të Ligjit për nëpunës shtetërorë, sipas të cilit organet kompetente detyrohen të hartojnë plane vjetore për përfaqësimin e drejtë dhe adekuat të bashkësive, plan të cilin duhet t'ia dërgojnë Agjencisë për Nëpunës Shtetërorë.

Në kontekst të kësaj, Avokati i Popullit iu drejtua: Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, Qeverisë, ministrive, organeve të pavarura shtetërore (agjencive, drejtorive, komisioneve, enteve), fondeve, ndërmarrjeve publike, Këshillit Gjyqësor Republikan, Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë, Gjykatës Supreme, gjykatave të apelit dhe gjykatave themelore, Prokurorisë Publike dhe institucioneve ndëshkimore – përmirësuese.

Përndryshe, nga institucionet e lartpërmendura, janë përjashtuar njësitë e vetadministrimit lokal.

Në të vërtetë, Avokati i Popullit e kishte parasysh gjendjen aktuale që ka të bëjë me ristrukturimin e kuadrit të organeve të njësive të vetadministrimit lokal në relacionin pushtet qendror - pushtet lokal dhe ky qe shkaku kryesor që nuk iu drejtua vetadministrimit lokal, sepse vlerësoi se pas një periudhe të konsiderueshme, do të jetë lëndë e shqyrtimit analitik të gjendjes së strukturës së përfaqësimit adekuate të punonjësve.

Të dhënat, të cilat i dërguan institucionet, trajtojnë numrin e përgjithshëm të të punësuarve në organet e administratës shtetërore, në përputhje me Ligjin për nëpunës shtetërorë, përkatësisht në ndërmarrjet publike, në përputhje me Ligjin për marrëdhënie të punës dhe Ligjin për ndërmarrjet publike, Avokati i Popullit i sublimoi, hartoi dhe i pasqyroj në tabelë (**Pasqyrim me tabelë nr. fq.26**).

Nga analiza, e të dhënave që i ka në dispozicion, konstatohet se organet kompetente, veçanërisht organet e pushtetit ekzekutiv i realizojnë në mënyrë më intensive parimet e përfaqësimit të drejtë dhe adekuat të pjesëtarëve të bashkësive.

Nga ana tjetër, të dhënat e siguruar për kuadrin e organeve të pavarura shtetërore (agjencitë, drejtoritë, komisionet, entet), vënë në dukje se këto institucione në një përqindje minimale e respektojnë parimin e përfaqësimit të drejtë dhe adekuat të pjesëtarëve të bashkësive.

Në rrafsh të njëjtë janë edhe fondet dhe ndërmarrjet publike, ku përqindja e përfaqësimit të pjesëtarëve të bashkësive është e pamjaftueshme dhe nuk korrespondon me parimin e garantuar kushtetues.

Situatë të ngjashme hasim edhe në jurisprudencë, ku përqindja e zbatimit të parimit të përfaqësimit të pjesëtarëve të bashkësive realizohet me mefshtësi.

Në bazë të të dhënave, të cilat i ka në dispozicion, si institucione në të cilat fare nuk ka të punësuar pjesëtarë të bashkësive, Avokati i Popullit vë në dukje këto organe:

- Agjencinë për përkrahje të sipërmarrësisë së Republikës së Maqedonisë;
- Fondin për Sigurimin e Depozitimeve;
- NP për Furnizim me Ujë me Hidrosistemin “Liqeni i Dojranit” – Dojrani i Vjetër;
- NP Ekonomia e Ujit “Fusha e Gjevgjelisë - Valandovës” – Gjevgjeli;
- Gjykatën Themelore në Kavadar;
- Gjykatën Themelore në Radovish;
- Gjykatën Themelore në Sveti Nikollë dhe
- INP Burgu në Shtip

Si institucione, në përbërjen e të cilave përqindja e pjesëtarëve të bashkësive është minimale ose nën 10% nga numri i përgjithshëm i shërbimit profesional janë:

- Agjencia për Nxitjen e Zhvillimit të Bujqësisë – Manastir;
- Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim Shkup;
- Enti Shtetëror për Punë Gjeodezie;
- Drejtoria e të Hyrave Publike;
- Drejtoria e Aviacionit Civil;
- Byroja për Rezerva të Mallit;
- Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë – Shkup;
- Akademia Policore;
- Fondi për Sigurim Shëndetësor i Maqedonisë;
- NP për Ekonomizim me Lokale Banimi dhe Afariste e Republikës së Maqedonisë – Shkup
- NP “Radiodifuzioni i Maqedonisë” – Shkup;
- NP për Furnizim me Ujë “Studençica” – Shkup;
- NP “Strezhevë” – Manastir;
- NP për Ekonomizim me Ujë “Fusha e Gjevgjelisë – Valandovës” – Gjevgjeli;
- Gjykata e Apelit – Manastir;
- Gjykata e Apelit – Shtip;
- Gjykata Themelore në Berovë;
- Gjykata Themelore në Manastir;
- Gjykata Themelore në Veles;
- Gjykata Themelore në Gjevgjeli;
- Gjykata Themelore në Dellçevë;
- Gjykata Themelore në Kriva Pallankë;
- Gjykata Themelore në Koçan;
- Gjykata Themelore në Ohër;
- Gjykata Themelore në Prilep dhe



- Gjykata Themelore në Strumicë.

Megjithatë, konstatimi i përgjithshëm i Avokatit të Popullit nuk bazohet mbi të dhënat e të gjitha organeve sepse një pjesë e tyre edhe përkundër urgjencave shtesë, nuk i dërguan informatat e kërkuara si dhe nuk dërguan as të dhëna të tjera të pjeshme, të cilat nuk janë relevante për përpunimin dhe analizën e lëndës, kështu që me mosveprimin e tyre penguan funksionimin e Avokatit të Popullit.

Në kontekst të kësaj, pas kërkesës së Avokatit të Popullit nuk vepruan:

- Ministria për Punë të Brendshme;
- Ministria për Transport dhe Ndërlidhje;
- Agjencia për Zhvillim dhe Investime e Republikës së Maqedonisë;
- Agjencia për Privatizim;
- Agjencia për Komunikime Elektronike;
- Byroja për Zhvillimin e Arsimit;
- Byroja për Ekspertiza Gjqësore;
- Byroja e Turizmit;
- Komisioni Rregullator për Energji;
- Qendra për Arsimimin e Kuadrit nga Fusha e Sigurisë;
- Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim;
- Fondi për Sigurim Pensional dhe Invalidor i Maqedonisë;
- NP për Ekonomizim me Pyje “Pyjet e Maqedonisë” – Shkup;
- NP për Furnizim dhe Shpërndarje të Gazit Natyror “GA – MA” – Shkup;
- NP për Kryerje të Veprimtarive të Ekonomisë së Ujit HS “Zletovica” – Probishtip;
- NP për Ekonomi të Ujit “Lisiçe” – Veles;
- Gjykata Themelore në Kratovë;
- Gjykata Themelore në Kumanovë;
- Gjykata Themelore në Negotinë;
- Gjykata Themelore Shkup 2;
- INP – Burgu – Shkup;
- INP – Burgu Manastir;
- INP – Burgu – Gjevgjeli dhe
- të gjitha entet shëndetësore, me përjashtim të OPSH “Qendra e Klinikave” – Shkup;
- Institucionet e arsimit fillor dhe të lartë dhe
- Institucionet nga fusha e kulturës.

Nga ana tjetër të dhëna të pjeshme, nga të cilat nuk mund tërësisht të konstatohet gjendja e përfaqësimit të drejtë dhe adekuat, dërguan:

- Ministria e Arsimit dhe Shkencës;
- NP “Gazeta zyrtare e RM-së”
- Drejtoria për Sigurinë e Informatave të Klasifikuara dhe
- EEP – Tetovë.

Për shkak të mungesës të të dhënave, nga organet të cilat nuk dërguan apo dërguan informata të pjeshme, Avokati i Popullit nuk mund ta informojë me përpikëri Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, e as ta njoftojë Komitetin për marrëdhënie midis bashkësive me gjendjen reale dhe të plotë, të konstatuar lidhur me përfaqësimin e drejtë dhe adekuat të pjesëtarëve të të gjitha bashkësive në Republikën e Maqedonisë.

Së këtejmi, është e domosdoshme që Avokatit të Popullit t'i vihen në dispozicion të dhënat, të cilat do t'i mundësonin pasqyrimin e plotë të gjendjes, sa i përket përfaqësimit të drejtë dhe adekuat, që nënkupton bashkëpunim të rregullt dhe pa pengesë si dhe dërgim të të dhënave nga ana e organeve të cilave u drejtohet, në përputhje me kompetencat ligjore.

Megjithatë, nga të dhënat e dërguara pranë Avokatit të Popullit, mund të konstatohet se një numër më i madh i institucioneve edhe përkundër përpjekjeve të bëra për zbatimin e parimit të përfaqësimit të pjesëtarëve të të gjitha bashkësive, niveli i arritur akoma nuk kënaq.

Avokati i Popullit vlerëson se institucionet kompetente duhet në mënyrë maksimale të angazhohen për përshpejtimin e procesit të pjesëmarrjes së drejtë dhe adekuate të të gjitha bashkësive në sektorin publik dhe në atë të jurisprudencës, përkatësisht të angazhohen për zbatimin konsekuent të dispozitave kushtetuese dhe ligjore, të cilat bashkësive ua garantojnë të drejtat.

Të dhënat nuk janë të tërësishme ngaqë disa institucione edhe përkundër urgjencave shtesë të Avokatit të Popullit nuk i dërguan informatat e kërkuara, me çka penguan funksionimin e punës së tij.

Edhe përkundër kësaj, është për t'u theksuar se në ushtri, administratë publike, para së gjithash në ministri dhe institucione të tjera publike (përveç ndërmarrjeve publike dhe sistemit gjyqësor), shënohet rritje e përfaqësimit të drejtë dhe adekuat e pjesëtarëve të bashkësive, Avokati i Popullit nuk mund të jep pasqyrë krahasuese me të dhëna nga vitet e kaluara, sepse kompetencën e re për përcjelljen e përfaqësimit të drejtë dhe adekuat të pjesëtarëve të bashkësive filloi ta zbatojë nga viti 2005.

PASQYRIM ME TABELË

	Maqedonas		Shqiptarë		Turq		Romë		Vlleh		Serbë		Boshnjak		Të tjerë		Gjithsej
	Gjithsej	%	Gjithsej	%	Gjithsej	%	Gjithsej	%	Gjithsej	%	Gjithsej	%	Gjithsej	%	Gjithsej	%	
<b>Kuvendi i RM-së</b>	148	81,31	24	13,18	3	1,6	2	1,09	/	/	3	1,64	1	0,54	1	0,54	182
<b>Qeveria e RM-së</b>	406	82,52	46	9,34	9	1,82	7	1,42	7	1,42	10	2,03	5	1,01	2	0,4	492
<b>Ministritë</b>	2507	85,21	259	8,8	48	1,6	21	0,71	27	0,91	52	1,76	10	0,33	18	0,61	3042
<b>Organet pavarura shtetërore</b>	8572	89,8	469	4,91	56	0,58	53	0,55	64	0,67	212	2,22	33	0,34	86	0,9	9545
<b>Fondet</b>	616	94,62	25	3,84	2	0,3	1	0,15	5	0,76	2	0,3					751
<b>Ndërmarrjet publike</b>	5597	85,5	473	7,22	49	0,74	68	1,03	54	0,82	212	3,23	25	0,38	68	1,03	6646
<b>Jurisprudenca</b>	1741	85,4	182	8,93	26	1,27	25	1,22	37	1,81	12	0,58	5	0,24	9	0,44	2037
<b>INP-të</b>	188	81,38	35	15,15			1	0,43	2	0,86	2	0,86			3	1,29	331
<b>GJITHSEJ</b>	<b>19775</b>	<b>86,77</b>	<b>1513</b>	<b>7,42</b>	<b>193</b>	<b>0,83</b>	<b>178</b>	<b>0,77</b>	<b>196</b>	<b>0,85</b>	<b>505</b>	<b>2,19</b>	<b>79</b>	<b>0,34</b>	<b>187</b>	<b>0,81</b>	<b>23026</b>

**\* VËREJTJE:**

Tabela pasqyron përmbledhjen e të dhënave që i janë prezantuar Avokatit të Popullit, nga e cila nuk mund të ilustruhet qartë gjendja e përgjithshme sa i përket zbatimit të parimit të përfaqësimit të drejtë dhe adekuat të bashkësive.

**PASQYRË**  
**e institucioneve të cilat fare s'kanë vepruar sipas kërkesave**  
**të Avokatit të Popullit, përkatësisht nuk i kanë dërguar informatat e kërkuara**

- Ministria për Punë të Brendshme
- Ministria e Transportit dhe Ndërlidhjeve
- Agjencia për Zhvillim dhe Investime e Republikës së Maqedonisë
- Agjencia për Privatizim
- Agjencia për Komunikime Elektronike
- Byroja për Zhvillimin e Arsimit
- Byroja për Ekspertiza Gjyqësore
- Byroja për Turizëm
- Komisioni Rregullator për Energjetikë
- Qendra për Arsimimin e Kuadrit nga Fusha e Sigurisë
- Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim
- Fondi për Sigurim Pensional dhe Invalidor i Maqedonisë
- NP për Ekonomizim me Pyje “Pyjet e Maqedonisë” – Shkup
- NP për Furnizim, Transport dhe Shpërndarje të Gazit Natyror “GA – MA” – Shkup
- NP për Kryerje të Veprimtarive të Ekonomisë së Ujërave HS “Zletovica” – Probishtip
- NP për Ekonomizim me Ujëra “Lisiçe” – Veles
- Gjykata Themelore në Kratovë
- Gjykata Themelore në Kumanovë
- Gjykata Themelore në Negotinë
- Gjykata Themelore Shkup 2
- INP – Burgu – Shkup
- INP – Burgu – Manastir
- INP – Burgu – Gjevgjeli

<b>PASQYRË</b> <b>e institucioneve në të cilat fare s'ka të punësuar pjesëtarë të bashkësive të cilat nuk janë shumicë</b>
- Agjencia për Përkrahje të Sipërmarrësisë të Republikës së Maqedonisë
- Fondi për Sigurimin e Depozitimeve
- NP për Furnizim me Ujë Përmes Hidrosistemit "Liçeni i Dojranit"- Dojran i Vjetër
- NP e Ekonomisë Ujore "Fusha e Gjevgjelisë – Valandovës" – Gjevgjeli
- Gjykata Themelore e Kavadarit
- Gjykata Themelore e Radovishit
- Gjykata Themelore e Sveti Nikollës
- INP – Burgu – Shtip

**0,20 %**

nga numri i  
përgjithshëm i  
parashtresave të  
pranuara

## Mosdiskriminimi

Gjatë vitit 2005 pranë Avokatit të Popullit u dërguan 12 parashtresa, në të cilat qytetarët ankoreshin për sjellje diskriminuese, në të shumtën e rasteve nga fusha e marrëdhënieve të punës, përkatësisht kërkonin mbrojtje për shkak të mosrespektimit të parimit të përfaqësimit të drejtë dhe adekuat të pjesëtarëve të bashkësive, të cilat nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë. Pas zbatimit të procedurave përkatëse, në tre raste janë konstatuar cenime të të drejtave të qytetarëve, me ç'rast Avokati i Popullit ndërmoi masa përkatëse për mbrojtjen e të drejtave të tyre, nga të cilat raste njëri është zgjidhur pozitivisht, ndërsa për të tjerët procedura është në vijim.

Numri i vogël i parashtresave, në të cilat qytetarët përmendin se u janë shkurtuar të drejtat, përkatësisht se nuk kanë mund të realizojnë të drejta të caktuara për shkak të përkatësisë etnike, fetare apo përkatësie tjetër, nuk do të thotë se në Republikën e Maqedonisë diskriminimi nuk është prezent. Përkundrazi, informatat bëjnë me dije faktin se ekziston fenomeni i diskriminimit, por është në një formë të fshehur dhe rrallë herë shpaloset në publikë, kuptohet nga arsye të ndryshme, për shkak të frikës ose informimit të pamjaftueshëm të qytetarëve, përkatësisht pamundësisë të dallohet sjellja e cila implikon ose parashikon ekzistimin e sjelljes diskriminuese.

Duke e pasur parasysh gjendjen e këtillë si dhe: Direktivën 76/207 EEC të Këshillit të Unionit Evropian për barazi ndërmjet meshkujve dhe femrave, Direktivën 2000/43.EC (6), me të cilën jetësohet parimi i trajtimit të barabartë ndërmjet njerëzve, pavarësisht nga përkatësia racore apo etnike dhe Direktivën 2000/78/EC, me të cilën verifikohet korniza e përgjithshme për trajtimin e barabartë gjatë punësimit në fushat e përmendura, sipas kategorive të theksuara të personave, Avokati i Popullit konsideron se është e domosdoshme të miratohen rregulla përkatëse, të cilat do ta rregullonin këtë problematikë.

Konstatimi i këtillë rezulton nga fakti se në Republikën e Maqedonisë edhe më tej në jetën e përditshme shfaqen raste të sjelljes diskriminuese me elemente të ksenofobisë. Refuzimi dhe pamundësimi që pjesëtarët e bashkësisë etnike rome të kenë qasje deri te objektet e pronave private siç janë: objektet hotelerike – sportive dhe ngjashëm, ishin evidente gjatë vitit që raportojnë. Pas shkrimeve në mjetet e shkruara të informimit, Avokati i Popullit me iniciativë të vet iu drejtua

Inspektoratit Shtetëror të Tregut me kërkesë që të ndërmerren veprime për zbulimin e rasteve të diskriminimit të pjesëtarëve të bashkësisë etnike rome dhe parandalimin, përkatësisht sanksionimin e sjelljeve të këtilla.

Gjatë vitit për të cilin raportojmë, pranë Avokatit të Popullit arriti parashtresë nga pjesëtar i bashkësisë shqiptare, me të cilën kërkohej ndërhyrje për shkak të sjelljes diskriminuese të personave të punësuar në kafe barin “Blu kafe” – Shkup, të cilët kishin refuzuar ta shërbenin. Me këtë rast, Avokati i Popullit dhe Inspektorati Shtetëror i Tregut bënë inspektim, përkatësisht mbikëqyrje inspektuese, në kafe barin e përmendur.

Sikurse edhe në shumë raste paraprake edhe kësaj here tentimi për t’u konfirmuar se a ekziston diskriminim, mbeti i pasuksesshëm për arsye se nuk është miratuar Ligji për mosdiskriminim, në të cilin në mënyrë precize do të përkufizohej nocioni “diskriminim” si dhe organi i cili do të ishte kompetent për të ndërmarrë masa përkatëse për shmangien e pasojave nga sjellja diskriminuese. Në kontekst të kësaj mungesa e normave ligjore paraqet pengesë për realizimin konsekuent të të drejtave të qytetarëve. Konstatimin dhe përcaktimin e këtillë, Avokati i Popullit e prezantoi edhe në raportin paraprak, të cilin e dërgoi pranë Kuvendit të Republikës së Maqedonisë me rekomandim që Ligji për mosdiskriminim të miratohet sa më parë.

Nevojën për t’i dhënë përkrahje nxjerrjes së Ligjit për mosdiskriminim, Avokati i Popullit e paraqiti edhe në mbledhjen me përfaqësueset e të ashtuquajturit “Lobi i grave” në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, me ç’rast me më tepër organizata joqeveritare dhe një pjesë të ekspertëve juridikë, morën qëndrim se nxjerrja e këtij ligji është i domosdoshëm. Ndonëse në disa rregulla ligjore, siç është Ligji për marrëdhënie pune, janë inkorporuar dispozita që kanë të bëjnë me diskriminimin dhe përcaktohet diskriminimi i drejtpërdrejt dhe i tërthortë, miratimi i një Ligji për mosdiskriminim është i domosdoshëm sepse diskriminimin e hasim edhe në sfera të tjera.

Me ligjin e veçantë duhet të përkufizohet nocioni diskriminim, sferat në të cilat është e mundshme shfaqja e sjelljes diskriminuese, format e manifestimit të diskriminimit, përmendja e kryerësve të mundshëm dhe viktimave të akteve dhe veprimeve diskriminuese, mënyrat, format dhe organet, pranë të cilëve qytetarët mund të kërkojnë mbrojtje, të drejtat që mund të shfrytëzohen në rastet e cenimit, si edhe përkufizimi i përgjegjësisë së kryerësve të akteve dhe veprimeve apo mosveprimeve diskriminuese. Avokati i Popullit vlerëson se me miratimin e Ligjit për mosdiskriminim do të mundësohej zbatimi konsekuent i parimeve të proklamuar kushtetuese për barazi të qytetarëve për liri dhe të drejta, pavarësisht nga gjinia, raca, ngjyra, prejardhja sociale, besimi politik dhe fetar dhe pozicioni shoqëror e pronësor.

Gjatë vitit të kaluar, Avokati i Popullit mori pjesë edhe në hartimin e Projektligjit për mundësi të barabarta ndërmjet meshkujve dhe femrave, ku me propozime dhe sugjerime, të cilat u pranuan, kontribuoi në hartimin e tij. Sipas njohurive të fundit, Propozimligji për mundësi të barabarta ndërmjet meshkujve dhe femrave është në procedurë të Kuvendit dhe së shpejti pritet miratimi i tij.

Krahas aktiviteteve të theksuara dhe me qëllim të kapërcimit të problemeve, me të cilat ballafaqohen qytetarët gjatë realizimit të të drejtave të tyre, Avokati i Popullit ndërmerr masa për edukimin e tyre, duke e ngritur vetëdijen për realizimin e parimit të përcaktuar kushtetues për barazi të qytetarëve sa i përket të drejtave dhe lirive, me çka kontribuon për zbatimin e tij konsekuent.

Aktivitetet në drejtim të hartimit të broshurave me karakter edukativ dhe veprimit në media, me sukses do ta promovojnë përcaktimin e Avokatit të Popullit si mbrojtës të qytetarëve dhe ndërmjetësues, përkatësisht ndërmjetës gjatë zgjidhjes të të gjitha gjendjeve diskriminuese.

Njëkohësisht, për funksionimin më efikas të organeve dhe institucioneve në Republikën e Maqedonisë, për respektimin në përpikëri, realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive, ndërsa në këtë kuptim edhe parandalimin e shfaqjeve diskriminuese dhe të ksenofobisë, nevojitet edhe trajnimi i personave zyrtarë të punësuar në administratën publike. Në kontekst të kësaj janë edhe tentativat për ngritjen e vetëdijes së punonjësve në organet e institucioneve se me një bashkëpunim më të madh me Institucionin Avokati i Popullit do të kontribuojnë për punë të tyre më efikase.

# 12,81 %

nga numri i  
përgjithshëm i  
parashtresave të  
pranuara

## Procedimi policor dhe punë të tjera të rendit

Si mekanizëm kontrollues mbi punën e administratës publike, duke i kryer autorizimet e përcaktuara me ligj, Avokati i Popullit ka rol të rëndësishëm në mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të qytetarëve edhe në fushën policore dhe punëve të tjera të rendit. Mirëpo, sa i përket vëllimit dhe shkallës së cenimeve të të drejtave dhe lirive të njeriut, Avokati i Popullit këtë mund ta vlerësojë në bazë punimeve mbi lëndët gjatë procedimit sipas parashtresave të qytetarëve të pranuar në vitin për të cilin raportojmë dhe procedurat, të cilat në përputhje me ligjin i hapi me iniciativë të vet.

Gjatë realizimit të të drejtave kushtetuese dhe ligjore dhe plotësimit të detyrimeve ligjore, qytetarët e Republikës së Maqedonisë gjatë jetës së përditshme shpesh herë komunikojnë me organet dhe punonjësit e Ministrisë për Punë të Brendshme, me aktet, veprimet apo mosveprimet e të cilëve mund të vijë deri te cenimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Gjatë mbrojtjes të të drejtave dhe lirive themelore, gjatë cenimeve të bëra me akte apo veprime të organeve që janë në përbërje të Ministrisë për Punë të Brendshme ose punonjësve të asaj Ministrie, gjatë periudhës për të cilën raportojmë, pranë Avokatit të Popullit u drejtuan gjithsej 391 qytetarë, që paraqet rritje për thuaja se 50%, krahasuar me vitin paraprak, thuaja se një e katërta e tyre kanë të bëjnë me abuzimin e autorizimeve të ndryshme policore. Avokati i Popullit konsideron se numri i këtyre rritur i parashtresave i referohet kritikës publike të drejtuar në adresë të Sektorit për kontroll të brendshëm dhe standarde profesionale.

Duke vepruar në këtë pjesë, gjatë vitit raportues, në aspekt të kompetencave ligjore pati mendime kundërthënëse ndërmjet Avokatit të Popullit nga njëra dhe Ministrisë për Punë të Brendshme nga ana tjetër.

Përkatësisht në disa raste, në të cilat Avokati i Popullit konstatoi se ka cenim të të drejtave të njeriut me përdorim jashtëmase të forcës ose të mjeteve të detyrimit nga ana e personave zyrtarë, pjesëtarë të Njësisë për detyra speciale, Sektori për kontroll të brendshëm dhe standarde profesionale refuzoi t'ia jep të dhënat e kërkuara, duke iu referuar Ligjit për mbrojtjen e informatave të klasifikuara, me çka e degradon autorizimin e Avokatit të Popullit, sipas nenit 27 të Ligjit për Avokatin e Popullit, sipas të cilit të gjitha organet shtetërore detyrohen të bashkëpunojnë me Avokatin e Popullit dhe me kërkesë të tij t'ia dërgojnë të gjitha informatat dhe të dhënat, pa marrë parasysh shkallën e besueshmërisë.

Duke e pasur parasysh refuzimin e dhënies së informatave të kërkuara, e që do të thotë pengim në punë, Avokati i Popullit për këtë gjë e njoftoi publikun.

Ndonëse reagimi i këtyre u interpretua si përpjekje që disa struktura, përmes Avokatit të Popullit t'ia lidhin duart Ministrisë për Punë të Brendshme në orvatjet për ta luftuar dhe parandaluar kriminalitetin, ky hap u ndërmor në bazë të autorizimeve ligjore, sipas të cilave për pengimin e ushtrimit të funksionit, Avokati i Popullit mund ta njoftojë publikun, ndërsa qëllimi ishte që të bëhej trysni plotësuese mbi institucionet, të cilat gjatë kryerjes së kompetencave ligjore me apo pa vetëdije i cenojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

Avokati i Popullit edhe me këtë rast potencoi se qëllimi i vetëm gjatë ushtrimit të funksionit të tij është mbrojtja e të drejtave dhe lirive themelore të qytetarëve me profesionalizëm, tërësisht dhe me zbatim efektiv të detyrimeve ligjore dhe shfrytëzimin e të gjitha mjeteve të lejuara, ndërsa ndërhyrjet e tij nuk duhet dhe nuk guxojnë të kuptohen si qëllimkëqija apo si qëllim për bllokimin e punës së organeve shtetërore dhe organeve e organizatave mbi punën e të cilëve e kryen funksionin e mekanizmit kontrollues. Ndërhyrjet e Avokatit të Popullit kanë për qëllim dhe janë në funksion të

përmirësimin e të drejtave dhe lirive themelore të qytetarëve dhe ndërmerren kur ka ngecje në punën e mekanizmave të tyre të brendshëm kontrollues. Orvatjet e Avokatit të Popullit për ngritje permanente të veprimit të tyre profesional njëherit janë edhe qëndrime të organizatave ndërkombëtare prezente në Republikën e Maqedonisë.

Avokati i Popullit vlerëson se Sektori për kontroll të brendshëm dhe standarde profesionale, gjatë vitit raportues, nuk ishte në nivelin e detyrave dhe qëllimeve për të cilat është formuar dhe kjo ndodh për shkak të arbitrarizmit të tij në dobi të personave të autorizuar zyrtarë të Ministrisë për Punë të Brendshme. Sidomos, kjo vërehet gjatë vlerësimeve të rasteve të prezantuara, të mbështetura edhe me dokumente mjekësore për përdorim të dhunës, por ky Sektor prap nuk e pranon se i ka tejkalluar autorizimet e veta.

Duke e pasur parasysh sjelljen e këtyre joprofesionale, Avokati i Popullit në rolin e super revizorit, mbi bazë të autorizimeve ligjore, pranë prokurorive themelore publike në Shkup, Kumanovë dhe Shtip paraqiti 7 kallëzime penale kundër personave të autorizuar zyrtarë të Ministrisë për Punë të Brendshme, të cilët gjatë aplikimit të kompetencave të ndryshme i kanë tejkalluar autorizimet, dhe me përdorim jashtë mase të forcës kanë kryer vepra penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut dhe qytetarit.

Për këtë që u tha flasin të dhënat e gjykatave më të mëdha, përveç Gjykatës Themelore Shkup 2 – Shkup, e cila nuk u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit. Seksionet e tyre hetuese dhe penale, gjatë periudhës prej datës 01.01 deri më 31.12.2005 kanë vepruar në më tepër se 18 vepra të iniciuara nga qytetarë, ndaj të cilëve personat e autorizuar zyrtarë kanë kryer vepra penale kundër të drejtave dhe lirive të njeriut dhe qytetarit dhe në procedura për lëndime fizike të shkaktuara nga ana e personave të autorizuar zyrtarë të Ministrisë për Punë të Brendshme.

Në segmentet e tjera të punës me qytetarë, për problemet që kanë të bëjnë me statusin e shtetësisë, vendbanimit ose vendqëndrimin dhe evidencës amë apo procedurat për kthimin e sendeve përkohësisht të marra pas procedurës së përfunduar, ndonëse pranë organeve në Ministrinë për Punë të Brendshme edhe më tej procedurat zgjasin shumë, megjithatë dukshëm është përmirësuar respektimi dhe pranimi i ndërhyrjeve të Avokatit të Popullit, si edhe përmirësimi i gjendjes me respektimin e të drejtave të qytetarëve.

**30,40 %**

nga numri i  
përgjithshëm i  
parashtresave të  
pranuara

## Jurisprudenca

Karakteristikë kryesore, e vitit për të cilin raportojmë, nga aspekti i gjyqësisë është rritja jashtëzakonisht e madhe e numrit të parashtresave të parashtruara pranë zyrës së Avokatit të Popullit, si edhe i numrit të qytetarëve të cilët kërkuan pranim dhe bisedë të drejtpërdrejt në selinë dhe zyrat e njësisve rajonale të Avokatit të Popullit.

Të dhënat statistikore, të paraqitura në pasqyrimin tabelar, dëshmojnë se numri i parashtresave të regjistruara nga kjo fushë është për dy herë e gjysmë më i madh, krahasuar me vitet e kaluara dhe se nga numri i përgjithshëm i parashtresave 1/3 u përkasin çështjeve dhe problemeve me të cilat ballafaqohen parashtruesit në procedurat gjyqësore.

Rritja e evidentave të parashtresave në këtë fushë është rezultat i masave dhe veprimeve të marra nga ana e Avokatit të Popullit, kur për shkak të cenimeve të konstatuara të të drejtave dhe shkeljes së parimit “gjykim brenda afatit të arsyeshëm”, me iniciativë të tij u shkarkua një gjyqtar i



Gjykatës së Apelit në Shtip, por rritja e numrit të parashtrësive i referohet gjithashtu edhe ekipimit të kuadrit të zyrave rajonale të Avokatit të Popullit.

Megjithatë, duhet theksuar se edhe përkundër kufizimeve ligjore të autorizimeve të Avokatit të Popullit në fushën e gjyqësisë, ku qytetarët mund t'i mbrojnë vetëm nga zvarritjet e pajustificueshme të proceseve gjyqësore dhe nga kryerja e pandërgjegjshme dhe papërgjegjshme e punëve nga ana e shërbimeve gjyqësore, edhe më tej qytetarët në parashtrësitë e tyre kërkojnë që t'i rishikojë vendimet gjyqësore, duke iu referuar arbitrarizmit dhe ekzistimit të korrupsionit në gjyqësi.

Rezultatet, nga procedimi i Avokatit të Popullit, konfirmuan faktet e pamohueshme, të pranuar edhe nga faktorë të rëndësishëm të vetë gjyqësisë, si dhe të pushtetit ligjvënës dhe ekzekutiv, se në Republikën e Maqedonisë sistemi gjyqësor është e avashtë, sidomos në pjesën e kundërvajtjes, përmbaruese dhe në procedurat e falimentimit, se në pjesë të madhe gjyqësia është e korruptuar dhe jokompetente dhe si e tillë as qytetarëve e as subjekteve të tjera akoma nuk u siguron mbrojtje efektive gjyqësore të të drejtave të tyre kushtetuese dhe ligjore.

Anomalitë e këtilla, sikurse edhe ndryshimet e pjesshme të disa procedurave proceduese, gjatë periudhës pas pavarësimit të Republikës së Maqedonisë, na sollën deri te efektshmëria më e madhe e proceseve gjyqësore, afirmimi dhe realizimi i parimit *gjykim brenda afatit të arsyeshëm*.

Së këtejmi, gjendja objektive, me të cilën ballafaqohet pushteti gjyqësor në Republikën e Maqedonisë, e cila funksionon me strukturim joadekuat organizativ të gjykatave, përkundërit gjendjes dhe nevojës për specializimin e tyre në fusha të caktuara, pajisja joadekuate teknike dhe teknologjike, numri i pamjaftueshëm i kuadrit gjyqësor dhe personelit ndihmës edhe më tej sjell deri te përfundimi se normat ligjore nuk janë shkaku i vetëm i joefikasitetit të gjyqësisë dhe stërzgjatjes së procedurave, por se kontribut të madh kanë edhe elementet subjektive: mungesa e motivit për veprim profesional për shkak të pagave (që shkaktojnë edhe varësi nga qarqe të caktuara shoqërore me influencë, e që paraqet gjenerator për shfaqjen e dukurisë së korrupsionit), rënies në ndikimin e emocioneve, karakteristikë e kryerësve të funksionit në mjediset më të vogla, kompetencave të pamjaftueshme dhe mungesës së gatishmërisë për vetedukim etj.

Tejkalimi i dukurive të këtilla është parakusht kryesor për kthimin e besimit të humbur në gjyqësi dhe respektimin e vendimeve gjyqësore.

Rregullat e reja ligjore, të cilat i rregullojnë procedurat proceduese, sidomos Ligji për procedurë proceduese dhe Ligji për përmbarim, të cilët duhet të fillojnë të zbatohen gjatë vitit 2006, krijojnë bazë reale për procedura më racionale dhe më efektive të sistemit të gjyqësisë. Ndryshimet kushtetuese të Republikës së Maqedonisë i mënjantuan pengesat e fundit, të cilat ndikonin në realizimin e mëtutjeshëm të Strategjisë për reforma në sistemin gjyqësor dhe planin aksionar për zbatimin e tij, prandaj tani ngel vetëm jetësimi i mirëfilltë dhe i shpejtë në pjesën e riorganizimit të sistemit gjyqësor dhe në edukimin e zgjedhjes së gjyqtarëve më të mirë, nga radhët e kandidatëve potencial për ushtrues të këtij profesioni jashtëzakonisht të rëndësishëm dhe me peshë.

Dera, gjysmë e hapur e Bashkësisë Evropiane, do të mbetet vetëm gjysmë e hapur në qoftë se u gjuhëzohemi detyrave që kemi marrë dhe nëse qytetarëve dhe subjekteve të tjera një orë e më parë nuk u sigurohet siguria ligjore, që është njëra nga vlerat qenësore, jo vetëm të rregullimit kushtetues të Republikës së Maqedonisë, por në përgjithësi i çdo shoqërie demokratike, pra derisa qytetarët nuk ndejnë se jetojnë dhe veprojnë në shoqëri në të cilën *sundon drejtësia dhe funksionon shteti ligjor*.

Konstatimet e këtilla për gjendjen në gjyqësi, bazohen në konkluzionet që rezultuan nga puna me lëndë, si edhe nga opinioni i padiskutueshëm publik për gjendjen në këtë sferë të jetës shoqërore në Republikën e Maqedonisë.

Gjatë vitit raportues në llogari të funksionimit të ligjshëm të prokurorive publike në Republikën e Maqedonisë, pranë Avokatit të Popullit u parashtrua një numër tejet i vogël i parashtrësive, të cilat kishin të bënin me zvarritjen e procedurave sipas kallëzimeve penale, por duke iu falënderuar bashkëpunimit korrekt, sidomos të Prokurorisë Themelore Publike të Shkupit, Avokati i Popullit merrte informata të shpejta për rrjedhën dhe rezultatet e procedimit të tyre.

Gjatë proceseve, Avokati i Popullit ka konstatuar se shkaqet e zvarritjeve në procedimet e Prokurorisë Publike para së gjithash ndodhin për shkak të procedimit të mefshtë të organeve të Ministrisë për Punë të Brendshme, të cilat përgjigjet sipas kërkesave për njoftimet paraprake, prokurorit publik ia dërgojnë disa muaj më vonë.

Megjithatë, ndaj problemeve dhe gjendjeve me të cilat ballafaqohet pushteti gjyqësor nuk është imune as organizata e Prokurorisë Publike, prandaj dhe problemet e njëjta reflektohen edhe gjatë epilogut të procedurave gjyqësore, e ndonjë herë janë edhe shkak kryesor për parashkrim të ndjekjeve penale dhe në kohën e procedurës parapenale.

Për shkak të dyshimit të bazuar për tejkalim të autorizimeve zyrtare nga ana e personave të autorizuar zyrtarë të Ministrisë për Punë të Brendshme, gjatë vitit për të cilin raportojmë, Avokati i Popullit paraqiti 8 kallëzime penale pranë prokurorive themelore publike në: Shkup, Shtip dhe Kumanovë, nga të cilat njëra është hedhur poshtë, ngaqë prokurori publik nuk ka konstatuar se bëhet fjalë për vepër e cila ndiqet sipas shërbimit zyrtar. Sipas të tjerave procedura pranë prokurorive publike është në vijim.

Avokati i Popullit edhe nga ky organ pret rritje të efikasitetit dhe shkallë më të lartë të profesionalizmit gjatë veprimit dhe vendimmarrjes, sidomos sa i përket zbatimit të reformave që duhet të pasojnë gjatë periudhës së ardhshme në organizatën e prokurorisë publike, të cilat në masë të madhe do ta ndryshonin jo vetëm strukturimin e tyre organizativ, por edhe do të bënin ndryshim dhe rritje të kompetencave, pavarësi më të madhe nga pushteti ekzekutiv, dhe me këtë edhe efikasitet dhe profesionalizëm më të madh të organit, i cili mban autorizimin për zbulimin dhe ndjekjen e kryerësve të veprave penale.

Avokatia dhe noteria, si shërbime të veçanta, pranë të cilave qytetarët gjithashtu i realizojnë të drejtat dhe interesat e tyre, gjatë vitit të kaluar nuk janë përmendur si shkelës të të drejtave të tyre kushtetuese dhe ligjore. Shkak për këtë gjithsesi nuk është vetëm fakti se nga ana e tyre nuk është bërë asnjë shkelje e të drejtave të qytetarëve ose se tek ata çdo gjë funksionon në mënyrë të përkryer, por sigurisht nga fakti se noteriali zgjidh vetëm çështje jokontestimore dhe se lidhja, ndërmjet qytetarëve nga njëra dhe këtyre dy shërbimeve nga ana tjetër, ka karakter tjetër, nga ajo që kanë me gjyqësinë dhe prokurorinë Publike.

Arsyeja tjetër, se pse nuk janë regjistruar parashtresa në adresë të këtyre dy shërbimeve, sigurisht se është edhe informimi i pamjaftueshëm i qytetarëve se edhe në rastet e cenimit të të drejtave të tyre nga këto shërbime, mund të drejtohen për ndihmë pranë Avokatit të Popullit. Kjo vë në dukje se, sa i përket kësaj, Avokati i Popullit duhet t'i kushtojë vëmendje më të madhe edukimit të tyre.

Për dallim nga ata, pranë Avokatit të Popullit u paraqitën disa parashtresa të qytetarëve, të cilët u ankuan se Avokati Publik jo sa duhet i mbron interesat pronësore të Republikës së Maqedonisë në rastet kur bëhet fjalë për uzurpimin e tokës për ndërtim, e cila është pronë e shtetit, ndërsa i prek edhe të drejtat e tyre pronësore apo shfrytëzuese.

**1,57 %**

nga numri i  
përgjithshëm i  
parashtresave të  
pranuara

**Institucionet ndëshkimore -  
përmirësuese dhe entet  
përmirësuese - edukuese**

Avokati i Popullit, në bazë të autorizimeve ligjore për ta përcjellë gjendjen e respektimit të mbrojtjes të të drejtave kushtetuese dhe ligjore të personave të arrestuar dhe të paraburgosur dhe personave të cilët vuajnë dënimin me burg apo masën përmirësuese – edukuese nëpër institucionet ndëshkimore – përmirësuese ose entet përmirësuese – edukuese, si mekanizëm kontrollues mbi

punën e administratës publike dhe në funksion të realizimit të programit për punë, gjatë vitit 2005, bëri inspektim të përgjithshëm në pjesën më të madhe të institucioneve ndëshkimore përmirësuese në Republikën e Maqedonisë dhe në Entin Përmirësues – edukues në Tetovë.

Përshtypje e përgjithshme është se në sistemin penitenciar të Republikës së Maqedonisë, edhe përkrah disa masave të marra për përmirësimin e gjendjes në disa nga institucionet ndëshkimore – përmirësuese, vazhdon të ketë mangësi të mëdha. Shteti nuk krijon kushte të nevojshme për funksionimin e tij normal dhe kjo reflektohet negativisht mbi të drejtat kushtetuese dhe ligjore të të paraburgosurve dhe personave të dënuar dhe atyre nuk ju mundëson kushte për risocializim të mirëfilltë.

Prandaj, personat e dënuar edhe më tej kanë ndjenjën se gjenden në margjinat e shoqërisë dhe se dënimi është hakmarrje e shtetit për shkak të veprës së kryer.

Duke i pasur parasysh parimet e standardeve penologjike të sistemit penitenciar, i cili në planin normativ tërësisht korrespondon me sistemet e njëjta të shoqërive të zhvilluara demokratike dhe mungesën e programit gjithëpërfshirës për mposhtjen e dukurive dhe tendencave negative, siç janë zhvillimet e fundit në institucionet ndëshkimore – përmirësuese në Republikën e Maqedonisë, me të drejtë mund të konstatohet se gjendja, sa i përket aspektit të sigurisë së vuajtjes së dënimit me burg, gjatë vitit raportues, u paraqitë dukshëm e përkeqësuar me raste të shpeshta të qërim hesapeve me armë ndërmjet personave të dënuar ose rrëmbim të personave të privuar nga liria, ikje të të dënuarve, rritje të numrit të vetëvrasjeve, rritje të varësisë nga droga dehëse dhe alkooli të personave të dënuar etj. Në institucionet ndëshkimore – përmirësuese sikurse edhe në Entin Përmirësues – Edukues në Tetovë, gjithashtu u regjistruan një varg dukurish negative, të cilat përcillen vite me radhë, ndërkohë që janë rezultat i mungesës kronike të mjeteve financiare të domosdoshme për përmirësimin dhe rregullimin e kushteve hapësinore dhe pajisjes teknike, ekipimit të pamjaftueshëm të kuadrit nga aspekti i funksionimit profesional dhe të sigurisë në institucione, profesionalizimit të pamjaftueshëm të personave të inkuadruar në procesin riedukues, ndërkohë që mungon edhe mbikëqyrja në vazhdimësi e organeve kompetente të përcaktuara me ligj.

Edhe përkundër asaj se nuk janë regjistruar forma më të rënda të torturës dhe forma të tjera të dhunës ndaj personave të dënuar, megjithatë janë të pranishme dukuritë e incidenteve me përdorim të forcës, për të cilën pohohet se praktikohet në funksion të ruajtjes së rendit në institucione, si edhe dukuritë dhe anomalitë, të cilat nuk korrespondojnë me nevojat për funksionimin e procesit konsistent të risocializimit të personave të dënuar. Është vërejtur se në një numër më të madh të institucioneve ndëshkimore – përmirësuese, me përjashtim të institucionit ndëshkimit – përmirësues të Burgut - “Shtip” dhe Seksionit të hapur të Burgut “Manastir” në Prilep, personat e dënuar dhe të paraburgosur, masën e paraburgimit apo dënimit me burg e vuajnë në kushte johumane (mobile të shkatërruara, prezencë të brumbujve dhe kandrave të neveritshme, higjienë të pamjaftueshme, ndriçim të dobët, lagështirë në lokale, gjumë në dysheme ose korridore) me çka cenohet dinjiteti njerëzor dhe nuk mundësohet zbatimi i procesit për risocializim të mirëfilltë dhe adaptim social.

Janë shënuar dobësi në kuptimin e sasisë dhe cilësisë së ushqimit, mungesës së takëmeve dhe inventarit në lokalet e mensës dhe për këtë arsye shpesh herë ndodhë që, personat e dënuar dhe të paraburgosur, ushqimin ta marrin nga jashtë dhe ta ruajnë në kushte të papërshtatshme.

Numri më i madh i institucioneve ndëshkimore – përmirësuese nuk kanë në dispozicion sasi të mjaftuar e as cilësi të veshmbathjes dhe shtrojës dhe mirëmbajtja e tyre nuk kënaq, prandaj kjo kalon si obligim i personave të dënuar dhe të paraburgosur. Të dënuarit e kanë të vështirë komunikimin me telefon me botën jashtë burgut, për shkak të numrit të pamjaftueshëm të foltoreve telefonike ose kufizimit të shfrytëzimit të tyre në periudhë të caktuar të ditës. Ata, jo sa duhet angazhohen në punë, ndërsa ata që janë të angazhuar nuk paguhen në përputhje me ligjin.

Për shkak të numrit të pamjaftueshëm të personave profesionistë të shërbimeve për riedukim dhe menaxhimin të dobët me resurset ekzistuese të kuadrit (psikologë, pedagogë, punonjës social dhe instruktorë), procesi i riedukimit nuk e përmbush funksionin e tij në mënyrë të mirëfilltë.

Mbrojtja shëndetësore e të dënuarve dhe të paraburgosurve nuk i kënaq nevojat e tyre për shkak të sistemit joadekuat të mbrojtjes shëndetësore dhe numrit të vogël të mjekëve të angazhuar, të cilët punojnë mbi bazë të kontratës për vepër.

Qëndrimi në ajër të pastër i të dënuarve dhe të paraburgosurve nuk është në përputhje me ligjin, e që arsyetohet me numrin e madh të personave të dënuar apo të paraburgosur, përkundrejt numrit të punonjësve të shërbimit të sigurimit.

Dhe përfundimisht, fakti i cili nuk kontestohet nga institucionet e as nga Drejtoria për ekzekutimin e sanksioneve, është prezenca e drogës, alkoolit dhe armëve, e që kanë ndikim jashtëzakonisht të madh negativ nga aspekti i sigurisë së institucioneve.

Kjo që u tha është vetëm një pjesë e dobësive të konstatuara gjatë inspektimeve nëpër institucionet ndëshkimore – përmirësuese të Republikës së Maqedonisë, për të cilat kontribuojnë jo vetëm mundësitë e kufizuara materiale të cilat i kanë në dispozicion, por edhe menaxhimi i dobët me resurset ekzistuese të kuadrit.

Duhet theksuar se gjatë vitit për të cilin raportojmë, nga disa institucione ndëshkimore – përmirësuese janë bërë përpjekje për pengimin e punës së Avokatit të Popullit.

Sidomos, si rast karakteristik duhet përmendur pengimin e zëvendësit të Avokatit të Popullit të zyrës rajonale të Shtipit, të cilit drejtori i Institutit Ndëshkimesor – Përmirësues i Burgut “Shtip”, nuk i mundësoi takim me person të paraburgosur me justifikim se nuk ka leje nga gjyqtari hetues dhe se nuk posedon certifikatë për shfrytëzimin e informatave të klasifikuara.

Ndonëse problemi u tejkalua, me vënien në pah të dispozitave të Ligjit për Avokatin e Popullit, në të cilin përfshihen kompetencat e tij dhe autorizimet kur bëhet fjalë për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese dhe ligjore të personave të dënuar dhe të paraburgosur, megjithatë kjo gjithsesi na sjell deri te përfundimi se madje edhe personat udhëheqës, në disa institucione të shtetit, nuk i njohin sa duhet normat ligjore, të cilat në funksionin për të cilin janë zgjedhur apo emëruar, duhet t'i zbatojnë gjatë punës së tyre të përditshme.

E gjithë kjo vë në dukje se sistemi penitenciar në Republikën e Maqedonisë është i ngarkuar me numër të madh të problemeve dhe se nuk funksionon në përputhje me Ligjin për ekzekutimin e sanksioneve. Ndonëse në planin normativ sistemi i ekzekutimit të sanksioneve themelohet mbi parimet e humanizmit, vlerave morale, drejtësisë dhe respektimit të personalitetit të njeriut dhe dinjitetit, në praktikë institucionet e sistemit, të ngarkuara për zbatimin e normave ligjore dhe nënligjore, që kanë të bëjnë me personat e dënuar dhe të paraburgosur, këtë kategori e kanë hedhur në margjinat e shoqërisë duke mos i kushtuar rëndësi, me çka i cenojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

**13,20 %**

nga numri i  
përgjithshëm i  
parashtrësive të  
pranuara

## Marrëdhëniet pronësore – juridike

Një nga segmentet esenciale të marrëdhënieve pronësore – juridike, në të cilin Avokati i Popullit, në kontekst të kompetencës së caktuar, ndërmerr veprime me qëllim të mbrojtjes së qytetarëve, është procedura për shqyrtimin dhe vendimmarrje sipas kërkesave për denacionalizim në shkallë të parë dhe të dytë.

Është karakteristike se organi për denacionalizim – Ministria e Financave, me komisionet përkatëse për denacionalizim thuaja se fare nuk u përmbahet dhe nuk i respekton afatet për marrjen

e vendimit sipas kërkesave të paraqitura, edhe pse në përputhje me dispozitat e parapara me Ligjin për denacionalizim procedurat e këtilla trajtohen si urgjente.

Gjithashtu, nuk janë të rralla rastet, kur edhe përkundër miratimit të akteve administrative të plotfuqishme dhe të prera, me të cilat kërkesat e paraqitura merren në konsideratë, t'u shmangen detyrimit për marrje të veprimeve me qëllim të përmbarrimit të tyre dhe dorëzimit në zotërim të drejtpërdrejt të pronës së kthyer – denacionalizuar, tek pronarët e mëparshëm, përkatësisht trashëgimtarët të tyre.

Krahas kësaj, fakt i pamohueshëm është se ekziston mosndërmarrje në vazhdimësi e veprimeve sipas shkresave të paraqitura nga Avokati i Popullit (kërkesa, rekomandime, udhëzime e ngjashëm) që kanë të bëjnë me procedurën për shqyrtim dhe vendimmarrje sipas kërkesave për shpronësim, si edhe rastet kur komisione të caktuara përgjigjet i dërgojnë thjeshtë sa për formalitet, me njoftimin se procedura për kompletimin e kërkesës është në vijim, se pritet mendimi i Komisionit për verifikimin e funksionalitetit të patundshmërive të nacionalizuara ose nga Komisioni për koordinim, se ndonjë komision fare nuk punon dhe ngjashëm. Gjendja e këtillë sjell deri te ngecja në punë dhe pamundësi i realizimit të të drejtave të qytetarëve – parashtrues të parashtrësve.

Karakteristikat e procedurës në shkallë të parë:

- joefektivitet, joracionalitet, jofunksionalitet dhe moskryerje me kohë e punëve, me tendencë të theksuar për pengimin e realizimit të të drejtave dhe interesave të drejtpërdrejta ligjore të palëve në procedurë;
- avashllëk, burokraci e theksuar dhe shkallë e lartë e subjektivitetit gjatë procesit të procedurës administrative;
- sjellje jokooperative dhe joprofesionale ndaj subjekteve të përfshira në procedurë që shkakton pasoja të dëmshme për qytetarët – palë në procedurë;
- zbatim jo i barabartë i rregullave dhe ngjashëm.

Procedurën në shkallë të parë dukshëm e ndërlikojnë dhe zvarrisin edhe vetë komisionet brenda Ministrisë së Financave, të formuara me qëllim të dhënies së këshillave për çështje të caktuara, por që nuk kanë karakter vendimmarrës sipas kërkesave për denacionalizim, të cilët vetë vlerësojnë për vendimmarrje ligjore të lëndëve. Gjithashtu, zvarritjen e bëjnë edhe organet e organizatat e tjera të shtetit që kanë autorizime publike dhe që janë të përfshira në procedurën e denacionalizimit.

Në të vërtetë, të gjitha vendimet në formë të projektvendimeve ose konkluzioneve për shkak të miratimit të tyre, së pari detyrimisht duhet të dërgohen deri te i ashtuquajturi Komision për kontroll, i cili vërejtjet e tij i jep pa kurrfarë forme dhe përmbajtje. Ai këtë e bën në një letër të rëndomtë, në të shumtën e rasteve me tekst të shkruar me dorë. Nuk janë të rralla rastet kur nga disa herë, vite me radhë ky komision sugjeron që kërkesat për denacionalizim të refuzohen si të pabaza ndonëse është më se e qartë se një vendim i tillë do të ishte rezultat i zbatimit të gabuar të të drejtës materiale – dispozitave që parashikohen me Ligjin për denacionalizim, me çka vërtetohen interpretimet juridike të paraqitura nga organi i shkallës së dytë ose nga Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë, e që jepen në kontekst të vendimeve të marra sipas ankesave ta paraqitura ose padive për konteste administrative për lëndët me gjendje të njëjtë ose të ngjashme faktike dhe juridike të punëve.

Kjo sidomos ka të bëjë për sa i përket çështjes së zbatimit të nenit 8, paragrafit 1 të Ligjit për denacionalizim, për çka nga ana e Komisionit për koordinim të punës së komisioneve, të cilët vendosin sipas kërkesave për denacionalizim është lëshuar Udhëzimi për punë i evidentuar nën nr. KKD 03/sl., sipas të cilit kërkesat për denacionalizim duhet të refuzohen me arsyetim se lëndë e denacionalizimit nuk është prona e marrë për të cilën është paguar, përkatësisht për të cilën është dhënë kompensim, me ç'rast organi i shkallës së parë vetëm duhet të konstatojë se për pronën e marrë – lëndë e denacionalizimit, pronarit të mëparshëm i është caktuar kompensimi, pa marrë parasysh apo pa e verifikuar se vallë brenda kohe kompensimi i caktuar a i është paguar, përkatësisht dhënë edhe pse për zbatimin e dispozitës së cituar nuk mjafton që kompensimi vetëm të caktohet, por pronarit të mëparshëm ai duhet t'i paguhet. Udhëzimi i këtillë është në kundërshtim me ligjin dhe është në dëm të qytetarëve, parashtrues të kërkesave për denacionalizim. Ky është shembull i interpretimit të gabuar dhe tendencioz i dispozitës së cekur të Ligjit për denacionalizim.

Me qëllim të tejkalimit të gjendjes së këtillë, Avokati i Popullit dërgoi mendim juridik deri te ministri i Financave, me ç'rast edhe pse nga Komisioni për koordinim u informua se organi për denacionalizim në tërësi do ta ketë parasysh përmbajtjen e tij, edhe më tej vazhdohet me praktikën e vënë, duke e zbatuar gabimisht dispozitën e cituar dhe mënyrën me të cilën Komisioni për kontroll nuk i miraton projektvendimet e komisioneve që marrin vendime sipas kërkesave për denacionalizim, kështu që lëndët vite me radhë gjenden në procedurën e shkallës së parë.

Edhe pse për raste të këtilla dhe të ngjashme, disa herë është njoftuar ministri i Financave, i cili së paku sipas dijenive që ka Avokati i Popullit deri tani nuk janë ndërmarrë kurrfarë veprimesh për tejkalimin e problemeve. Sjellja e këtillë është në kundërshtim me nenin 15 të Ligjit për denacionalizim, sipas të cilit ministri i Financave drejtpërdrejt është kompetent dhe vetëm ai përgjigjet për rrjedhën e procedurave për denacionalizim, përkatësisht për zbatimin konsekuent dhe respektimin e dispozitave të Ligjit për denacionalizim.

Në rastet kur janë marrë akte përmbareuese të plotfuqishme dhe të prera, me të cilat kërkesat e qytetarëve për kthimin e pronës së patundshme të nacionalizuar janë marrë në konsideratë, me pretekste të ndryshme u shmangen detyrimeve për marrjen e masave për përmbarrimin e tyre dhe dorëzimin në zotërim të drejtpërdrejt tek pronarët e mëparshëm, përkatësisht trashëgimtarët e tyre juridikë dhe lëndët për kohë më gjatë ruhen pa vepruar fare sipas tyre. Së këtejmi, nuk respektohen aspak rregullat e procedimit dhe në kontekst të Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative, në qoftë se organi konsideron se përmbarrimi do të shkaktojë dëm të pakompensueshëm mbi të drejtat e personave të tretë apo shtetin, në asnjë rast nuk miratohet akt administrativ përkatës - konkluzion, me të cilin përkohësisht do të shtyhej përmbarrimi, dhe kështu qytetarit do t'i sigurohej shfrytëzimi i të drejtës së garantuar për ankesë.

Ekzistojnë aktvendime përfundimtare dhe të plotfuqishme për denacionalizim, të cilat nuk përmbroheshin me arsyetimin se në pronën e denacionalizuar (shtëpi apo banesë) jetojnë persona, të cilëve shteti në përputhje me nenin 70 të Ligjit për denacionalizim duhet t'ju ndajë banesë tjetër, por imponohet fakti se të njëjtat mund t'i shfrytëzojnë më së shumti një vit, duke llogaritur nga momenti kur, në përputhje me dispozitat e ligjit të cekur, pronari i mëparshëm apo trashëgimtari i tij ligjor ka fituar të drejtën e kthimit të banesës.

Gjatë sigurimit të kësaj të drejte është përfshirë edhe i ashtuquajtimi Komision për caktimin e pronës reale, por nga analizimi i lëndëve vihet re se ky komision nuk shënon kurrfarë rezultatesh në punë, por sjell vetëm pasoja të dëmshme për shtetin sepse qytetarët, të cilëve duhet t'u kthehet në zotërim prona e denacionalizuar fitojnë të drejtën që në mënyrë plotësuese, me kërkesë, ta padisin shtetit duke kërkuar kompensim të dëmit.

Siç u përmend në fillim, Avokati i Popullit vepron edhe mbi parashtrësat të cilat sipas përmbajtjes së tyre kanë të bëjnë me sigurimin e realizimit efikas dhe mbrojtjes të të drejtave të qytetarëve gjatë procedurave për shqyrtim dhe vendimmarrje të mjeteve të tyre të rregullta ligjore – ankesat, të parashtruara kundër akteve administrative të marra në shkallë të parë nga ana e komisioneve për vendosje sipas kërkesave për denacionalizim të Ministrisë së Financave.

Në kontekst të kësaj, gjatë vitit të shkuar me shkresa – kërkesa, mendime, rekomandime apo udhëzime, Avokati i Popullit më tepër herë iu drejtua Komisionit për vendosje në procedurë administrative në shkallë të dytë nga fusha e denacionalizimit.

Njëkohësisht për gjendjen e përgjithshme të konstatuar, disa herë me informata të veçanta e informoi sekretarin dhe kryetarin e komisionit përkatës, me ç'rast nuk kontestohet fakti se pas marrjes së veprimeve të këtilla për një pjesë të vogël të lëndëve Komisioni mori vendime.

Megjithatë, analiza e zhvillimeve të përgjithshme, sjellë deri te përfundimi se në kontinuitet ekziston mosndërmarrja e veprimeve sipas shkresave të dërguara nga Avokati i Popullit, që kanë të bëjnë me këtë procedurë, e që nga ana tjetër pengon punën dhe pamundëson realizimin e të drejtave të qytetarëve – parashtrues të parashtrësive.

Për sa i përket punës së organit administrativ të shkallës së dytë, në start duhet të potencohet se që nga fillimi e deri nga mesi i vitit 2005, ky komision nuk ka funksionuar fare, me justifikimin se nuk ka kryetar, se duhet të shtohet stafi kadrovik dhe ngjashëm. E që rezultonte me lëndë të pazgjidhura, të paraqitura me mjete ligjore, të cilat thënë më shkurt nuk janë zgjidhur vite me radhë,

ndërsa ajo që është më karakteristike dhe alarmante nuk mund të verifikohet as numri i lëndëve që gjendet në komisionin e shkallës së dytë.

Gjendja u ndërlikua edhe më tepër edhe për shkak të mossigurimit të kushteve për kryerje të shpejtë dhe me azhurnitet të punëve dhe kjo bëri që për një periudhë të mos ketë kush të bëjë pranimin e dokumenteve dhe akteve të tjera nga palët, përfshirë edhe shkresat e Avokatit të Popullit, të cilat duhej t'i dorëzoheshin personalisht sekretarit të Komisionit.

Në të vërtetë, sipas informatave që i arrijnë Avokatit të Popullit, akoma nuk ekziston sekretari përkatëse, ku mund të merren apo sigurohen të gjitha të dhënat, sa i përket numrit të ankesave të paraqitura, numrit të lëndëve të formuara, akteve të regjistruara, inspektimi në aktet e lëndëve të formuara dhe radhitja kronologjike, sipas të cilës janë pranuar lëndët, klasifikimi i punës, radha e zgjidhjes së lëndëve, vendimet e marra dhe dita e kthimit të tyre pranë organit administrativ të shkallës së parë apo madje dita e dërgimit të akteve pranë Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë, në kontekst të padisë së paraqitur për hapjen e kontestit administrativ pranë Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë.

Nga këto shkaqe edhe për procedurat lidhur me ankesat e paraqitura pranë Komisionit për vendosje në procedurë administrative të shkallës së dytë nga fusha e denacionalizimit, karakteristike është:

- joefektiviteti, joracionaliteti, jofunksionaliteti dhe moskryerja me kohë e punëve e përcjellë me zvarritje të pajustificueshme të procedurës sipas mjeteve të paraqitura ligjore;
- mosorganizimi i tërësishëm i punës nga çasti i pranimit të ankesës, së bashku me aktet e lëndës e deri në zgjidhjen përfundimtare, që rezulton me humbjen e lëndëve të tëra dhe mospasjen e evidencës për të njëjtat;
- avashllëku, burokracia jashtë mase dhe shkalla e lartë e subjektivitetit gjatë kryerjes së procedurës administrative me mosrespektimin e afateve të caktuara ligjore për marrjen e vendimit;
- sjellja joprofesionale dhe jokooperative ndaj subjekteve të përfshira në procedurë dhe me këtë shkaktim të pasojave të dëmshme për qytetarët – palë në procedurë;
- zbatimi jo i barabartë i rregullave;
- Komisioni, Avokatit të Popullit nuk ia dërgon sqarimet, informatat dhe provat e kërkuara, nuk e njofton për masat e ndërmarra për zbatimin e kërkesave, propozimeve, mendimeve, rekomandimeve ose udhëzimeve, e as nuk ia dërgon vendimet e marra.

Gjithashtu, ndonëse për mosveprimin sipas lëndëve konkrete, si edhe gjendjen e konstatuar të përgjithshme me mosmarrjen e veprimeve sipas intervenimeve të Avokatit të Popullit, me informata të veçanta janë njoftuar sekretari dhe kryetari i Komisionit përkatës, si edhe Qeveria e Republikës së Maqedonisë, sipas parashtrimit të mjeteve ligjore akoma nuk kanë marrë vendime. Së këtejmi, padyshim rezulton se asnjëri nga organet nuk kanë ndërmarrë veprime për kapërcimin e gjendjes së këtyllë.

Lidhur me gjendjen e realizimit të të drejtës së privatizimit të tokës për ndërtim, e pamohueshme është se në fillim të vitit 2005 është miratuar Ligji për privatizim dhe qiramarrje të tokës për ndërtim në pronësi të shtetit, por duhet theksuar se Ligji nuk funksionon, përkatësisht se gjatë gjithë vitit zbatimi i tij nuk ka mund të fillojë ngaqë nga ana e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë akoma nuk janë miratuar rregullat nënligjore, me të cilat duhet të rregullohet lartësia e kompensimit për tokën e ndërtimit që është lëndë e privatizimit, si edhe mënyra e procedurës për arkëtimin e kompensimit për privatizim, përkatësisht me vonesë është miratuar vetëm akti, me të cilin caktohet rajonizimi i zonave në qytetet dhe vendbanimet e Republikës së Maqedonisë.

Në pjesën e procedurave për sigurimin e të drejtave të qytetarëve, në kuptimin e dispozitave të Ligjit për tokë ndërtimore, Avokati i Popullit pranë Sektorit për dokumentim dhe rregullimin e tokës për ndërtim, në Ministrinë e Transportit dhe Ndërlidhjeve dhe pranë Komisionit për vendosje në procedurë administrative të shkallës së dytë nga fusha e marrëdhënieve pronësore – juridike dhe tokës për ndërtim, në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë nuk has në kurrfarë bashkëpunimi sepse për asnjë lëndë nuk ka marrë përgjigje për veprimet apo vendimet e marra.

Për sa i përket procedurave për regjistrimin e të drejtave të patundshmërisë në kadastrën e patundshmërive, përkatësisht të tokës, edhe më tej qëndron konstatimi i deklaruar disa herë se ato

në vazhdimësi zvarriten, se ekziston joprofesionalizëm i punonjësve, sjellje injorante dhe mosrespektim i skajshëm sa u përket ndërhyrjeve të Avokatit të Popullit, sidomos nga ana e Sektorit për matje dhe kadastër në Shkup, për të cilin kanë të bëjnë thujta se të gjitha parashtresat e parashtruara dhe nga ana e organit administrativ të shkallës së dytë – Komisionit për vendosje në shkallë të dytë sipas lëndëve nga fusha e matjes, kadastrës dhe regjistrimit të të drejtave mbi patundshmëri në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë. Në këtë segment, të gjitha konstatimet e përmendura më parë e që kanë të bëjnë me organin e shkallës së parë dhe shkallës së dytë për denacionalizim, njëkohësisht kanë të bëjnë edhe për këto organe administrative.

**6,03 %**

nga numri i  
përgjithshëm i  
parashtresave të  
pranuara

## Urbanizmi dhe ndërtimtaria

Rregullimi dhe humanizimi i hapësirës është pjesë e jetës shoqërore, i cili ligjërisht është i rregulluar tërësisht. Megjithatë, qytetarët ballafaqohen me numër tejet të madh të problemeve, të cilat janë rezultat të: normave ligjore jokonsistente dhe zbatimit të tyre dhe shpërndarjes jo të plotë të kompetencave ndërmjet pushtetit qendror dhe lokal e që krijon hapësirë për joefikasitet dhe korrupsion në administratën publike. Kjo rezulton me kaosin urban me çka qytetarëve, në kundërshtim me atë që deklarohet, u cenohen të drejtat dhe liritë themelore të jetesës në hapësirë të rregulluar dhe humane.

Gjendjet e këtilla, janë arsyt kryesore, për shkak të të cilave edhe gjatë vitit për të cilin raportojnë, në zyrën e Avokatit të Popullit u pranua numër i madh i parashtresave, në të cilat parashtruesit ankoreshin për funksionim joefikas të administratës publike të pushtetit qendror dhe lokal, në rastet kur ajo është dashur të paraqitet në shërbim të tyre gjatë procedurave për miratimin e planeve urbanistike, marrjeve të lejeve për ndërtim, zbatimit të akteve administrative për ndërtimet pa leje, me të cilat preken të drejtat e pronës dhe të drejtat e tjera ose gjatë plotësimit të detyrimeve për ndërtim të rrugëve dhe lidhjen e rrugicave.

Në parashtresa, qytetarët me të drejtë shpesh herë thirreshin në korrupsionin dhe shfrytëzimin e pozitës shoqërore të individëve të pushtetit qendror dhe lokal, si një ndër të këqijat shoqërore më të mëdha edhe në këtë segment të shoqërisë maqedonase. Ndërkaq, se e kanë me të drejtë dëshmon edhe kaosi i krijuar me numër të madh të ndërtimeve pa leje në mjediset urbane dhe në lokalet e parapara për sipërfaqe të blerta, madje edhe nëpër parqe nacionale në territorin e mbarë vendit, veçmas në kryeqytetin e shtetit.

Me Ligjin për ndërtim, të cilin e miratoi Kuvendi i Republikës së Maqedonisë dhe i cili u fuqizua më 01.07.2005, me çka u ndërpre vlefshmëria e Ligjit për ndërtim të objekteve investuese, pjesa më e madhe e kompetencave nga sfera e urbanizmit dhe ndërtimtarisë iu bartë organeve të njësive të vetadministrimit lokal. Mirëpo, përvoja gjashtëmujore e zbatimit tij, sipas parashtresave të pranuar në zyrën e Avokatit të Popullit, në gjysmën e dytë të vitit, dëshmoi se njësitë e vetadministrimit lokal u gjetën të papërgatitura që menjëherë dhe me efikasitete të transformohen në shërbim efikas, kështu që barrierat e deritanishme të realizimit të të drejtave që i kishin qytetarët në organet e pushtetit qendror në fushën e urbanizmit janë prezentë edhe pranë organeve të njësive të vetadministrimit lokal.

Njësitë e vetadministrimit lokal, në përputhje me Ligjin për ndërtim, tërësisht apo pjesërisht i pranuan punonjësit e njësive në njësitë rajonale të Ministrisë së Transportit dhe Ndërlidhjeve, ndërsa disa kryetarë të komunave, jo vetëm që nuk arritën ta ndryshojnë mentalitetin e tyre, por tentojnë që pozicionin e vet ta shfrytëzojnë për vetvete ose për të tjerët, më së shpeshti në bashkëpunim me biznese të ndryshme dhe elita të tjera të shoqërisë.



Pikërisht kjo sjellje inerte e organeve të inspektimit (të cilat tanimë gjenden në përbërje të njësisive të administratës lokale, si edhe pamundësia që organet gjyqësore të jenë korrektuese të mirëfillta mbi punën e administratës publike), bën që edhe më tej një nunër i madh i qytetarëve të kërkojnë mbrojtje të të drejtave të tyre duke iu drejtuar Avokatit të Popullit. Së këtejmi mund të përfundohet se, normat e deritanishme ligjore nuk kanë qenë shkak i vetëm i problemeve dhe barrierave me të cilat janë përballuar qytetarët gjatë realizimit të të drejtave të tyre në fushën e urbanizmit dhe ndërtimitarisë por, megjithatë shkak i është tek faktori njeri.

Qasja seleksionuese gjatë shembjeve të ndërtimeve pa leje, të cilin Avokati i Popullit e ka vënë në dijeni edhe në raportet vjetore të viteve të kaluara, që gjatë periudhës së shkuar ka qenë karakteristike për Inspektoratin Shtetëror për Urbanizëm dhe Ndërtimtari, vazhdon edhe më tej por tani këtë e bëjnë organet inspektuese të komunave dhe me përkrahje të kryetarëve të komunave, të cilët madje publikisht deklarojnë se përparësi i japin interesit publik, por kur kjo i prekë drejtpërsëdrejti interesat individuale, atëherë me lehtësi i referohen mungesës së mjeteve për përmbarrim.

Nga kjo mund të konstatohet se edhe më tutje nuk ka gatishmëri për ndryshime radikale të ndërgjegjes ose për ballafaqimin e plotë me kompetenca, të cilat në këtë fushë i merr përsipër çdonjëri që gjendet në administratën publike e sidomos ata të cilët qëndrojnë në krye të hierarkisë së saj.

Këtë na e pasqyrojnë të dhënat e ofruara në tabelë e që kanë të bëjnë me parashtrësia të pranuar, të zgjidhura dhe lëndë që kanë qenë në punë gjatë vitit raportues në zyrën e Avokatit të Popullit. Nga 19 parashtrësia vetëm në gjashtë raste organet, të cilat kanë vendosur në fushën e urbanizmit dhe ndërtimitarisë, i kanë pranuar ndërhyrjet e Avokatit të Popullit, ndërsa në rastet e tjera ose nuk janë deklaruar ose mosveprimin e kanë justifikuar me gjendje objektive.

Sa i përket gjendjeve me cenimet individuale të të drejtave të qytetarëve pranë organeve në përbërje të Ministrisë së Transportit dhe Ndërlidhjeve, si edhe për gjendjen e përgjithshme në fushën e urbanizmit dhe ndërtimitarisë, Avokati i Popullit pranë ministrit të këtij resori, gjatë vitit për të cilin raportojmë, dërgoi 10 informata, por as ato, sikurse edhe të tjerat më parë, me të cilat vazhdimisht viheshin në dukje problemet e njëjta, deri më tani nuk i kanë dhënë rezultatet e pritura.

Problemet e shpalosura gjatë realizimit të të drejtave të qytetarëve në fushën e urbanizmit dhe ndërtimitarisë, e sidomos rastet e zbatimit të gabueshëm të normave ligjore, për shkak të jokompetencës ose si rezultat i sjelljes korruptive nga ana e organeve që vendosin, janë arsye që qytetarët të kërkojnë mbrojtje gjyqësore pranë Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë, me çka ngarkohet puna e këtij organi gjyqësor, i cili nga ana tjetër sipas përvojës së deritanishme edhe në rastet kur janë krijuar kushte, nuk vendosë në mënyrë të meritueshme, me çka mbase e realizon funksionin e kontrollit, por jo edhe të mbrojtësit gjyqësor nga aktet paligjshme të organeve administrative.

**0,75 %**

nga numri i  
përgjithshëm i  
parashtrësive të  
pranuara

**Mjedisi**

Gjatë viteve të kaluara, që nga periudha e transicionit të shoqërisë maqedonase, si rezultat i derdhjes së investimeve të huaja erdhi deri te riaktivizimi i kapaciteteve më të mëdha industriale, kombinateve metalurgjike – kimike: “Silmak”, “Mak – Stil”, “Ballkan – Stil”, “Fenimak”, fabrika e çimentos “Usje”, me eksploatimin e pasurisë xeherore vazhduan me punë edhe disa xeherore dhe kështu të gjitha ato si edhe centralet termoelektrike në Manastir dhe Oslomej dhe puna e

kapaciteteve të tjera më të vogla, u bënë burim potencial për emetimin e substancave të cilat në masë të konsiderueshme mund të sjellin deri te çrregullimi dhe degradimi i natyrës dhe ndotja e mjedisit.

Nëse është e padiskutueshme se mjedisi i shëndoshë është parakusht për ekzistimin e botës bimore dhe shtazore, do të thotë se edhe njeriu, krahas stuhive natyrore, si qenie e vetme humane me veprimet e veta mund të shkaktojë ndryshime në strukturën e elementeve të natyrës dhe të proceseve që zhvillohen në të, e me këtë edhe ndotjen e mjedisit pra, është e qartë se fati dhe çështja e ekzistimit të tij janë në duart e tij.

Mirëpo, grykësia dhe gara për fitim, qenien e vetme humane – njeriun, e bëjnë që të mendojë vetëm sot për sot dhe t'i anashkalojë pasojat e veprimit të vet mbi natyrën, pa mbajtur llogari për ekzistencën vetjake.

Pra, bëhet fjalë për nivelin e ulët të vetëdijes ekologjike, për pasojat mbi të cilat shoqëria, përmes organeve të veta, dhe me norma plotësisht të ndërtuara normative dhe zbatimit të tyre, duhet të ndikojë së paku në kuadër të qëndrueshmërisë së mjedisit.

Republika e Maqedonisë mbase gjendet në radhët e vendeve më të rralla, të cilat në këtë fushë ka miratuar norma ligjore voluminoze, me të cilat rregullohen çështjet, problemet dhe masat për mbrojtjen e mjedisit, duke u nisur nga Ligji për mjedisin, si ligj i kornizës, Ligji për natyrën, ligjet e veçanta për mbrojtjen e truallit, ajrit dhe ujërave, mbrojtjen nga zhurma e dëmshme, ligjet për mbrojtjen e lokaliteteve të caktuara natyrore me rëndësi të veçantë, si edhe një numër të madh të akteve nënligjore, të cilat në pjesën më të madhe janë harmonizuar me standardet evropiane dhe ndërkombëtare, ndërkohë që janë ratifikuar edhe një numër i madh i akteve siç janë: Konventa Kornizë e Kombeve të Bashkuara për ndryshimet klimatike, Protokolli i Kjotos, Protokolli i Montrealit, Konventa e Stokholmit, Konventa për qasje deri te informatat, pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrje dhe arritjet e drejtësisë për çështje që kanë të bëjnë me mjedisin.

Edhe përkundër kësaj, rezulton se normat ligjore vetvetiu nuk mjaftojnë, nëse subjektet kompetente në nivel qendror nuk i zbatojnë në tërësi dhe me konsekuencë dhe nëse vetëdija e subjekteve të tjera dhe në përgjithësi vetëdija e banorëve ndaj mjedisit është në nivel të ulët.

Me sa duket, ministria përkatëse, pra Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, dhe në kuadër të saj edhe Inspektorati Shtetëror i mjedisit, nuk i ndërmarrin të gjitha masat ligjore, me të cilat do t'i luftonin para së gjithash ndotësit më të mëdhenj të mediumit të mjedisit. Se është kështu konfirmojnë edhe rastet për të cilat reagues banorët lokal që jetojnë në afërsi të rafinerisë "OKTA" dhe fabrikës së çimentos "Usje" ndonëse të dhënat zyrtare të Shërbimit të mjedisit për matje të kryera për ndotjen e ambientit të mjedisit, dëshmojnë se koncentrimi i emetimit të substancave të dëmshme janë në kuadër maksimal të kufirit të lejuar. Në përputhje me nenin 21 të Ligjit për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit i përcjellë gjendjet e këtylla, por sikurse edhe deri tani konstaton pasivitet dhe interesim të pamjaftueshëm nga një numër i madh i shoqërive ekologjike dhe nga vetë qytetarët si individë.

Si rrjedhojë e vetëdijes së ulët ekologjike, qytetarët zakonisht reagojnë vetëm në rastet kur drejtpërdrejt dhe kur personalisht rrezikohen interesat e tyre individuale, e këtë e dëshmon numri i vogël i parashtrësive të kësaj fushe deri te zyra e Avokatit të Popullit.

Duke e pasur parasysh faktin se gjendja në fushën e mjedisit nuk është në nivelin e kënaqshëm, apo në nivel të asaj që quhet e durueshme, ndërkohë që mungon vetëdija e qytetarëve, nevojitet aksion më i gjerë i të gjithë faktorëve relevantë dhe para së gjithash i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, njësisive të vetadministrimit lokal, institucioneve arsimore, shoqërive ekologjike, po edhe i Avokatit të Popullit, në drejtim të ngritjes së vetëdijes së qytetarëve.

Në vitin për të cilin raportojmë edhe përkundër asaj që në shikim të parë quhet bashkëpunim korrekt ndërmjet Avokatit të Popullit dhe Inspektoratit për Mjedisin, megjithatë vlerësojmë se edhe ky organ i administratës nuk ndërmori masa të mjaftueshme dhe energjike kundër subjekteve, të cilat me mosrespektimin e rregullave ligjore, i cenuan të drejtat e qytetarëve për paqe dhe qetësi vetjake dhe të drejtat për jetë në mjedis të shëndoshë. Siç është thënë edhe në raportin paraprak, sjellja e këtyllë u jep guxim individëve dhe pronarëve të objekteve industriale, hotelerike dhe objekteve të

tjera, që veprimtarinë e tyre ta realizojnë në llogari dhe në dëm të ambientit të mjedisit jetësor dhe në llogari të të drejtave të qytetarëve.

Duke i shfrytëzuar autorizimet ligjore, Avokati i Popullit, me iniciativë të vet hapi procedurë për mbrojtjen e mjedisit, të dëmtuar me uzurpimin dhe me përpunimin e tokës bujqësore që gjenden në kuadër të Rezervuarit rreptësishtë natyror “Ezerani”, që gjendet në Liqenin e Prespës. Në këtë drejtim nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujit, u kërkua që ta refuzojë kërkesën për marrje me koncesion të një pjese të tokës, kërkesë kjo e paraqitur nga person fizik nga fshati Asamat, i cili ka bërë uzurpimin e dhe ka filluar ta përpunojë tokën, ndërsa nga Avokati Publik i Republikës së Maqedonisë ka kërkuar të ndërmer masa për mbrojtje nga uzurpimi, meqë bëhet fjalë për pronë që është në pronësi të Republikës së Maqedonisë. Për fat të keq, organi nuk ka ndërmarrë masa nga kompetenca e vet e as nuk është deklaruar sipas kërkesës së Avokatit të Popullit.

Në rastin e njëjtë, vetëm Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, duke vepruar sipas rekomandimit të Avokatit të Popullit ndërmori masa nga kompetenca e vet në bazë të të cilave uzurpuesi i tokës u dënua për kundërvajtje.

Megjithatë, ky rast ngeli pa zgjidhje përfundimtare ligjore ngaqë Avokati Publik nuk kërkoi mbrojtje të pronës së Republikës së Maqedonisë, mbi të cilën vazhdon uzurpimi duke vazhduar me përpunimin tokës në lokalet e përmendura, me çka ekziston rreziku nga degradimi i saj, e që do të rezultonte me shkatërrimin e biotopeve dhe biocenoza natyrore që janë në gjendjen natyrore e që është në kundërshtim me qëllimet e Ligjit për shpallje të lokalitet ornitologjik “Ezerani” të Liqenit të Prespës për rezervat rreptësishtë natyror.

Me qëllim që të ndikojë në vetëdijen e qytetarëve, në drejtim të mbrojtjes dhe avancimit të mjedisit, Avokati i Popullit hartoi dhe shpërndau fletëpalosje informative në të cilën informon për më tepër çështje që kanë të bëjnë me mjedisin dhe të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë për mbrojtjen e tij.

**10,32 %**

nga numri i  
përgjithshëm i  
parashtresave të  
pranuara

## Marrëdhëniet e punës

Në fillim të vitit raportues te Avokati i Popullit vazhduan të vijnë qytetarë, të cilët kishin marrë aktvendime për pushim nga marrëdhënia e punës për shkak se ishin shpallur tepriçë teknologjike, ndërsa kjo ishte rrjedhë e detyrimeve që Qeveria e Republikës së Maqedonisë i kishte marrë gjatë negociatave të zhvilluara ndërmjet Fondit Monetar Ndërkombëtar për racionalizimin e administratës publike. Kështu, mbrojtjen e të drejtave të veta e kërkuan punonjësit e Ndërmarrjes Publike “Hekurudhat e Maqedonisë” – Shkup, ku Avokati i Popullit dërgoi sugjerim për veprim adekuat gjatë procedurës së zbatimit të racionalizimit, përkatësisht që të merren parasysht dispozitat ligjore, të cilat e rregullojnë këtë materie. Avokati i Popullit, konstatoi se në rastin konkret bëhet fjalë për proces tejet të vështirë dhe shumë të rëndësishëm, pasojat e të cilit do të reflektoheshin në jetën shoqërore, nëse kihet parasysht fakti se me pushimin nga puna, në pozitë të palakmueshme shoqërore vihen familjet e 850 punonjësve, para së gjithash nga aspekti ekonomik dhe social, e që drejtpërsëdrejti do të reflektohej në planin social, i cili edhe ashtu është në nivelin e rrezikuar social në Republikë.

Qëllimi i Avokatit të Popullit nuk ishte vlerësimi i nevojës së inkorporimit të ndryshimeve me karakter të këtyllë, sepse është e pamohueshme e drejta e punëdhënësit, e parashikuar me Ligjin për marrëdhënie pune, të ndërmarrë hapa të këtyllë, në qoftë se vlerëson se me këtë do të ketë rezultate më të mira në punë dhe në realizimin e fitimit proporcional, e që është qëllim kryesor i subjektit ekonomik. Megjithatë, Avokati i Popullit, konsideroi se në rastin konkret duhet të merreshin parasysht dispozitat e Ligjit për marrëdhënie të punës dhe Kontrata kolektive për ndërmarrjet publike, sipas të

cilave parashikohet që numri dhe struktura e punonjësve, të cilëve duhet t'u pushojë marrëdhënia e punës, për shkak të strukturimit organizativ, teknologjik dhe ndryshimeve strukturore, përkatësisht për shkak të zvogëlimit të numrit të kryerësve mbi bazë të kriterëve të caktuara të përmendura në Kontratën kolektive, me të cilën bëhet lista e radhitjes, përkatësisht fitimi i pikëve për punonjësit, dhe pastaj t'u kumtohet pushimi nga marrëdhënia e punës. Sipas Avokatit të Popullit, nuk është në përputhje me rregullat ligjore nëse shqiptimi i pushimit nga marrëdhënia e punës me përjashtim, për shkak të ndryshimeve organizative, teknologjike dhe strukturore është kumtuar pa pasur kriterë dhe pa i përcaktuar pikët, përkatësisht listën e radhitjes së punonjësve. Pushimi i këtillë nga marrëdhënia e punës konsiderohet si i jashtëligjshëm dhe nuk ka pasoja ligjore për punonjësin.

Ndërmarrja Publike "Hekurudhat e Maqedonisë" – Shkup, pas rishqyrtimit të gjendjes faktike, vetëm për një rast dërgoi përgjigje pozitive, përkatësisht konstatoi cenim gjatë procedurës për shpallje si tepricë teknologjike, me ç'rast pas sugjerimit të bërë nga Avokatit të Popullit pala është kthyer në punë. Në rastet e tjera nuk është konstatuar cenim dhe prandaj palët për mbrojtjen e të drejtave të tyre hapën procedurë pranë gjykatës kompetente.

Gjatë procedimit për punësim, aktuale ishte gjendja e punësimit të kuadrit profesional në të gjitha gjykatat themelore dhe të apelit në Republikën e Maqedonisë, si edhe në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë. Pas shpalljes së konkursit për punësimin e kuadrit profesional nëpër gjykata, Avokati i Popullit deri te të gjithë kryetarët e gjykatave dërgoi njoftim, me të cilin u sugjeroi që gjatë procedurës së punësimit të mbahet llogari për parimin e përfaqësimit të drejtë dhe adekuat të qytetarëve të cilët u përkasin të gjitha bashkësive.

Pas parashtresave të parashtruara dhe duke pasur parasysh faktin se në rrjedhë e sipër ishte procesi i vendimmarrjes sipas ankesës pranë Komisionit për vendosje në shkallë të dytë, sipas ankesave dhe kundërshtimeve të nëpunësve shtetërorë, pranë Agjencisë për Nëpunës Shtetërorë, Avokati i Popullit këtij Komisioni i dërgoi sugjerimin që gjatë procedurës së vendimmarrjes të kihën parasysh të gjitha faktet dhe provat materiale, me qëllim që gjatë marrjes së vendimit të veprojë në mënyrë të drejtë. Komisioni, e hodhi poshtë numrin më të madh të ankesave, duke i vlerësuar si të pabaza, sepse nuk konstatoi cenim gjatë procedurës së zgjedhjes. Vetëm në një rast u pranua sugjerimi i Avokatit të Popullit, kur kryetari i Gjykatës Themelore në Negotinë kishte bërë zgjedhjen e dy kandidatëve nga lista e propozuar, në vend që të zgjidhte nga një kandidat nga secila listë e propozuar. Pas shfuqizimit të vendimit për zgjedhje nga ana e Agjencisë për Nëpunës Shtetërorë, kryetari i Gjykatës Themelore në Negotinë bëri rizgjedhje të kandidatëve me ç'rast u zgjodh nga një kandidat nga secila listë e propozuar.

Si cenime të të drejtave nga marrëdhënia e punës gjatë procedurës së punësimit, karakteristik ishte punësimi i kursistëve, të cilët me sukses e kryen trajnimin në kuadër të "Programit për trajnim të nëpunësve shtetërorë profesionistë – administrativë, pjesëtarë të bashkësive, për punë në administratën shtetërore", që u mbajt gjatë periudhës prej 15.03 – 19.11.2004 dhe pas dhënies së provimit për praktikantë, fituan të drejtën për të themeluar marrëdhënie të punës në organin shtetëror, në të cilin e kishin kryer trajnimin në vend përkatës të punës. Cenimi i të drejtave kishte të bënte me atë se disa punëdhënës nuk lidhnin kontrata për punë me kursistët, edhe pse ishin të detyruar ta bëjnë një gjë të tillë, përfundimisht deri më datë 01.02.2005. Avokati i Popullit sugjeroi që të ndërmerreshin masa në drejtim të rregullimit të statusit të kursistëve, përkatësisht që të merrnin vendime për themelim të marrëdhënies së punë me të njëjtët, sepse kishte kaluar një periudhë e gjatë kohore nga data 01.02.2005, kur në fakt ata duhej të kishin themeluar marrëdhënie të punës nëpër organet e shteti ku kishin kryer trajnimin. Pas sugjerimit të Avokatit të Popullit, deri më tani pozitivisht janë zgjidhur dy raste, përkatësisht drejtori i Institucionit Ndëshkimor – Përmirësues, ka lidhur kontratë për punë me dy kursistë. Pas sugjerimit të Avokatit të Popullit nuk ka vepruar punëdhënësi i Ministrisë për Punë të Brendshme në Tetovë.

Cenime të të drejtave nga marrëdhënia e punës janë shfaqur edhe gjatë procedurës së punësimit të një grupi të oficerëve – nëntogerë në Akademinë Ushtarake. Ministria e Mbrojtjes nuk themeloi marrëdhënie të punës me këtë grup të oficerëve – nëntogerë që ishte obligim ligjor i saj, ndërsa shkak për mënyrën e këtillë të veprimin ishte se me aplikimin e reformave në Ministrinë e Mbrojtjes është bërë zvogëlimi i vendeve të punës. Avokati i Popullit kërkoi të ndërmerren masa për punësimin e këtij grupi të oficerëve – nëntogerë, ashtu siç në fakt Ministria kishte vepruar edhe me 10 gjeneratat paraprake të oficerëve – nëntogerë. Avokati i Popullit është informuar se meqë nuk ka

vende të lira të punës për punësim, Ministria e Mbrojtjes oficerëve –nëntogerë u ka ofruar arsimim shtesë për studime posdiplomike ose të themelojnë marrëdhënie të punës nëpër gjykata, si policë të gjykatave ose si gardianë nëpër institucionet ndëshkimore – përmirësuese për çka në rrjedhë është procedura e realizimit.

Vitin për të cilin raportojmë e shënoi edhe çështja e caktimit se cili organ vendos sipas kërkesave për pagesën e pagës pas pushimit të funksionit ambasador, sepse pranë organeve kompetente, përkatësisht deri te Komisioni për çështje të emërimeve dhe zgjedhjeve pranë Kuvendit të Republikës së Maqedonisë deri më tani nuk është vendosur për rastet e këtilla. Duke e shfrytëzuar mundësinë, e caktuar me Rregulloren e punës së Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, Avokati i Popullit hapi procedurë, me ç'rast deri te kryetari i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë dërgoi kërkesë për interpretim autentik të nenit 19, paragrafit 1 dhe nenit 20 të Ligjit për pagat dhe kompensimet e tjera të deputetëve të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë dhe personave të tjerë të emëruar dhe të zgjedhur në Republikë ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 36/90; 44/90; 11/91; 23/97; 37/05), përkatësisht për caktimin se cili organ do të vendosë sipas kërkesave për pagesën e pagës pas ndërprerjes së funksionit ambasador apo funksionit tjetër të personave të emëruar apo të shkarkuar nga Komisioni për çështje të emërimeve dhe zgjedhjeve pranë Kuvendit të Republikës së Maqedonisë edhe organeve dhe trupave të tjerë. Pas kërkesës për interpretim autentik, në vijim është procedura për dhënien e mendimit rreth kësaj çështje nga ana e komisioni kompetent të Kuvendit.

Gjatë vitit 2005, jo më pak i rëndësishëm ka qenë zbatimi i procedurës së decentralizimit, përkatësisht transferimit të kompetencave nga niveli qendror në atë lokal, ku dëm apo padrejtësi më të madhe kanë pësuar punonjësit e Ministrisë së Transportit dhe Ndërlidhjeve dhe njësitë rajonale të tyre.

Përkatësisht, para fillimit të procedurës së decentralizimit, u bënë disa ndryshime ligjore, në të cilat qartë është parashikuar se bartja e kompetencave nga niveli qendror në atë lokal, si transferimi i punonjësve, pajisja, mjetet e punës, arkivi, dokumentacioni nga njësitë rajonale të organeve të administratës shtetërore, kompetencat e të cilëve në përputhje me ligjin bëhen komunale dhe merren nga komunat në mënyrë dhe kushte të përcaktuara me ligjet e harmonizuar të veçantë. Me fillimin e zbatimit të Ligjit për ndërtim dhe Ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanistik të cilët u ndryshuan, Ministria e Transportit dhe Ndërlidhjeve për të gjithë punonjësit përgatiti kontrata për transferim, të cilat në numrin më të madh u nënshkruan, por kontratat e atyre që nuk u nënshkruan nga kryetarët e komunave, Ministria ju kumtoi pushim nga marrëdhënia e punës. Duke e shqyrtuar gjendjen faktike dhe dispozitat ligjore, Avokati i Popullit dërgoi sugjerim deri te të gjitha organet relevante, për të cilat konsideroi se me ndërmarrjen masave dhe veprimeve të caktuara, në kuadër të kompetencave të tyre, mund ta parandalojnë gjendjen e këtillë, përkatësisht të kontribuojnë për shmangien e parregullsive të bëra ndaj punonjësve gjatë zbatimit të procedurës së decentralizimit, për çka u shqiptuan aktvendime për pushim nga marrëdhënia e punës.

Për shkak të konstatimit të cenimit të të drejtave të punonjësve, përkatësisht zbatimit jo të plotë të të drejtës materiale nga ana e Ministrisë së Transportit dhe Ndërlidhjeve dhe disa kryetarëve të komunave të njërive të vetadministrimit lokal, të cilët nuk pranuan t'i nënshkruanin kontratat për transferim, Avokati i Popullit ndërmori masa konkrete për mbrojtjen e të drejtave të punonjësve duke dërguar sugjerime deri te Komisioni për vendosje në shkallë të dytë sipas ankesave dhe kundërshtimeve të nëpunësve shtetërorë pranë Agjencisë për Nëpunës Shtetërorë për shkak të ankesave të dërguara nga ana e punonjësve që ishin kundër vendimeve për pushim nga marrëdhënia e punës, pranë ministrit të Transportit dhe Ndërlidhjeve, ministrit të Vetadministrimit Lokal dhe veç e veç deri te të gjithë kryetarët e komunave, të cilët nuk vepruan në përputhje me ligjet, përkatësisht nuk i nënshkruan kontratat për transferim, për çka punonjësit kanë marrë vendime për pushim nga marrëdhënia e punës. Avokati i Popullit dërgoi informatë edhe në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë edhe deri te kryetari i Bashkësisë së Njësisë së Vetadministrimit Lokal – BNJVL.

Avokati i Popullit mori parasysh dispozitat e Ligjit për vetadministrim lokal, Ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanistik, Ligjit për ndërtim dhe Vendimin për bartjen e të drejtës së sendeve të tundshme dhe mënyrën e transferimit të nëpunësve shtetërorë mbi bazë të të cilëve sugjeroi që në mënyrë konsekuente të respektohen ligjet e cekura, të cilët duhet të zbatohen në tërësi, përkatësisht

të ndërmerren masa për nënshkrimin e të gjitha kontratave për transferimin e punonjësve nga niveli qendror në atë lokal.

Pas dërgimit të sugjerimeve, Avokati i Popullit akoma nuk ka marrë përgjigje pozitive nga ndonjë kryetar i komunës në kuptimin se është pranuar sugjerimi i tij dhe se janë ndërmarrë masa konkrete për nënshkrimin e kontratave që janë lëndë shqyrtimi për punonjësit, të cilët nuk janë transferuar. Përkundrazi, sqarimet që bëjnë janë se sipas aktit për sistematizim, vende vakante të punës nuk ka, përkatësisht nuk ka mjete të mjaftueshme materiale, e ky arsyetim për Avokatin e Popullit nuk është i pranueshëm. Disa kryetarë të komunave kanë potencuar se e kanë kryer detyrimin ligjor me atë se i kanë nënshkruar të gjitha kontratat, ndërsa te Avokati i Popullit paraqiten qytetarë – punonjës të pakënaqur nga Ministria e Transportit dhe Ndërlidhjeve, të cilët nuk janë transferuar pikërisht nga njësitë e vetadministrimit lokal, nga të cilat Avokati i Popullit ka marrë përgjigje se i kanë zbatuar detyrimet ligjore.

Agjencia për Nëpunës Shtetërorë ishte e vetmja që pranoi sugjerimin e Avokatit të Popullit dhe i mori në konsideratë ankesat e punonjësve, të cilëve iu ndanë vendime për pushim nga puna dhe lëndët i ktheu në rishqyrtim dhe vendimmarrje pranë Ministrisë së Transportit dhe Ndërlidhjeve.

Gjatë zbatimit të procedurës së decentralizimit të arsimit, numri i qytetarëve që kanë parashtruar parashtrësia pranë Avokatit të Popullit është i vogël dhe kryesisht kanë të bëjnë me procedurën e sistematizimit nga niveli qendror në atë lokal. Por, sipas këtyre lëndëve Avokati i Popullit i dërgoi ministrit të Arsimit dhe Shkencës sugjerim për veprim përkatës, përkatësisht për sistematizim të përfaqësuesve rajonal, në çfarëdo qoftë vendi të punës në kuadër të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, në mënyrë që të mos u kumtohet pushimi nga marrëdhënia e punës. Nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, ndërmerren masa konkrete që edhe ai numër i vogël i qytetarëve, të cilët ende nuk kanë marrë vendime për sistematizim në njësitë e vetadministrimit lokal ose në kuadër të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, së shpejti të sistematizohen.

Në kontekst të kësaj, patjetër duhet theksuar se gjendja e procedurave gjatë punësimit dhe sistematizimit të kuadrit arsimorë në arsim, në periudhën e kaluar, ishte tejet më e vështirë dhe këto probleme Avokati i Popullit i shpalosi në raportin paraprak. Gjatë vitit 2005, ka përmirësim në kuptimin e shmangies së gjendjes së përmendur gjatë procedurës së punësimit dhe sistematizimit të kuadrit arsimor, sepse Inspektorati i Arsimit, me kompetencat e reja të caktuara ndërmerr masa konkrete për mbrojtjen e të drejtave të punonjësve të kuadrit arsimor, e kjo rezulton me zvogëlimin e numrit të parashtrësive të parashtruara që kanë të bëjnë me shkelje të procedurës gjatë punësimit dhe sistematizimit.

Marrë në përgjithësi, bashkëpunimin më të mirë, sa i përket mbrojtjes të të drejtave nga marrëdhënia e punës, Avokati i Popullit e ka me Inspektoratin e Punës pranë Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale, i cili çdo herë u përgjigjet kërkesave të parashtruara për zbatim të mbikëqyrjes inspektuese në organin e përmendur, pa marrë parasysh se a bëhet fjalë për organ të administratës shtetërore ose për sipërmarrje private, ku Avokati i Popullit nuk ka kompetenca të veprojë. Ky Inspektorat bën inspektime të plota dhe Avokatit të Popullit ia dërgon dokumentacionin për inspektimin e bërë në organin përkatës, i cili i nevojitet për veprim të mëtutjeshëm.

**2,10 %**

nga numri i  
përgjithshëm i  
parashtrësive të  
pranuara

**Çështjet strehimore**

Ngjashëm me vitet e kaluara edhe gjatë vitit për të cilin raportojmë, numri më i madh i parashtrësive të paraqitura për këtë fushë, kanë të bëjnë me punën e Komisionit për çështje strehimore të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë. Qytetarët në të shumtën e rasteve kërkojnë

ndërhyrje për shkak të mosveprimit të Komisionit sipas kërkesave të dërguara për vendosje të çështjeve strehimore, në kuptimin e dispozitave të Ligjit për banim, kërkesave për ndarjen e banesave me qira, mbi bazë të Ligjit për denacionalizim dhe kërkesave për ndarjen e banesave me qira, përkatësisht blerje mbi bazë të Ligjit për të drejta të veçanta të pjesëtarëve të forcave të sigurimit edhe anëtarëve të familjeve të tyre.

Duke vepruar sipas parashtresave të parashtruara. Avokati i Popullit ka konstatuar se në numrin më të madh të rasteve, komisioni kompetent, thuaja se pa përjashtime, i shkel afatet për vendosje të caktuara me ligj, përkatësisht afatet për dërgimin e përgjigjeve sipas kërkesave të paraqitura dhe kështu i cenon të drejtat kushtetuese dhe ligjore të parashtruesve.

Në drejtim të tejkalimit të praktikës së këtillë, Avokati i Popullit disa herë ka realizuar takime me personat kompetent të Komisionit për çështje strehimore, me ç'rast ua ka bërë me dije nevojën e vendosjes me kohë sipas kërkesave të qytetarëve. Gjatë këtyre takimeve, Avokati i Popullit ka theksuar se është i vetëdijshëm dhe i njohur se për shkak të gjendjes së vështirë ekonomike dhe sociale, shteti nuk ka në dispozicion numër të mjaftueshëm të banesave, prandaj dhe në të shumtën e rasteve nuk ka mundësi që të përgjigjet pozitivisht sipas kërkesave të qytetarëve për zgjidhjen e çështjeve strehimore. Por, megjithatë Avokati i Popullit vlerëson se Komisioni ka për detyrë që brenda afatit të arsyeshëm t'i shqyrtojë kërkesat e dërguara, ndërsa për epilogun e procedurës t'i njoftojë me kohë parashtruesit e kërkesave. Edhe përkundër sugjerimeve të këtilla dhe premtimeve të kryetarit të Komisionit për çështje strehimore, se lëndët për të cilat ka intervenuar Avokati i Popullit do të shqyrtohen dhe do të vendoset për to, ndërsa parashtruesit e kërkesave për vendimin e marrë do të njoftohen me shkrim, deri në momentin e hartimit të raportit, Avokati i Popullit nuk është në dijeni se a ka vepruar Komisioni ashtu siç janë marrë vesh.

Bashkëpunimi me Ministrinë e Transportit dhe Ndërlidhjeve, përkatësisht Sektorin kompetent për çështje strehimore – komunale dhe infrastrukturore, si organin i cili vepron sipas kërkesave, në përputhje me autorizimet ligjore, që kanë të bëjnë me bartjen e të drejtës të shtëpisë tek anëtari i familjes dhe për blerjen e banesave familjare që janë në pronë të shtetit, Avokati i Popullit e vlerëson si të pakënaqshme.

Në të vërtetë, pranë Avokatit të Popullit kanë arritur më shumë parashtresa të qytetarëve, të cilët kërkojnë përshpejtimin e procedurës për bartjen e të drejtës banesore edhe blerjen e banesave që janë në pronësi të shtetit nga bartësit e të drejtës banesore në përputhje me Ligjin për shitjen e banesave në pronësi shoqërore. Pavarësisht nga ajo se a ekziston ose jo bazë për zgjidhje pozitive të kërkesave, Ministria e Transportit dhe Ndërlidhjeve për numrin më të madh të kërkesave, tregoi bashkëpunim dhe veprim me kohë sipas kërkesave të Avokatit të Popullit. Nga ana tjetër, Avokati i Popullit ka vërejtje në punën e Ministrisë së Transportit dhe Ndërlidhjeve për shkak të mefshtësisë së marrjes së vendimeve sipas kërkesave të qytetarëve, prandaj dhe disa qytetarë për realizimin e disa të drejtave të caktuara pranë Ministrisë pa nevojë presim për një kohë më të gjatë.

Avokati i Popullit, pati takim të drejtpërdrejt me persona zyrtarë të Ministrisë së Transportit dhe Ndërlidhjeve, gjatë të cilit takim u kërkuar informata konkrete për rrjedhën e procedurës së shpërndarjes së banesave të dedikuara për persona me të ardhura të ulëta dhe shitjen e banesave shtetërore, të cilat i shfrytëzojnë persona pa i pasur dokumentet e nevojshme, përkatësisht persona të akomoduar pa leje.

Meqë gjatë vitit 2003, u shpall konkursi i dytë për shpërndarjen e banesave të ndërtuara sipas "Projektit për ndërtimin e banesave, të cilat do t'u ndahen personave me të ardhura të ulëta" në Qytetin e Gostivarit, ndërkohë që shpërndarja nuk është bërë për shkak të hapjes së procedurës gjyqësore nga ana e Avokatit Publik për shfuqizimin e kontratave, të cilat në bazë të shpalljes së mëparshme Ministria e Transportit dhe Ndërlidhjeve i kishte kontraktuar me qytetarët, Avokati i Popullit kërkoi njoftim se vallë procedura për shfuqizimin e kontratave ka përfunduar plotfuqishëm.

Duke pasur parasysh faktin se procedurat gjyqësore për anulimin e kontratave për qiramarrje të banesave nuk kanë përfunduar plotfuqishëm, Ministria e Transportit dhe Ndërlidhjeve për një kohë nuk do ta bëjë shpërndarjen e banesave në Qytetin e Gostivarit. Lidhur me problemin që është prezent më shumë vjet, me të ashtuquajturat banesa sociale, Avokati i Popullit u informua se Ministria e Transportit dhe Ndërlidhjeve ka kontaktuar me ekspertë të Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës, e cila bëri financimin e ndërtimit të banesave dhe kërkoi mendim për mënyrën e zgjidhjes

së problemit me shpërndarjen e banesave. Qëndrimi i ekspertëve të cilët u konsultuan ka korresponduar me qëndrimin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë se zgjidhja duhet kërkuar në zbatimin ligjor të procedurës për shfuqizimin e kontratave të lidhura me personat, të cilët nuk i përmbushin kriteret për ndarjen e banesës me qira, si dhe verifikimin e kontratave me personat të cilët i përmbushin kriteret e parashtruara. Për këtë qëllim, Qeveria e Republikës së Maqedonisë e ka ngarkuar Komisionin për shpërndarjen e banesave pranë Ministrisë së Transportit dhe Ndërlidhjeve që të bëjë revizionin e kërkesave të personave, të cilët paraprakisht e kanë fituar të drejtën e qirasë, të bëjë kontroll mbi dokumentacionin, por edhe kontroll në vetë vendin se vallë personat, të cilëve në procedurën e mëparshme u janë ndarë banesa, i përmbushin kushtet për shpërndarjen e banesës me qira në pronësinë të shtetit. Sipas njohurive të fundit, procedura e kontrollit akoma vazhdon.

Për sa i përket problemit të banimit pa të drejtë të personave, të cilin Avokati i Popullit më shumë herë e ka vënë në dukje se duhet të zgjidhet me respektimin e parimit të drejtësisë, u mor përgjigjja kthyesë se Ndërmarrja Publike ka bërë pasqyrën e banesave shtetërore të Republikës së Maqedonisë, nëpër të cilat pa dokumente përkatëse jetojnë të ashtuquajturit persona që banojnë pa të drejtë. Në ndërkohë, Qeveria e Republikës së Maqedonisë miratoi Vendimin për shitjen e banesave që janë në pronësi të shtetit e të cilat i zotërojnë persona pa bazë ligjore. Në kontekst të përmbajtjes së Vendimit, shitja e banesave bëhet përmes publikimit të shpalljes për grumbullimin e ofertave, të botuar nga Ndërmarrja Publike për Ekonomizim me Lokale Banimi dhe Afariste të Republikës së Maqedonisë. Në mjetet e informimit publikë gjatë muajit tetor u shpallën konkurset, në të cilat personat e interesuar, kuptohet së pari personat të cilët i shfrytëzojnë banesat pa dokumente përkatëse, paraqitën ofertat për blerjen e banesave të shpallura. Duke pasur parasysh se procedura e shitjes nuk u zbatua për të gjitha banesat që janë në pronë të shtetit, dhe njëkohësisht Ndërmarrja Publike duhet të bëjë korrigjim duke e plotësuar pasqyrën me banesa të cilat kanë ngelur pa u evidentuar, pasojnë shpallje të reja të banesave për shitje e që duhet të zbatohet gjatë periudhës së ardhshme.

Disa parashtrësia u parashtruan nga qytetarët të cilët kërkonin ndërhyrjen e Avokatit të Popullit pranë Ndërmarrjes Publike për Ekonomizim me Lokale Banimi dhe Afariste të Republikës së Maqedonisë, për kontraktim të marrëveshjes për qiramarrje mbi bazë të vendimit të marrë të Komisionit për çështje strehimore të Republikës së Maqedonisë dhe për hapje të procedurës për shpërnguljen e personave që banojnë pa të drejtë në banesat që janë pronë e shtetit. Pas shkresave që i dërgonte Avokati i Popullit, Ndërmarrja publike e Republikës së Maqedonisë dhe njësitë e saj rajonale, vepronin thuaja se pa përjashtim.

Vlerësim i përgjithshëm për vitin raportues, është se duke e përcjellë gjendjen e mbrojtjes të drejtave të qytetarëve nga fusha banesore, në rastet kur konstatohet cenim i shkaktuar nga organet kompetente Avokati i Popullit reagon me kohë dhe përmes formave të ndryshme të shprehjes së qëndrimeve, mendimeve, sugjerimeve dhe udhëzimeve. Edhe përkundër asaj se edhe më tutje ballafaqohet me probleme në relacion me organet e administratës dhe organizatat me autorizime publike, Avokati i Popullit vlerëson se gjatë periudhës për të cilën raportojmë, bashkëpunimi me organet dhe institucionet ndaj të cilave vepron me kompetencë është më intensive, më efektive dhe dukshëm e përmirësuar.

Por, kur bëhet fjalë për realizimin e të drejtave të qytetarëve nga fusha strehimore edhe përkundër përpjekjeve që bën Qeveria e Republikës së Maqedonisë, në drejtim të miratimit të akteve nënligjore, me qëllim të intensifikimit të zgjidhjes së gjendjes së shtresuar negative (ndarja e të ashtuquajturave banesa sociale, shitja e banesave shtetërore, të cilat i shfrytëzojnë persona që banojnë pa të drejtë etj), mbetet konstatimi se këto probleme vështirë zgjidhen. Avokati i Popullit konsideron se aktet nënligjore, paraqesin bazë të mirë për zgjidhjen e problemeve shumëvjeçare që shfaqen në fushën e banimit, por rezultatet e aplikimit të tyre do të shihen gjatë periudhës së ardhshme.



# 3,87 %

nga numri i  
përgjithshëm i  
parashtresave të  
pranuara

## Sigurimi dhe mbrojtja sociale

Duke vepruar në drejtim të mbrojtjes të të drejtës nga sigurimi social dhe mbrojtjes sociale, Avokati i Popullit konstatoi se edhe pse gjatë vitit 2005 pati zvogëlim minimal të numrit të parashtresave nga kjo lëmi, gjendja sociale dhe ekonomike e qytetarëve nuk është përmirësuar, ndërsa ndihma sociale nuk është e mjaftueshme për t'i plotësuar nevojat esenciale të ekzistencës, prandaj dhe nuk mund të thuhet se në mënyrë konsekuente realizohet garancia kushtetuese për siguri sociale dhe drejtësi sociale.

Gjatë vitit për të cilin raportojmë, për shkak të realizimit të të drejtave nga fusha e mbrojtjes sociale, ndonëse qendrat për punë sociale vazhduan ta zbatojnë me konsekuencë detyrimin ligjor për kryerje të drejtpërdrejtë të inspektimit nëpër familjet e aplikuesve, për shkak të verifikimit të drejtë të gjendjes faktike, e që është parakusht kryesor për realizimin e ligjshëm të të drejtave nga mbrojtja sociale, megjithatë kishte raste kur ajo nuk verifikohet drejt dhe kur qytetarëve u ndërpritej e drejta e shfrytëzimit të ndihmës sociale. Për këtë arsye, Avokati i Popullit disa herë ka ndërhyrë që të bëhet inspektim i drejtpërdrejtë për shkak të verifikimit të drejtë të gjendjes faktike me qëllim që të mos vijë deri te ndërprerja e paligjshme e ndonjë të drejte që del nga mbrojtja sociale.

Në këtë drejtim, Avokati i Popullit për disa raste ka konstatuar se ndihma sociale e parashtruesve, është ndërprerë për disa vjet në bazë të gjendjes gabimisht të verifikuar. Pas ndërhyrjeve të Avokatit të Popullit, parashtruesve të parashtresave u është njohur e drejta për ndihmë sociale në para edhe në mënyrë retroaktive, pra nga momenti kur padrejtësisht u është ndërprerë ndihma sociale. Gjithashtu, në disa raste, personave të paafte për punë u është ndërprerë ndihma e vazhdueshme në para, vetëm për shkak të faktit se realizojnë pension apo të ardhura të tjera pavarësisht se ato të ardhura a e tejkalojnë mesataren e parashikuar me ligj. Në rastet kur për këto shkaqe është ndërprerë ndihma e vazhdueshme në para, pas ndërhyrjes së Avokatit të Popullit parashtruesit e kanë realizuar të drejtën e ndihmës së vazhdueshme në para.

Pengesë e veçantë gjatë realizimit të disa të drejtave të caktuara të mbrojtjes sociale, qytetarët patën edhe për shkak të moskryerjes me kohë të kontrolleve nga ana e komisioneve për vlerësimin e aftësisë së punës. Komisionet në disa raste nuk bënë kontroll vetëm për shkak të mungesës së formularëve, për çka Avokati i Popullit reagoi dhe kërkonte të ndërmerren masa përkatëse, duke ua bërë me dije se për shkak të problemeve teknike, qytetarët nuk duhet të pengohen në realizimin e të drejtave të tyre. Gjithashtu, një pjesë e parashtresave u paraqitën për shkak të zvarritjes së procedurës për hartimin dhe dërgimin e rezultatit dhe mendimit të komisioneve, të cilët kontrollin e kishin bërë shumë kohë më parë.

Në lidhje me realizimin e të drejtave sociale, varësisht nga aftësia e punës, kishte edhe raste kur nga dokumentacioni i dorëzuar, padyshim rezultonte se bëhet fjalë për person krejtësisht të paafte, të cilit edhe përkundër këtij fakti, nuk i njihej e drejta e kompensimit për ndihmë dhe përkujdesje nga person tjetër, apo e drejta e ndihmës së vazhdueshme në para. Në rastet e kësilla, Avokati i Popullit insistonte të bëhej kontroll i drejtpërdrejtë i parashtruesit të kërkesës dhe kur ai nuk kishte mundësi që vetë të shkonte në kontroll, kërkohet të vizitohej në shtëpi nga ana e komisionit. Propozimet e kësilla, në disa raste pranoheshin dhe qytetarët pas kontrollimit të drejtpërdrejtë i realizonin të drejtat e tyre. Disa qytetarë, të cilët jetojnë në vendbanime më të largëta, sidomos ata që jetojnë nëpër fshatrat e thellë të Tetovës, për një periudhë më të gjatë nuk u vizituan nga komisionet për vlerësimin e aftësisë për punë, dhe si rrjedhojë e kësaj qytetarët vite me radhë i prisnin komisionet për ta bërë kontrollin dhe për ta fituar të drejtën e kompensimit për ndihmë dhe përkujdesje nga person tjetër ose për ndihmë të vazhdueshme në para. Për këtë arsye, Avokati i Popullit intervenoi deri te të gjitha organet kompetente me kërkesë që të vendosej një bashkërenditje përkatëse, midis të gjitha organeve dhe qytetarët të mos pengohen në realizimin e të drejtave të tyre,

vetëm për shkakun se vendbanimi i tyre gjendet larg apo për shkaqe të tjera të pajustificueshme. Pas ndërhyrjeve të Avokatit të Popullit, u bë inspektim i drejtpërdrejt nga ana e komisioneve kompetente nëpër vendet më të largëta dhe qytetarët pas disa vjetësh arritën t'i realizonin të drejtat.

Për tejkalimin e problemeve të punës së komisioneve për vlerësimin e aftësisë së punës u mbajt takim me përfaqësuesit relevantë të organeve kompetente për punën e komisioneve, me ç'rast u njoftuan me ankesat e qytetarëve, të cilat para së gjithash kishin të bënin me joobjektivitetin e komisioneve dhe me zvarritjen e procedurave. Në këtë takim u konstatua se është e domosdoshme të formohet komision i veçantë për vlerësimin e aftësisë së punës për realizimin e të drejtës së kompensimit për ndihmë dhe përkujdesje nga person tjetër. Sa u përket zvarritjeve të procedurave pranë organeve të shkallës së dytë, në takim u vlerësua se shumë shpesh procedura zvarritet për shkak të mosnënshkrimit me kohë të vendimeve të përgatitura nga ana e kryetarit të komisionit të shkallës së dytë, prandaj dhe u tha se duhet bërë ndryshime të rregullores së punës së Qeverisë, me parashikimin e mundësisë për caktimin e zëvendësve të kryetarëve të shkallës së dytë, të cilët në raste të caktuara do të autorizoheshin për nënshkrimin e vendimeve, me çka do të përshpejtohej procedura.

Në takim, gjithashtu u konstatua se gjatë procedimit sipas parashtresave (komunikimi me qytetarët dhe me organet kompetente), rezultoi se qytetarët akoma nuk janë të njoftuar sa duhet me të drejtat dhe mënyrat e realizimit të tyre, për të cilën gjë organet janë të mbingarkuara me kërkesa të pabaza. Së këtejmi, u sugjerua që në të gjitha organet, në vende të dukshme të theksohen kushtet themelore për realizimin e të drejtave të cilat qytetarët i realizojnë pranë atij organi, gjithnjë duke pasur parasysh edukimin e qytetarëve por edhe për shkarkimin e organeve nga kërkesa të pabaza.

Disa veprime të paligjshme në disa qendra për punë sociale, gjatë vitit 2005 u evituan, përkatësisht pa miratimin e akteve administrative nuk bëhej ndërprerja e shfrytëzimit të të drejtave, siç ishte rasti në Qendrën ndërkomunale për punë sociale të Qytetit të Shkupit.

Sikurse edhe gjatë viteve të kaluara edhe në vitin për të cilin raportojmë, Avokati i Popullit konstatoi se nuk ka ndonjë përparim të veçantë, sa i përket respektimit të parimit të procedurës administrative për vendimmarrje të shpejtë dhe efektive për të drejtat dhe interesat e palëve, përkatësisht se akoma, në pjesën më të madhe të rasteve, kemi zvarritje të palejueshme të procedurave, sidomos në procedurat e shkallës së dytë, ku rrallë herë vendoset brenda afateve të parapara.

Në disa raste, Avokati i Popullit intervenoi për shkak se disa qytetarëve nuk u ishin pranuar dokumentet në qendrat për punë sociale, me pretekst se nuk i përmbushin kushtet. Duke vlerësuar se me një mënyrë të këtyllë të veprimit, për të drejtat vendos personi i cili i pranon dokumentet, Avokati i Popullit sugjeroi se kërkesat e paraqitura duhet të pranohen në përputhje me Ligjin për procedurë të përgjithshme administrative, personat zyrtarë duhet të udhëzohen se si t'u ndihmojnë palëve që nuk dinë dhe kështu t'u ndihmojnë në realizimin e të drejtave të tyre dhe nëse edhe pas udhëzimeve që ua bëjnë, sërish kërkesën nuk e shoqërojnë me provat e nevojshme, ajo t'u refuzohet për shkak se nuk i posedojnë dokumentet e nevojshme ose për shkak se nuk i përmbushin kushtet e parashikuara, e jo thjeshtë të refuzohen nga punonjësit e sporteleve.

Lidhur me bashkëpunimin e organeve kompetente me Avokatin e Popullit, mund të konstatohet se gjatë vitit 2005, bashkëpunimi u përmirësua, përmes më shumë inspektimeve të drejtpërdrejta të bëra nga ana e Avokatit të Popullit në organet kompetente, por edhe me thirrjen në bisedë dhe takimeve me personat përgjegjës të atyre organeve në zyrën e Avokatit të Popullit, me ç'rast në asnjë rast nuk u refuzua ftesa e Avokatit të Popullit. Komunikimi i këtyllë, i drejtpërdrejtë me organet dhe organizatat, rezultoi si mjaft i efektshëm për vendimmarrje më të shpejtë dhe ligjore sipas kërkesave të qytetarëve. Për shkak të shqyrtimit gjithëpërfshirës rreth asaj se si realizohen të drejtat e qytetarëve, si edhe për shkak të përmirësimit të bashkëpunimit, u vizituan disa qendra të punës sociale dhe u dhanë më tepër rekomandime për përmirësimin e punës së tyre e sidomos për vendimmarrje më efektive, më me përgjegjësi dhe vendimmarrje ligjore për të drejtat kushtetuese dhe ligjore të qytetarëve.

Sikurse edhe gjatë viteve të kaluara, edhe gjatë vitit 2005, Avokati i Popullit i vizitoi qendrat kolektive, përkatësisht personat e zhvendosur, të akomoduar në Hotel "Kristal" dhe Hotel "Kuba" në

Kumanovë, në qendrat kolektive “Ranka Milanoviq” dhe “Stiv Naumov” në Shkup dhe në “Çiçino Sello” në Saraj.

Edhe më tej, problem thelbësor me të cilin ballafaqohen personat e zhvendosur, të akomoduar nëpër qendrat kolektive janë kushtet joadekuate për jetë, shërbimet joadekuate shëndetësore, higjiena, regjistrimi dhe dhënia me kohë e kartelave të reja për regjistrim, me çka atyre ju vështirësohet shfrytëzimi i të drejtave, të cilat ju takojnë si persona të zhvendosur etj.

Duke pasur parasysh se kushtet më të vështira për jetë u konstatuan në Qendrën kolektive në “Çiçino Sello”, Avokati i Popullit në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale, i evitoi të gjitha mangësitë e konstatuara e sidomos sa i përket kushteve të higjienës dhe kushteve të jetesës.

Në këtë drejtim, Avokati i Popullit, ju sugjeroi të gjitha institucioneve relevante të shtetit dhe institucioneve ndërkombëtare, detyrë e të cilëve është të kujdesen për personat e zhvendosur, që me urgjencë të ndërmarrin masa dhe aktivitete për t'i zgjidhur përfundimisht problemet me personat e zhvendosur dhe kthimin nëpër shtëpitë e tyre, me ç'rast secili nga institucionet kompetente, në suazat e autorizimeve të veta ndërmoi masa, e që si përfundim rezultoi me përgjysmimin e numrit të personave të zhvendosur.

Megjithatë, edhe më tutje mbetet detyrim i shtetit dhe i të gjitha organeve e organizatave të tjera relevante është që të ndërmarrin masa dhe veprime të mëtutjeshme me qëllim që përfundimisht të zgjidhet problemi me personat e zhvendosur dhe kthimin e tyre në shtëpi.

**5,57 %**

nga numri i  
përgjithshëm i  
parashtresave të  
pranuara

## Sigurimi pensional dhe invalidor

Karakteristikë e kësaj periudhe raportuese është se një numër më i madh i parashtresave të parashtruara që kanë të bëjnë me sigurimin pensional dhe invalidor, u paraqitën për shkak të veprimit jo në kohë të organeve kompetente, përcaktimit jo të drejtë të lartësisë së pensionit ose verifikimit të padrejtë të stazhit për pension, si dhe për shkak të pamundësisë së qytetarëve që ta realizojnë të drejtën për pension pleqërie, familjar dhe sidomos për pension invaliditeti.

Avokati i Popullit, edhe gjatë vitit 2005, ka konstatuar procedura të stërzgjatura pa arsye sipas kërkesave të qytetarëve dhe mosrespektim të afateve ligjore për të dhënë përgjigje sipas kërkesave, sidomos për vendosje sipas ankesave të paraqitura. Gjithashtu, rrallë herë janë respektuar afatet ligjore për dhënie e përgjigje sipas kërkesave, rekomandimeve dhe udhëzimeve të Avokatit të Popullit.

Sidomos, brengos kohëzgjatja e procedurave pranë komisioneve të shkallës së dytë, me ç'rast shumë shpesh vendimet e hartuara nga shërbimet profesioniste pritnin një periudhë më të gjatë për nënshkrimin e kryetarit të komisionit. Prandaj e domosdoshme është që të gjenden zgjidhje adekuate për tejkalimin e këtij problemi, i cili ndikon mbi realizimin më efikas të të drejtave të qytetarëve.

Gjatë konfirmimit të cenimit të të drejtave nga ana e Avokatit të Popullit dhe rekomandimeve të dërguara, propozimeve ose udhëzimeve, mund të konstatohet se respektohen dhe se evitohet paligjshmëria ose padrejtësia në aktet dhe punën e organit kompetent, për çka në një pjesë të konsiderueshme të rasteve procedura përfundon me realizimin e të drejtës së qytetarëve pas ndërhyrjeve të Avokatit të Popullit. Lidhur me realizimin e të drejtës për pension pleqërie, Avokati i Popullit konstaton se një numër më i madh i qytetarëve kanë probleme me zvarritjen e procedurës

për realizimin e kësaj të drejte edhe përkundër faktit se i përmbushin kushtet për pension. Por, në një pjesë të madhe të parashtresave që kanë të bëjnë me këtë të drejtë, qytetarët nuk i përmbushin kushtet ligjore për realizimin e pensionit të pleqërisë (kontribute të papaguara për sigurim pensional dhe invalidor, mungesë të stazhit për pension, mosdorëzim të formularëve të nevojshëm pranë Fondit, përkatësisht mosparaqitjen e të dhënave të nevojshme dhe provave përkatëse për realizimin e kësaj të drejte), për të cilën gjë Avokati i Popullit nuk kishte mundësi të ndërhyjë.

Gjatë realizimit të të drejtës për pension pleqërie dhe familjar, një numër më i madh i parashtresave ishin parashtruar për shkak të vështirësive të qytetarëve që të sigurojnë të dhëna për stazhin për pension të realizuar jashtë vendit, me ç'rast Avokati i Popullit mund të intervenonte vetëm pranë Fondit për Sigurim Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë dhe në kuadër të bashkëpunimit të ndërsjellë të ndërmerr masa ndaj organeve jashtë vendit me qëllim të pranimit më të shpejtë të të dhënave të nevojshme.

Numri më i madh i parashtresave kanë të bëjnë me problemet, me të cilat qytetarët ballafaqohen gjatë realizimit të të drejtës për shumën më të ulët të pensionit, sidomos pas realizimit të pensionit nga jashtë. Avokati i Popullit për një numër më të madh të këtyre parashtresave vlerësoi se qytetarët pa pasur bazë, vazhdojnë të kërkojnë realizimin e të drejtës për shumën më të ulët të pensionit edhe përkundër asaj se të drejtën e pensionit e kanë realizuar nga një shtet i huaj dhe shuma e këtij pensioni është më e lartë sesa pensioni më i ulët, edhe përkundër faktit se procedura për realizimin e kësaj të drejte është në vijim pas përmbushjes së kushteve të parapara. Në raste të këtilla, nga puna e deritanishme e Fondit është evidente se rezulton me parapagimin e pensionit, sepse edhe përkundër fakti se obligim i qytetarit është që Fondin ta njoftojë për çdo ndryshim që ka pasuar në lidhje me të drejtën e realizuar, shpesh ata nuk e respektojnë këtë obligim, për të cilën gjë pa bazë e marrin pensionin më të ulët dhe kështu vjen deri te parapagimi i shumës së pensionit, të cilën pastaj Fondi ua heq nga pensioni.

Mirëpo gjatë heqjes së më shumë pensioneve të paguara zakonisht nuk merret aktvendim për shkurtim nga pensioni dhe nuk mbahet llogari për dispozitat mbrojtëse gjatë arkëtimit të dhunshëm. Sipas kësaj, Avokati i Popullit intervenoi në drejtim të respektimit të dispozitave të Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor, sipas të cilave pensioni mund të jetë lëndë për përmbartimin dhe sigurimin deri në një të tretën, në ç'rast Fondi për Sigurim Pensional dhe Invalidor në të shumtën e rasteve pas ndërhyrjes së Avokatit të Popullit vepronte në përputhje me dispozitat e cekura ligjore.

Një numër i madh i parashtresave, të cilat ishin lëndë pune gjatë periudhës për të cilën raportojmë, kishin të bënin me realizimin e të drejtës për pension invaliditeti, përmes të cilave qytetarët shprehnin pakënaqësi nga vendimet e komisioneve kompetente nga aspekti i vlerësimit të aftësisë së tyre për punë dhe nga aspekti i stërzgjatjes së procedurave për kryerjen e kontrollit mjekësor apo për dhënien e rezultatit ose mendimit.

Gjatë realizimit të të drejtës për pension invaliditeti, Avokati i Popullit në të shumtën e rasteve qytetarëve nuk mund t'u ndihmojë edhe aq shumë pasi që nuk është as kompetent e as ekspert që t'i vlerësojë rezultatet dhe mendimet e komisioneve kompetente në lidhje me gjendjen shëndetësore dhe aftësinë për punë. Megjithatë në rastet kur sheshit dukej se bëhet fjalë për persona të cilët janë me sëmundje të rënda, Avokati i Popullit intervenonte që organi kompetent në mënyrë reale dhe të drejtë ta përcaktojë gjendjen faktike për realizimin e të drejtës për pension invaliditeti.

Me qëllim të tejkalimit të problemeve në punimet e komisioneve për vlerësimin e aftësisë për punë, Avokati i Popullit mbajti takim me përfaqësuesit e Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale, Fondin për Sigurim Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë dhe me personin e autorizuar nga komisionet për vlerësimin e aftësisë për punë. Në këtë takim, përveç të tjerash u konstatua se domosdo duhet të ndërmerren masa për përshpejtimin e procedurave pranë komisioneve për vlerësimin e aftësisë për punë; të përshpejtohet procedura pranë komisionit të shkallës së dytë pranë Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, për të cilën gjë do të ishte e pëlqyeshme që të caktohej zëvendës i kryetarit të komisionit të shkallës së dytë, i cili në mungesë të kryetarit do t'i nënshkruajë aktvendimet, të përmirësohet sjellja ndaj qytetarëve dhe qytetarët të njihen me të drejtat e tyre.

Një pjesë e parashtresave janë parashtruar për shkak të pakënaqësisë me lartësinë e pensionit me ç'rast Avokati i Popullit ndërhyri vetëm në rastet kur gjatë përcaktimit të lartësisë së pensionit nuk ishte marrë parasysh stazhi i përgjithshëm për pension dhe pagat realisht të paguara.

Avokati i Popullit në mënyrë të veçantë ndërhyri në disa raste, në të cilat Fondi nuk i njihte pagat e paguara se kinse qëllimisht janë rritur para ndërprerjes së marrëdhënies së punës. Fondi më së shpeshti nuk i respekton sugjerimet e Avokatit të Popullit, sepse konsideron se nuk është kompetent të bëjë kontroll në lidhje me lartësinë e pagave të paguara, por jo rrallë herë pas kontrollit të kryer te punëdhënësit është vërejtur se për bazë nuk janë marrë pagat e paguara, por paga që u paguhej personave të punësuar te punëdhënësi në vende pune të njëjta apo të ngjashme.

Në lidhje me njohjen e stazhit për pension dhe me evidentimin e tij në evidencën amë të Fondit për Sigurim Pensional dhe Invalidor edhe gjatë këtij viti u parashtruan parashtrësia, me ç'rast veçanërisht karakteristike ishin parashtrësia nga persona, të cilët një pjesë të stazhit e kishin realizuar në ish APJ-në apo stazhin e kishin realizuar në Serbi e Mal të Zi. Në lidhje me të drejtat e këtyre personave, me pranimin e të dhënave nga ish APJ-ja edhe pse supozohej se u tejkaloan problemet që kishin të bënin me evidentimin e stazhit dhe njohjen e pagave të paguara, për disa qytetarë ky problem akoma nuk është zgjidhur nga shkaku se ende nuk janë gjetur të dhënat e nevojshme. Një numër i vogël i parashtrësive kanë të bëjnë me pagesën e pensionit të qytetarëve, shtetas të Republikës së Maqedonisë, të cilët pensionin e kanë realizuar në ish APJ-në, ndërkaq nuk janë përfshirë me Marrëveshjen për sigurim pensional. Mirëpo, pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes për suksesion ndërmjet republikave të ish RSFJ-së, Avokati i Popullit ndërhyri që të zgjidhen problemet edhe të këtyre personave, me ç'rast me një marrëveshje të përbashkët ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Serbisë e Malit të Zi, Fondi për Sigurim Pensional dhe Invalidor i Maqedonisë e mori obligimin për pagimin e pensioneve të këtyre personave dhe me këtë edhe ky problem konsiderohet si i tejkaluar. Por, përsëri qytetarët edhe më tej janë të pakënaqur sepse nuk u paguhet pjesa ligjore e pensionit, por një shumë akontative e pensionit. Për tejkalimin e problemeve të këtyre qytetarëve, sipas deklaratave të personave përgjegjës të Fondit, janë të domosdoshme negociata dhe bisedime të mëtutjeshme me Serbinë e Malin e Zi.

Gjatë periudhës kohore për të cilën raportojmë, gjithashtu kishte parashtrësia që kishin të bënin me grumbullimin e mjeteve nga pensionistët në Fondin solidar. Sikurse edhe gjatë viteve të kaluara, parashtrësia u parashtruan nga shoqatat e pensionistëve, të cilët nuk patën sukses të bien dakord dhe të gjejnë zgjidhje të përbashkët për të pasur në dispozicion mjetet e Fondit solidar, por edhe më tutje secila shoqatë kërkon që mjetet nga Fondi solidar të transferohen në llogaritë e tyre. Fondi për Sigurim Pensional dhe Invalidor i Maqedonisë, mjetet nga Fondi solidar i transferon deri te lidhjet e shoqatave ngaqë do të shkaktoheshin probleme të mëdha gjatë shpërndarjes në rast se do të transferoheshin pranë çdo shoqate, duke pasur parasysh faktin se për çdo ditë rritet numri i këtyre shoqatave ndërsa Fondi nuk ka të dhëna ta sakta për anëtarët e këtyre shoqatave. Ky problem edhe më tutje mbetet aktual, përkatësisht i pazgjidhur.

**1,41 %**

nga numri i  
përgjithshëm i  
parashtrësive të  
pranuara

## Sigurimi dhe mbrojtja shëndetësore

Gjatë realizimit të të drejtës shëndetësore, qytetarët shpesh herë hasin në një numër të madh pengesash, sidomos për shkak të faktit se organet kompetente rrallë herë me kohë dhe në mënyrë efikase vendosin sipas kërkesave të tyre, gjë e cila sjell deri te pamundësimi që mbrojtja shëndetësore të bëhet me kohë.

Për shkak të pranimit më të shpejtë dhe me të hollësishëm të informatave dhe të dhënave sipas parashtrësive të parashtruara, Avokati i Popullit vazhdoi me praktikën e vënë që të bëjë inspektime të drejtpërdrejta në organet kompetente e që rezultoi me vendimarrje më të shpejtë dhe ligjore sipas parashtrësive të parashtruara nga ana e qytetarëve, por kishte edhe raste edhe krahas kërkesave me shkrim dhe verbale dhe inspektimeve të kryera, nuk dërgoheshin me kohë të

gjitha informatat dhe të dhënat e nevojshme, të rëndësishme në lidhje me procedurën përkatëse të parashtresës, me të cilën gjë pengohej puna e Avokatit të Popullit.

Në rastet kur konstatohej cenimi i të drejtave, shpesh herë qytetarët të drejtat e tyre i realizonin pas ndërhyrjes së Avokatit të Popullit.

Edhe në këtë periudhë kohore për të cilën raportojmë, kishte parashtresa që kishin të bënin me cenimin e të drejtave të qytetarëve për shkak të mosnjohjes së cilësisë së personit të siguruar, edhe pse Avokati i Popullit në vitet paraprake, bënte me dije se nuk ka bazë ligjore për mosnjohjen e cilësisë së personit të siguruar apo për moskryerje të ndryshimit të sigurimit, vetëm për shkak të ndonjë baze paraprake, e cila ka pushuar së ekzistuari dhe prandaj nuk janë përmbushur obligimet ndaj Fondit. Gjithashtu, edhe gjatë kësaj periudhe për shkak të borxhit të mbetur në emër të kontributit për sigurim shëndetësor nga ndonjë bazë e mëparshme e sigurimit, qytetarët nuk i merrnin kartonët e shëndetësisë, edhe pse si persona të siguruar, mbi ndonjë bazë tjetër, filluan në mënyrë të rregullt ta paguajnë kontributin në përputhje me Ligjin. Avokati i Popullit vazhdoi të ndërhyjë në të gjitha rastet e këtuja pas të cilave ndërhyrje qytetarët e realizonin të drejtën e tyre, përkatësisht çregjistroheshin dhe regjistroheshin dhe u jepeshin libreza shëndetësie kurse për borxhin e mbetur hapeshin procedura të parapara me ligj.

Të drejtën e pagesës së kompensimit të pagës për shkak të mungesës nga puna, si pasojë e sëmundjes apo shtatzënësisë dhe lindjes, edhe gjatë kësaj periudhe një pjesë e qytetarëve me vështirësi apo fare nuk mund ta realizonin.

Për një pjesë të këtyre parashtresave, Avokati i Popullit nuk pati mundësi të sigurojë mbrojtje të të drejtave ngaqë punëdhënësit nuk i kishin paguar kontributet, kurse në përputhje me ligjin, në qoftë se kontributet nuk paguhen me rregull, atëherë nuk mund të shfrytëzohet e drejta e theksuar. Në rastet kur krahas përmbushjes së kushteve ligjore për pagesë, ky kompensim nuk ishte paguar, Avokati i Popullit duke e konstatuar cenimin e të drejtave të qytetarëve dërgonte rekomandime deri te organet kompetente, të cilët në të shumtën e rasteve vepronin sipas rekomandimeve dhe në këtë mënyrë qytetarët e realizonin të drejtën e cekur.

Gjatë realizimit të të drejtës kushtetuese për mbrojtje shëndetësore, qytetarët kishin probleme edhe gjatë furnizimit me ilaçe, sidomos gjatë refundimit të mjeteve nga ana e Fondit të Sigurimit Shëndetësor në rastet kur ishin të detyruar ta paguanin shërbimin në tërësi apo të furnizoheshin me ilaç, i cili gjendet në të ashtuquajturën "listë private" me mjete vetjake. Po ashtu, gjatë realizimit të të drejtës për refundim të mjeteve, qytetarët edhe gjatë këtij viti ballafaqoheshin me probleme sa i përket dallimit ndërmjet çmimit të cilin ata e kishin paguar dhe çmimit të tenderit të caktuar nga ana e Fondit për Sigurim Shëndetësor. Edhe pse u ndërmorën disa masa për tejkalimin e këtij problemi Avokati i Popullit vlerëson se ky problem ende nuk është zgjidhur.

Në këtë periudhë kohore për të cilën raportojmë, janë parashtuar një numër i vogël i parashtresave, krahasuar me periudhat kohore të viteve të kaluara, që kishin të bënin me realizimin e të drejtës për mjekim jashtë shtetit dhe për njohjen e shpenzimeve të bëra nga ana e Fondit për Sigurim Shëndetësor, e që rezulton me konkluzionin se në lidhje me realizimin e kësaj të drejte në mënyrë konsekuente respektohen rregullat.

Gjatë periudhës kohore për të cilën raportojmë, u rritë numri i parashtresave që kishin të bënin me mjekimin e pandërgjeshëm dhe jociësor. Avokati i Popullit për shkak të zgjidhjes së problemeve kërkonte që tërësisht të shqyrtohen dhe të merren masa përkatëse si nga ana e klinikave apo enteve të tjera shëndetësore, ku janë dhënë shërbimet shëndetësore, ashtu edhe nga organet e tjera, përkatësisht nga Ministria e Shëndetësisë dhe nga Dhoma e Mjekëve të Maqedonisë.

Por, në një numër më të madh të rasteve pas zgjidhjes së rasteve nga ana e enteve shëndetësore u konstatua se nuk bëhet fjalë për mjekim të pandërgjegjshëm apo jociësor.

Sipas disa parashtresave që kishin të bënin me këtë çështje, Avokati i Popullit duke mos pasur mundësi që t'i vlerësojë përgjigjet e enteve shëndetësore dhe ta vlerësojë profesionalizmin e mjekëve, përkatësisht të vlerësojë nëse me të vërtetë janë marrë masa të mirëfillta në rastet konkrete, krahas takimit të mbajtur në Dhomën e Mjekëve të Maqedonisë kërkoi nga Ministria e

Shëndetësisë të bëjë mbikëqyrje profesionale mbi punën e mjekëve, por deri më sot nuk është informuar për masat e ndërmarra për verifikimin e vërtetë të gjendjes faktike.

Një problem i veçantë me të cilin ballafaqohen qytetarët gjatë realizimit të të drejtës për mbrojtje shëndetësore ishte edhe mosnjohja e të drejtës për refundimin e mjeteve për mjekim spitalor apo për tjetër lloj të mjekimit në shtëpitë shëndetësore private edhe atë vetëm për shkak të faktit se këto shtëpi shëndetësore nuk kishin lidhur marrëveshje me Fondin për Sigurim Shëndetësor. Duke e pasur parasysh faktin se nuk kishte bazë ligjore për mosnjohjen e shpenzimeve vetëm për shkak të moskontraktimit të marrëveshjes, me ndryshimet e fundit të ligjit, është paraparë që refundimi i mjeteve për shërbime shëndetësore në shtëpitë shëndetësore private, të bëhet vetëm nëse shtëpia shëndetësore ka lidhur marrëveshje me Fondin për Sigurim Shëndetësor.

Duke pasur parasysh faktin se në periudhën paraprake nuk ekzistonte një dispozitë e këtillë ligjore, Avokati i Popullit konstatoi cenimin e të drejtave të qytetarëve dhe kërkoi që Fondi qytetarëve t'ua refundoj mjetet. Në disa raste, rekomandimet u mirëpritën dhe parashtruesve të parashtrësive iu njohën dhe iu paguan mjetet e mjekimit apo shërbimeve të tjera shëndetësore në shtëpitë shëndetësore private. Por, një pjesë e rekomandimeve nuk u morën parasysh pasi që Fondi dhe organi i shkallës së dytë e ndryshuan qëndrimin dhe filluan të mos i njohin shpenzimet e qytetarëve dhe për këtë shkak qytetarët ishin të detyruar të hapin kontest administrativ.

Për parashtrësat në këtë fushë edhe pse edhe gjatë vitit 2005 nuk ishin në një numër të madh, krahasuar me parashtrësat nga fushat e tjera, Avokati i Popullit nuk mund të jetë i kënaqur sa i përket realizimit dhe respektimit të të drejtave të qytetarëve, sidomos nga aspekti i vendimmarrjes me kohë, të shpejtë dhe efikase, sipas kërkesave të qytetarëve, përkatësisht procedura zvarritet pa arsye para organeve të shkallës së parë dhe atyre të shkallës së dytë, si dhe sipas kërkesave, sugjerimeve dhe rekomandimeve të Avokatit të Popullit.

**2,06 %**

nga numri i  
përgjithshëm i  
parashtrësive të  
pranuara

## Të drejtat e fëmijës

Nga veprimi i Avokatit të Popullit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve mund të konstatohet se në këtë plan gjendja edhe më tej nuk ka ndryshuar shumë dhe kjo do të thotë se fëmijët akoma nuk janë në rend të parë gjatë ndërmarrjes së masave konkrete ose gjatë krijimit të politikës së shtetit, e që manifestohet me numrin e madh të parashtrësive të parashtruara nga kjo fushë në vitin 2005.

Fëmijët akoma pranë Avokatit të Popullit nuk paraqiten vetë për t'i mbrojtur të drejtat e tyre, por në të shumtën e rasteve në emër të tyre, parashtrësia parashtrëjnë prindërit e tyre, e që lë të kuptohet se fëmijët jo sa duhet i njohin të drejtat dhe detyrimet, jo mjaftueshëm dinë për Avokatin e Popullit dhe kompetencat e tij dhe aftësia e tyre për vetëmbrojtje gjatë cenimeve dhe abuzimeve të të drejtave të tyre ende nuk është në nivelin e kënaqshëm. Sipas kësaj, Avokati i Popullit edhe më tej vlerëson se në të gjitha shkallët e procesit arsimor duhet të aplikohet mësimi i të drejtave të fëmijës dhe ata të aftësohen për vetëmbrojtje nga cenime dhe abuzime të ndryshme.

Pjesa më e madhe e parashtrësive të pranuar gjatë vitit 2005, kanë të bëjnë me realizimin e të drejtave të fëmijës për mbajtjen e kontakteve personale me prindërit me të cilët nuk jeton, por lëndë e këtyre parashtrësive më së shumti ka qenë realizimi i të drejtës së prindërve të mbajnë kontakte personale me fëmijën, me ç'rast parashtruesit jo çdo herë kanë mbajtur llogari për të drejtat e fëmijës.

Me zbatimin e dispozitave, nga ndryshimet e fundit të Ligjit për familjen, me të cilat janë paraparë më tepër masa, të cilat mundësojnë realizimin dhe respektimin e të drejtave të fëmijës për të mbajtur kontakte personale me të dy prindërit dhe kjo e drejtë të mos keqpërdoret në dëm të interesave të fëmijës, gjatë vitit 2005 u regjistrua numër i vogël i parashtrësive të parashtruara pranë Avokatit të Popullit. Mirëpo, edhe përkrah masave të parapara ligjore për realizimin e kësaj të drejte të fëmijës, prindërit shpesh herë tentojnë që ta pamundësojnë një gjë të tillë ose ta kufizojnë përmes anashkalimit të dispozitave ligjore.

Megjithatë, Avokati i Popullit konsideron se ndryshimet e dispozitave ligjore sigurojnë realizimin në konsekuent të të drejtës së fëmijës për mbajtjen e kontakteve personale me prindërit me të cilët nuk jeton.

Problem i veçantë gjatë realizimit të kësaj të drejte janë edhe procedurat e zgjatura gjyqësore për shkurorëzim të bashkëshortësisë dhe për atë se cilit prind do t'i takojë fëmija, ngaqë shpesh herë ndërprehen lidhjet e fëmijës me njërit prind, ndërsa pas divorcit fëmija i jepet njërin prind, dhe më vonë vështirë rivendosen këto kontakte për shkak të gjendjes irrituese të prindit të cili fëmija jeton e që refuzon ta kontaktojë fëmijën me prindin tjetër, me të cilin për shkak të procedurës së gjatë gjyqësore, kohë më të gjatë nuk ka pasur kontakte të rregullta personale.

Një pjesë e problemeve, të cilat paraqiten gjatë realizimit të të drejtës së fëmijës për të mbajtur kontakte të rregullta dhe normale me prindin me të cilin nuk jeton, janë edhe marrëdhëniet e ndërsjella të çrregulluara familjare të prindërve. Në rastet e këtilla, Qendra për punë sociale për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, mund që prindërit dhe fëmijët t'i udhëzojë të vizitojnë këshillimore të veçanta, të cilat do të ndihmonin që prindërit t'i tejkalojnë marrëdhëniet konfliktuoze, ndërsa fëmija t'i tejkalojë traumat që pasojnë nga sjellja joadekuate e prindërve. Por, në Republikën e Maqedonisë nuk ekzistojnë këshillimore speciale, të cilat rregullisht do të punonin me fëmijët dhe familjet problematike. Gjithashtu, në raste të marrëdhënieve të çrregulluara, Qendra për punë sociale mundet që fëmijët, njërin ose të dy prindërit t'i udhëzojë të shkojnë në institucion të veçantë shëndetësorë, ndërsa për momentin ky është Enti për shëndet mendor. Por, shpesh herë prindërit rezistojnë të kenë një trajtim të tillë apo fëmijët e tyre t'i dërgojnë në entin për shëndet mendor. Prandaj, propozohet që në kuadër të qendrave për punë sociale ose në kuadër të enteve për shëndet mendor, të formohet seksion i veçantë profesionistë për bashkëshortësi dhe familje, në të cilin do të inkuadroheshin më tepër profile profesioniste nga fusha të ndryshme. Seksioni do të punonte falas, pra pa kompensim të veçantë, sepse prindërit shpesh herë për shkak të mospasjes së mjaftueshme të mjeteve nuk i vizitojnë entet për shëndet mendor.

Për shkak të përfshirjes së fëmijëve në marrjen e vendimeve për mbajtje të kontakteve personale me prindin me të cilin jetojnë, me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për familjen, parashikohet që gjatë rregullimit të kësaj çështjeje, Qendra për punë sociale ta njoftojë fëmijën dhe t'i marrë parasysh qëndrimet dhe mendimet e tij, varësisht nga mosha që ka, pjekuria dhe shkalla e zhvillimit dhe ta njoftojë me pasojat e mundshme të vendimeve. Në përputhje me këto dispozita ligjore, Avokati i Popullit në mënyrë të veçantë bën përpjekje të realizohet dhe respektohet kjo e drejtë e fëmijës, me ç'rast në raste të caktuara u sugjeronte qendrave që për vendimet e këtilla, t'i kushtojnë vëmendje mendimit, nevojës dhe interesave të fëmijëve. Për fat të keq, sipas Qendrës për punë sociale, në numrin më të madh të rasteve, fëmijët mendimet e tyre i shfaqin nën presionin e njërit prind dhe shpesh janë të irrituar.

Disa parashtrësia që u parashtruan, për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, kishin të bënin me caktimin e tutorit ose akomodimin në familje përkujdesëse. Sidomos, karakteristik ishte rasti kur fëmijët pa kujdes prindërorë, u akomoduan në familje përkujdesëse, të gjyshja dhe gjyshi, të cilëve për shkak se kishin lidhje familjare nuk ua pranonin kompensimin e vlerës së plotë për përkujdesje. Avokati i Popullit vlerësoi se veprohej në kundërshtim me rregullat ligjore dhe nënligjore, sipas të cilave nuk ka rëndësi se ku janë përkujdesur fëmijët, tek farefisët ose në ndonjë familje tjetër përkujdesëse, prandaj dhe kërkoi që edhe kësaj familje t'i paguhej kompensimi i plotë si familje përkujdesëse, e që u pranua dhe u bë kompensimi retroaktiv për familjen përkujdesëse.

Gjatë kësaj periudhe pranë Avokatit të Popullit u parashtruan disa parashtrësia të cilat kishin të bënin me realizimin e të drejtës së shtesës fëmijërore, me ç'rast Avokati i Popullit konstatoi se edhe më tej, sipas dispozitave të vlefshme ligjore, shtesën për fëmijë nuk mund ta realizojnë fëmijët, të cilët nuk janë të përfshirë në procesin e rregullt arsimor dhe fëmijët, prindërit e të cilëve nuk kanë



kurfarë të ardhurash, përkatësisht që nuk janë të punësuar, nuk janë pensionistë e as nuk pranojnë kompensim për shkak të papunësisë dhe të cilët nuk kanë të drejtë të paraqesin kërkesë për ta realizuar të drejtën e shtesës fëmijërore. Duke i pasur parasysh dispozitat e këtylla ligjore, si dhe duke u nisur nga e drejta e fëmijës për standard përkatës jetësor, i cili sigurohet edhe përmes shtesës për fëmijë Avokati i Popullit, sikurse edhe gjatë viteve të kaluara, edhe këtë vit konsideron se duhet të bëhen ndryshime të dispozitave ligjore si dhe të parashikohet mundësia që të gjithë fëmijët, që kanë gjendje materiale të vështirë, të mund ta realizojnë të drejtën e shtesës fëmijërore. Njëkohësisht, duke pasur parasysh varfërinë, çdo ditë e më të madhe të familjeve, për shkak të të cilës më së shumti pësojnë fëmijët, Avokati i Popullit, sikurse në periudhën e mëparshme edhe tani, konsideron se shteti duhet ta parashikojë me ligj detyrimin për sigurimin dhe garantimin së paku të standardit minimal të jetesës për çdo fëmijë, sepse sipas Konventës për të drejtat e fëmijës, shteti detyrohet që çdo fëmijë t'i sigurojë standard jetësor adekuat me zhvillimin mendor, shpirtëror, moral dhe zhvillimin në përgjithësi.

Avokati i Popullit edhe gjatë vitit 2005, intervenoi për regjistrimin e fëmijëve në librin amzë të të lindurve, meqë konstatoi se një numër i madh i fëmijëve akoma nuk janë të evidentuar dhe për këtë shkak nuk mund t'i realizojnë edhe të drejtat e tjera. Në të shumtën e rasteve, prindërit nuk e paraqesin me kohë lindjen e fëmijës, nëse ka lindur në kushte të shtëpisë, por edhe në këto raste, pas intervenimit të Avokatit të Popullit gjenden mënyra për t'u dëshmuar dhe për t'u bërë regjistrimi i fëmijëve në evidencën amzë.

Për shkak të mbrojtjes të të drejtave të fëmijëve nga dhuna, sidomos nga dhuna familjare, janë bërë plotësime dhe ndryshime të Ligjit për familjen, me të cilat veçmas trajtohet dhuna në familje mbi fëmijën dhe parashikohen më tepër masa, të cilat mund t'i ndërmarrin qendrat për punë sociale dhe gjykatat, në drejtim të mbrojtjes së fëmijëve viktimat të dhunës familjare. Për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna familjare, gjatë vitit 2005, pranë Avokatit të Popullit janë parashtruar më tepër parashtrësia.

Nga parashtrësia e parashtruar, mund të konstatohet se si persona të cilën kryejnë dhunë, paraqiten edhe nëna edhe babai, por në numrin më të madh të rasteve ky është babai. Gjithashtu, ka pasur edhe raste kur fëmijët e vendosur nëpër familjet përkujdesëse kanë qenë viktimat të dhunës nga ana e tutorëve të tyre. Në të gjitha këto raste Avokati i Popullit nga qendrat për punë sociale dhe Ministria për Punë të Brendshme kërkonte që me ligj t'i ndërmarrin të gjitha masat që parashikohen për mbrojtjen e viktimave nga dhuna familjare. Në numrin më të madh të rasteve, ku ekzistonte bashkëpunimi i anëtarëve të familjes me qendrën, u ndërmorën masa përkatëse, por ndonjëherë madje edhe pas sugjerimit të Avokatit të Popullit, viktimat e dhunës, sidomos gratë, nuk dëshironin ta denonconin dhunën dhe të bashkëpunonin me qendrën për punës sociale.

Si problem për joefektivitetin e masave për mbrojtjen e viktimave nga dhuna në familje, janë procedurat e zgjatura gjyqësore, sidomos për kumtimin e masës së përkohshme kundër personit i cili ushtron dhunë familjare. Me shqiptimin jo në kohë të masave të përkohshme, jo vetëm se mbrojtja e viktimës nuk ka efekt, por situata edhe më tepër përkeqësohet për shkak të hapjes së procedurës gjyqësore. Problem i veçantë gjatë mbrojtjes së fëmijëve, viktimat të dhunës familjare, është mosekzistimi i këshillimoreve ose të qendrave të tjera, ku do të ndahej personi që ushtron dhunë, ndonëse masë e tillë është parashikuar me ligj. Për këtë shkak më së shpeshti fëmija ndahet nga familja biologjike, me çka i shkaktohen trauma plotësuese.

Gjatë vitit për të cilin raportojmë, ka edhe disa parashtrësia, të cilat kanë të bëjnë me keqtrajtimin psikik apo fizik të nxënësve nga ana e kuadrit arsimor. Avokati i Popullit vuri në dukje se në dispozitat ligjore nuk është precizuar dhe objektivizuar siç duhet noicion se ç'është keqtrajtim fizik e çka psikik i fëmijëve në shkollë dhe se në rast të zbatimit të shpeshtë të keqtrajtit fizik ose psikik nga ndonjë mësues, duhet të parashikohet edhe masa e ndalimit të ushtrimit të veprimtarisë mësimore, me qëllim që personat e këtyllë të mos jenë të inkuadruar në procesin arsimor dhe edukativ të fëmijëve. Për fat të keq, propozimet e Avokatit të Popullit deri më tani nuk janë shqyrtuar me seriozitetin e nevojshëm, dhe pikërisht për këtë shkak fëmijët çdo ditë e më tepër ankohen për keqtrajtime fizike dhe sidomos keqtrajtime psikike nga ana e mësuesve, e që në të shumtën e rasteve mbeten të pandëshkuar. Në disa raste konkrete, që kishin të bënin me keqtrajtime fizike dhe psikike të fëmijëve në shkollë, organet kompetente jo me kohë kanë reaguar dhe nuk kanë ndërmarrë masa pas sugjerimeve dhe rekomandimeve të Avokatit të Popullit.

Njëri nga parimet themelore të Konventës për të drejtat e fëmijës është pjesëmarrja e fëmijëve në vendimmarrjet, të cilat kanë të bëjnë me ta, ndërsa kjo do të thotë e drejtë e fëmijëve për ta shfaqur mendimin e tyre dhe mendimit të tyre ti përkushtohet vëmendje e detyrueshme. Mirëpo, nxënësit pohojnë se shumë rrallë ju jepet e drejta për ta shfaqur mendimin e tyre për çështje të caktuara në arsim dhe në shkollë dhe se edhe më pak respektohet mendimi i tyre. Së këtejmi, Avokati i Popullit konsideron se ky parim i Konventës nuk respektohet sa duhet dhe prandaj krijohen parakushte për keqpërdorimin e fëmijëve, diskriminim dhe mosrespektimin e interesave të tyre.

Gjatë vitit 2005, si problem i cili nxiti reagimin e prindërve për shkak të rrezikimit të të drejtave të fëmijëve, qenë paralajmërimet për ndërprerjen e mësimin të qëndrimit ditor, përkatësisht për ndërprerjen e financimit të tyre nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë, me propozimin që shpenzimet t'i bartin vetë prindërit. Duke e pasur parasysh faktin se përmbajtjet mësimore, të shkollave ku është aplikuar qëndrimi ditor, shparndahen gjatë gjithë ditës, u vlerësua se me ndërprerjen e qëndrimit ditor do të pamundësohet realizimi i përmbajtjeve mësimore dhe njëkohësisht fëmijët do të mbeten në rrugë, përkatësisht pa përkujdesje. Për këtë arsye, qëndrimi ditor vazhdoi deri në fund të vitit, ndërsa në ndërkohë prindërit mblodhën nënshkrime për ndryshimin e normave ligjore dhe për aplikimin e mësimin me qëndrim ditor si mundësi.

Problem i veçantë, për të cilin intervenoi Avokati i Popullit, ishte lirimi i nxënësve të shkëlqyeshëm të shkollave të mesme nga provimi përfundimtar. Avokati i Popullit konstatoi dhe i sugjeroi Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës se vepron në kundërshtim me Ligjin, me të cilin nuk parashikohet mundësia e lirimimit nga provimi përfundimtar dhe i maturës për nxënësit e shkëlqyeshëm. Mirëpo, nën trysinë e nxënësve dhe prindërve, nxënësit e shkëlqyeshëm u liruan në bazë të aktit nënligjor të vitit 1993, i cili tanimë nuk është në fuqi.

Të drejtat e fëmijës duhet të respektohen dhe mbrohen edhe nëpër institucionet parashkollore, përkatësisht kopshtet. Nga vizitat e bëra në disa kopshte, mund të konstatohet se përmes lojërave dhe aktiviteteve të tjera kreative, fëmijët i fitojnë njohuritë e para për të drejtat e njeriut. Por, në numrin më të madh të kopshteve përkujdeset numër i madh i fëmijëve nga ajo që parashikohet me standarde dhe kështu pamundësohet puna individuale me secilin fëmijë ose me grupe më të vogla. Sidomos brengos fakti se në kopshtet ku janë përkujdesur fëmijët me nevoja, nuk ka ekipe profesioniste, të cilat do të punonin ndaras me këta fëmijë. Për punën me këta fëmijë nuk ka të punësuar defektologë, e që do të ndikonin në përfshirjen e tyre më të lehtë në jetën shoqërore. Mirëpo, edhe përkundër mungesës së kuadrit profesionistë ka vend për të shprehur kënaqësinë sa i përket avancimit të pranimit dhe socializimit të fëmijëve me nevoja të veçanta së bashku me fëmijët e tjerë, me çka nuk janë stigmatizuar dhe izoluar.

Pas ndërhyrjeve shumëvjeçare të Avokatit të Popullit për ndërmarrjen e masave për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve që rrinë në rrugë me ndryshimet dhe plotësimet e bëra në Ligjin për mbrojtje sociale, parashikohet mundësia për sigurimin e mbrojtjes sociale të fëmijëve që rrinë në rrugë, ndërkohë që është parashikuar edhe formimi i qendrave ditore për këtë kategori të fëmijëve. Për shkak të shqyrtimit të rezultateve të punës së qendrës ditore për fëmijët e rrugës, Avokati i Popullit vizitoi Qendrën ditore në Shkup, me ç'rast konstatoi se në Qendër kanë kaluar 265 fëmijë.

Numri më i madh i fëmijëve të regjistruar janë të bashkësisë rome. Në Qendrën ditore, fëmijëve u mësohet shkrim – leximi, ata i mësojnë shprehitë themelore higjienike si dhe merren me aktivitete të tjera të lira, me qëllim që të shmangen nga rruga dhe të socializohen. Duke pasur parasysh faktin se numri më i madh i këtyre fëmijëve nuk përcjellin procesin mësimor, madje as arsimin fillor, Qendra ditore bën përpjekje që t'i përfshijë në arsimin fillor, mirëpo shpesh herë këto përpjekje nuk rezultojnë me sukses, ngaqë fëmijët nuk posedojnë asnjë dokument, sepse nuk janë të evidentuar në evidencën amzë të të lindurve. Gjatë inspektimit të kryer është konstatuar se edhe më tej në masë të vogël punohet me familjen, përkatësisht me prindërit e këtyre fëmijëve, ndonëse shumë shpesh ata janë shkak që fëmijët rrinë në rrugë. Ekipi profesionistë i Qendrës ditore i viziton familjet, por Qendra për punë sociale jo me rregull bën mbikëqyrjen e të drejtës prindërore, sepse sipas personave përgjegjës, nuk ka kuadër të mjaftueshëm profesionistë, i cili do të mund t'i përfshinte të gjitha familjet, në të cilat janë regjistruar fëmijë që rrinë në rrugë. Megjithatë, me funksionimin e deritanishëm të Qendrës ditore janë arritur rezultate pozitive, sepse fëmijët e përfshirë, në të shumtën e rasteve më nuk i kthehen rrugës.

Me qëllim të zvogëlimit të numrit të fëmijëve që rrinë në rrugë, të cilët qëndrojnë aty për shkak të varfërisë dhe kushteve të këqija të banimit, e domosdoshme është që shteti të ndërmerr masa për përmirësimin e gjendjes materiale dhe strehimore të familjeve të këtyre fëmijëve, duke punësuar së paku nga një anëtar të familjes ose me ndarjen e llojit të veçantë të ndihmës sociale në para dhe në natyrë (ushqim, veshmbathje, materiale të nevojshme për shkollë dhe ngjashëm). Në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe njësitë e vetadministrimit lokal, Qendra ditore detyrimisht duhet të jetë falas. Me qëllim që t'u ndihmohet familjeve, nga aspekti i gjendjes materiale, të cilat në të shumtën e rasteve janë shkaku kryesor që fëmijët nuk shkojnë shkollë, Avokati i Popullit sikurse edhe gjatë periudhës së kaluar, edhe me këtë rast propozon që me ligj të parashikohet mundësia dhe detyrimi për përkrahje materiale me qëllim që fëmijët të vijojnë procesin arsimor fillor, në rastet kur ata nuk vijojnë arsimin për shkak të gjendjes së vështirë materiale.

Me qëllim të tejkalimit të botëkuptimeve tradicionale të prindërve të fëmijëve që rrinë në rrugë dhe edukimit të tyre, si edhe për shkak të parandalimit të abuzimit të fëmijëve nga ana e prindërve, Avokati i Popullit konsideron se nevojitet ekip profesionistë, i cili do të punonte më tepër me prindërit e këtyre fëmijëve, ndërsa qendrat për punë sociale, fëmijët që i gjejnë në rrugë detyrimisht duhet të bëjnë mbikëqyrje mbi të drejtën prindërore dhe po qe se masat e para nuk ndihmojnë, pranë gjykatave të paraqiten edhe propozime për kufizimin ose heqjen e të drejtës prindërore.

Duke i marrë parasysh rezultatet e arritura pozitive nga funksionimi i qendrave ditore, do të duhej të hapeshin më tepër qendra ditore në rajonet ku jetojnë këta fëmijë, me qëllim që të kenë qasje më të lehtë, ndërsa qendrat të punojnë nga 24 orë, me qëllim që eventualisht mos shfaqet nevoja për përkujdesje të ndonjë fëmije të hasur në rrugë gjatë orëve të natës. Fëmijët që rrinë në rrugë rëndomë nuk kanë sigurim shëndetësor dhe kjo i pamundëson ata që të shfrytëzojnë mbrojtje shëndetësore. Prandaj, është e domosdoshme që të gjenden mënyra dhe mjete për shfrytëzimin falas të shërbimeve shëndetësore dhe furnizimin falas me barnat e nevojshme.

Për shkak të përfshirjes së fëmijëve në punën e Avokatit të Popullit dhe shfaqjes së mendimit të tyre, përkatësisht për shkak të realizimit të të drejtës së tyre për marrje pjesë për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat dhe interesat e tyre, edhe gjatë vitit 2005 vazhdoi puna me Këshillin e fëmijëve.

Gjatë periudhës së mëparshme, me propozimet dhe mendimet e Këshillit të fëmijëve, Avokati i Popullit e njoftoi Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës dhe Qeverinë e Republikës së Maqedonisë, duke shpresuar se me seriozitet do të shqyrtohen propozimet e fëmijëve dhe do të ndërmerren masa në kuptimin e ndryshimit dhe plotësimit të normave ligjore dhe zbatimit të tyre, për shkak të krijimit të kushteve për realizimin, respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Për sigurimin e mbrojtjes së shpejtë dhe efektive të të drejtave të fëmijëve, domosdo nevojitet bashkëpunim më i mirë midis organeve dhe organizatave, si edhe me sektorin joqeveritar. Bashkëpunimi i Avokati i Popullit me organet e administratës shtetërore edhe gjatë kësaj periudhe kohore është në nivel të kënaqshëm. Megjithatë, për shkak se ndonjëherë nuk veprohet në kohë sipas kërkesave, mendimeve dhe rekomandimeve të Avokatit të Popullit, vjen deri te cenimi i të drejtave të fëmijëve. Prandaj, Avokati i Popullit konsideron se akoma ka nevojë për ndërmarrje të masave në vazhdimësi për t'u krijuar kushtet për realizimin e të drejtave të fëmijëve dhe se shteti fëmijëve duhet t'u krijojë kushte materiale dhe mundësi të tjera për rritje dhe zhvillim normal, jetë të sigurt, nivel më të lartë të mbrojtjes shëndetësore dhe të gjitha të drejtat e tjera të garantuara me Konventën për të drejtat e fëmijës.

# 1,24 %

nga numri i  
përgjithshëm i  
parashtresave të  
pranuara

## Arsimi

Arsimi i lartë tanimë nuk është i arritshëm për të gjithë qytetarët, për shkak të pamundësisë që t'i bartin shpenzimet e studimit. Sipas Avokatit të Popullit, gjendja e studentëve vështirësohet jo vetëm për shkak të participimit të paraparë, por edhe me aplikimin e detyrimeve të ndryshme nga ana institucioneve të larta arsimore, me të cilat obligohen të gjithë studentët, pavarësisht se a janë regjistruar me participim apo me të ashtuquajturën kuotë shtetërore. Duke vepruar sipas parashtresave, të cilat kanë të bëjnë me participimin e studentëve në shpenzimet e studimeve, Avokati i Popullit para së gjithash sugjeronte zbatimin konsekuent të normave ligjore në kuptimin e detyrimit, përkatësisht lirimit nga participimi, ndërsa gjatë aplikimit të shpenzimeve të ndryshme, të cilat duhet t'i paguajnë studentët, sugjeroi që të mbahet llogari për bazat ligjore për aplikimin e këtyre shpenzimeve dhe mbrojtjen dhe avancimin e standardit të studentëve. Pas ndërhyrjes së Avokatit të Popullit për aplikimin e kompensimeve vetëm për shërbimet e parapara me ligj dhe për njësimin e këtyre kompensimeve në të gjitha institucionet publike të arsimit të lartë, gjatë vitit 2005 hyri në fuqi lista e vetme e çmimeve për detyrime administrative – teknike, e miratuar nga Këshilli për zhvillim dhe financim të veprimtarisë së arsimit të lartë. Lista e çmimeve u dërgua pranë të gjitha fakulteteve me obligim që të harmonizohen çmimet e shërbimeve.

Parashtresat që kishin të bënin me bashkëfinancimin e studimeve, në të shumtën e rasteve u parashtruan në bazë të Ligjit për të drejta të veçanta të pjesëtarëve të forcave të sigurimit të Republikës së Maqedonisë dhe anëtarëve të familjeve të tyre, të cilët konsideronin se duhet të lirohen nga participimi. Së këtejmi, disa parashtresa u parashtruan nga pjesëtarë të forcave të sigurimit, me kërkesë që fëmijët e tyre të lirohen nga participimi, vetëm për faktin se ata kanë qenë pjesëtarë të forcave të sigurimit të Republikës së Maqedonisë. Në këto raste, Avokati i Popullit nuk kishte bazë për të ndërmarrë masa, sepse të drejtën e lirimit mund ta shfrytëzojnë vetëm pjesëtarët e forcave të sigurimit, të cilët personalisht regjistrohen në institucion të arsimit të lartë ndërkaq, fëmijët e tyre mund të lirohen nga participimi vetëm nëse prindi, pjesëtar i forcave të sigurisë, ka ndërruar jetë apo nëse është vrarë ose po qe se është shpallur invalid.

Në drejtim të bashkëfinancimit, kishte raste kur në marrëveshjen e lidhur ndërmjet fakultetit dhe studentëve ishte paraparë që participimi për çdo vit akademik të përcaktohej sipas konkursit për vitin shkollor përkatës. Mirëpo, duke e pasur parasysh faktin se participimi ishte më i ulët gjatë viteve që pasuan, krahasuar me participimin kur ishte lidhë marrëveshja, fakulteti nuk e respektonte marrëveshjen e nënshkruar dhe participimin e përcaktuar e arkëtonte me konkursin, sipas të cilit ishte regjistruar studenti, ndërkaq ky ka qenë me shumë dukshëm më të lartë. Duke vlerësuar se në këtë mënyrë cenohen të drejtat e studentit dhe parimi i sigurisë ligjore, Avokati i Popullit ndërhyri me qëllim që të respektohej marrëveshja e nënshkruar mes fakultetit dhe studentit, me ç'rast studenti ishte obliguar me participim varësisht nga lartësia e participimit të përcaktuar me konkurset për çdo vit shkollor. Rekomandimi i Avokatit të Popullit u përkrah dhe u veprua në përputhje me dispozitat e marrëveshjes së nënshkruar.

Në lidhje me regjistrimet dhe të drejtat e studentëve në institucionet e larta arsimore, kishte edhe parashtresa të paraqitura nga një grup studentësh të transferuar nga Universiteti i Tetovës në Universitetin "Shën Cirili e Metodi" në Shkup, të cilët nga Avokati i Popullit kërkuan të ndërmer masa për përshpejtimin e procedurës së regjistrimit të tyre në semestrin përkatës. Pas ndërhyrjeve të Avokatit të Popullit, studentëve iu mundësua që nga disa herë të mund të hynin në provimin e kontrollimit të njohurive të materies mësimore, me qëllim që të verifikohet drejtë se në cilin semestër duhej të regjistroheshin. Kështu, u bë regjistrimi i çdo studenti në semestrin përkatës.

Gjatë vitit për të cilin raportojmë, kishte edhe parashtrësia të cilat kishin të bënin me ndarjen e bursave dhe kredive për studime, me ç'rast Avokati i Popullit konstatoi se jo vetëm që zvarritet procedura për dërgimin e përgjigjes pranë Avokatit të Popullit, por zvarritet apo fare nuk dërgohet përgjigja sipas kërkesave të qytetarëve.

U konstatua se për refuzimin e kërkesave për ndarjen e bursave nuk miratohej aktvendim i veçantë, por palët njoftoheshin me letra të zakonshme, të cilat dërgoheshin me postë të rëndomtë kështuqë Ministria nuk kishte prova për atë se a e ka pranuar pala njoftimin. Së ketejmi, palët të cilët u drejtuan pranë Avokatit të Popullit pohonin se nuk kanë pranuar kurrfarë njoftimit dhe kjo i pamundësonte të paraqisnin kundërshtim. Nga ana tjetër, kur paraqiteshin kundërshtime, nuk vendosej me kohë dhe nuk merreshin aktvendime. Në lidhje me këto mënyra të veprimit jokonsekuent, krahas informatave me shkrim dhe gjatë inspektimit të bërë në Ministri, u sugjerua se për çdo kërkesë duhet të vendoset me aktvendim, dhe pastaj palët të njoftohet me shkresë të dërguar me rekomandim, sepse vetëm kështu u mundësohet e drejta e paraqitjes së kundërshtimit dhe mjeteve të tjera ligjore, me të cilat realizohen të drejtat.

Sa i përket pranimit të dokumenteve për ndarjen e kredive dhe bursave të nxënësve, vazhdoi praktika jopërkatese, që nëpunësi i cili i pranon dokumentet të refuzojë t'i pranojë me pretekst se sipas tij, nuk janë plotësuar kushtet. Sipas deklaratave të palëve, në rastet kur ata insistojnë që t'u pranohen dokumentet, nga palët kërkohet që të japin deklaratë të nënshkruar se paraqesin dokumente të pakompletuara. Avokati i Popullit konsideron se me mënyrën e këtillë të veprimit, në të vërtetë për të drejtën e palës, vendosë personi, i cili i pranon dokumentet, e jo nga organi kompetent, dhe prandaj sa më parë duhet të ndërpritet praktika e këtillë, ky sugjerim është dhënë edhe gjatë viteve të mëparshme.

Gjatë vitit për të cilin raportojmë, pranë Avokatit të Popullit u parashtrua vetëm një parashtrësë, e cila kishte të bënte me akomodimin e studentëve në konvikte, megjithatë Avokati i Popullit sërish vuri në dukje nevojën për shmangien e lëshimeve dhe paligjshmërive gjatë akomodimit të studentëve nëpër konvikte, sidomos sa i përket caktimit të numrit të pikëve sipas kriterëve të caktuara.

Problem aktual gjatë vitit 2005, sipas të cilit vepronte Avokati i Popullit, ishte dhënia e provimit të veçantë për drejtorë të shkollave fillore, me ç'rast ndërhyrje nga Avokati i Popullit për dhënien e provimit të veçantë kërkuan persona të cilët nuk kishin kryer arsimin e lartë dhe nuk i plotësonin kushtet ligjore për drejtor, por megjithatë kanë qenë të zgjedhur për drejtorë. Kërkesat e këtyre drejtorëve janë refuzuar, sepse të drejtë për dhënie të provimit të drejtorëve kishin vetëm personat që i përmbushnin kushtet ligjore për drejtorë në shkollat fillore.

Lidhur me bashkëpunimin e Avokatit të Popullit me organet kompetente të arsimit edhe në periudhën kohore për të cilën raportojmë, nuk mund të konstatohet se ka ndonjë përmirësim, sepse në numrin më të madh të rasteve nuk është vepruar sipas kërkesave të tij brenda afatit ligjor, ndërsa në disa raste edhe pas më tepër urgjencave nuk dërgoheshin përgjigje. Për tejkalimin e këtyre problemeve dhe barrierave në punën e Avokatit të Popullit, për një pjesë të parashtrësive u dërguan informata pranë ministrit të Arsimit dhe Shkencës, ndërsa për të tjerat për shkak të mosndërmarrjes së masave nga ana e ministrit u dërguan informata të veçanta pranë Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.

Sjellja e këtillë e organeve dhe organizatave sjellë deri te marrja e vendimeve të paefektshme dhe të papërgjegjshme për të drejtat e qytetarëve, si dhe pengon punën e Avokatit të Popullit.

**3,08 %**

nga numri i  
përgjithshëm i  
parashtresave të  
pranuara

## Të drejtat e konsumatorëve

Nga të dhënat, të cilat rezultojnë nga analizat e bëra statistikore mbi punën e Avokatit të Popullit, mund të konstatohet se gjatë vitit 2005 është zvogëluar numri i lëndëve nga fusha e të drejtave të konsumatorëve.

Gjendja e këtillë, nga e cila mësojmë se qytetarët reagojnë në përmasa më të vogla, sa i përket veprimit të dhënësve të shërbimeve, Avokati i Popullit konsideron se është shkaktuar nga shkalla më e lartë e respektimit të dispozitave ligjore nga ana e kryerësve të shërbimeve publike.

Njëkohësisht, Avokati i Popullit konsideron se ndikim të mirëfilltë për trendin pozitiv të mirësjelljes së institucioneve me prokurime publike në pjesën e të drejtave të konsumatorëve ka edhe aktiviteti i deritanishëm i tij kur në mënyrë permanente ua bënte me dije detyrimet dhe obligimet që i kanë ndaj shfrytëzuesve të shërbimeve të tyre, me ç'rast u arritë një nivel përkatës i komunikimit dhe bashkëpunimit për realizim më efikas dhe mbrojtje të të drejtave dhe interesave të konsumatorëve.

Megjithatë, ky vlerësim i përgjithshëm për veprimin e dhënësve të shërbimeve nuk është i mjaftueshëm, ngaqë Avokati i Popullit vlerëson se ndërmjet dhënësve të shërbimeve dhe qytetarëve – shfrytëzues të shërbimeve, ende nuk është ndërtuar një shkallë përkatëse profesionale dhe e kënaqshme e komunikimit.

Në këtë kontekst, një faktor i rëndësishëm dhe i pamohueshëm është konstelacioni i pavolitshëm i segmenteve të parregulluara, përkatësisht mungesa ligjore përmes së cilës do të përcaktohej vendosja e kushteve dhe do të pozicionoheshin subjektet – kryerës të shërbimeve publike nga aspekti i mirësjelljes në treg në vend të funksionimit monopolist aktual.

Konfirmim i këtij konstatimi është edhe vlerësimi i Avokatit të Popullit se Administrata e dikurshme monopoliste, tani Komisioni për mbrojtjen e konkurrencës, nuk ia doli të sigurojë mbrojtje dhe kontroll përkatës mbi abuzimet e mundshme në treg të kryera nga ana e monopoleve.

Pritet se me transformimin dhe me strukturimin e ri të Komisionit për mbrojtje të konkurrencës, janë krijuar supozime përkatëse për përballimin më të suksesshëm të dukurive monopoliste të dhënësve të shërbimeve.

Problemet, për të cilat qytetarët kanë kërkuar ndihmë nga Avokati i Popullit kishin të bënin pikërisht me shërbimet e kryerësve të veprimtarive publike, veçanërisht ndaj cilësisë së shërbimit, mënyrës së arkëtimit dhe lartësisë së çmimit të caktuar. Në tekstin në vijim do të përqendrohemi në këto tri fusha me interes publik.

Duke vepruar sipas parashtresave të qytetarëve, Avokati i Popullit ka konstatuar se një pjesë e tyre ka të bëjë me sjelljen e SHA “Telekomunikacionet e Maqedonisë”, si ushtrues të veprimtarisë me karakter publik.

Avokati i Popullit sërish konstatoi se SHA “Telekomunikacionet e Maqedonisë”, duke e shfrytëzuar pozitën monopoliste krijojnë edhe kushtet e telefoninë fikse, me ç'rast qytetarët – abonuesit, çdo herë gjenden në situatë të palakueshme për t'i pranuar kushtet që ju ofrohen gjatë vendosjes së marrëdhënieve për parapagim, pa marrë parasysh se a përkojnë ato me situatën materiale të tyre.

Duke i vlerësuar situatat aktuale, veçanërisht në pjesën e përpilimit dhe operacionalizimit të një norme përkatëse, Avokati i Popullit shpreson se brenda një afati sa më të shkurtër të miratohen

aktet e nevojshme nënligjore, me të cilat do të zbatohet Ligji për komunikime elektronike, në ç'rast do të mundësohet demonopolizimi i SHA "Telekomunikacionet e Maqedonisë" dhe më në fund në telefoninë fikse të fillojë të funksionojnë operatorë të rinj.

Konkretisht një pjesë e kërkesave të parashtruesve, të cilët iu drejtuan Avokatit të Popullit kishin të bënin me shumat e larta të faturave, për të cilat nuk ekziston mundësi minimale objektive që të përcaktohet gjendja faktike, përkatësisht të verifikohen provat e qytetarëve për abuzime eventuale nga persona të tretë apo ekzistimi i ndonjë gabimi të pajisjes ose instalimeve të operatorit publik të telekomunikacionit.

Avokati i Popullit veprimi edhe sipas kërkesave të parashtruesve, ndaj të cilëve edhe përkrah marrëveshjeve të lidhura për themelimin e marrëdhënieve parapaguese dhe mjeteve të paguara SHA "Telekomunikacionet e Maqedonisë", megjithatë nuk ju kanë instaluar linjë telefonike por pas një periudhe më të gjatë, marrëveshjet në mënyrë të njëanshme janë prishur dhe qytetarëve u është refunduar një shumë jashtëzakonisht e vogël e parave. Avokati i Popullit vuri në dijeni se me këto veprime "Telekomunikacionet e Maqedonisë" i mashtrojnë qytetarët dhe në mënyrë të palejueshme veprojnë me mjetet e tyre dhe për këtë çështje një pjesë e qytetarëve hapën procedurë para organeve kompetente gjyqësore.

Problemet e deritanishme në lidhje me shkyçjet kolektive nga rrjeti elektrik të cilën e aplikonte SHA "Elektroekonomia e Maqedonisë" ndaj shfrytëzuesve të energjisë elektrike nëpër objektet e banimit apo vendbanimet, për shkak të faturave të papaguara nga një numër i konsumatorëve si dhe mosevidentimit të shfrytëzuesve të rinj për shkak të faturave të papaguara nga ish pronarët apo nga ish shfrytëzues të apartamenteve ose lokaleve afariste, mund të konstatohet se kryesisht janë tejkaluar. Së këtejmi, rastet e këtilla të shkyçjeve të konfirmuara nga Avokati i Popullit janë të rralla.

Gjithashtu, janë të rralla edhe rastet që kanë të bëjnë me praktikimin e SHA "Elektroekonomia e Maqedonisë" ndaj shkyçjeve të bëra mbi qytetarët, për shkak të faturave të arritura por të papaguara për energji elektrike të shfrytëzuar, për të cilën gjë Avokati i Popullit ka konstatuar se veprimi është në përputhshmëri me kriteret e përgjithshme për furnizim me energji elektrike, sipas të cilave furnizuesi mund t'ia ndërpresë konsumatorit furnizimin me energji elektrike, mes të tjerash edhe nëse nuk e paguan faturën për energjinë elektrike të shpenzuar brenda një muaji, por për këtë e ka për detyrë paraprakisht ta njoftojë konsumatorin.

Sido që të jetë, Avokati i Popullit vazhdimisht i ka parasysh situatat objektive në lidhje me fuqinë ekonomike të qytetarëve dhe sipas kësaj rezulton edhe qëndrimi për qasje restriktive drejt ndërprerjes së furnizimit me energji elektrike.

Duke vepruar me iniciativë të vet, në lidhje me dërgimin e faturave të energjisë elektrike, në të cilat në mënyrë konkrete nuk është cekur taksa radiodifuzive, si dhe lartësia e shumës, Avokati i Popullit dërgoi rekomandim pranë SHA "Elektroekonomia e Maqedonisë" dhe pranë Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, si aksionar i vetëm që të bëhet dërgimi i faturave, në të cilat në mënyrë të qartë do të potencohet taksa për të cilën bëhet fjalë.

Në të vërtetë duke e argumentuar se taksa është detyrim publik, të cilin qytetarët e kanë për detyrë ta përmbushin, Avokati i Popullit vlerësoi se është e domosdoshme theksohet në mënyrë transparente në faturat e energjisë elektrike, me çka në realitet qytetarët do të njoftohen në mënyrë konkrete për të gjitha elementet relevante që kanë të bëjnë me lartësinë dhe periudhën kohore brenda të cilës detyrohen ta përmbushin.

Institucionet kompetente vepruan sipas rekomandimit të Avokatit të Popullit, kështu që në faturat e dërguara për energji elektrike, në mënyrë të veçantë evidentohet shumata e taksës radiodifuzive.

Përndryshe, gjatë periudhës kohore për të cilën raportojmë, vazhdoi reforma në sistemin energjetik, proces ky i cili filloi vitin e kaluar pas të cilit pritet demonopolizimi dhe privatizimi i elektroekonomisë, përkatësisht qarkullimi i lirë i mallrave dhe shërbimeve në elektroenergjetikë, në kushtet e tregut të liberalizuar.

Në kuadër të veprimit të Avokatit të Popullit, vetëm një numër i vogël i qytetarëve kërkuan ndërhyrje në lidhje me punën e shoqatës aksionare "Ngrohtorja".

Palët, përmes parashtresave, në të shumtën e rasteve kërkonin ndihmë juridike në lidhje me faturat e mbetura e të papaguara dhe mundësi që t'i paguajnë në më shumë këste mujore, por ankoheshin edhe për ngrohje të dobët.

Marrë në përgjithësi nga kontaktet e deritanishme me SHA "Elektroekonomia e Maqedonisë" dhe SHA "Ngrohtorja" mund të konstatojmë se është arritur një bashkëpunim dhe komunikim solid që në fund të fundit në mënyrë pozitive reflektohet në drejtim të realizimit të të drejtave të njeriut dhe funksionimit të institucionit Avokati i Popullit.

Avokati i Popullit edhe në periudhën e kaluar veproi sipas parashtresave konkrete në lidhje me shkyçjen e qytetarëve nga rrjeti i ujësjellësit për shkak të faturave të papaguara ndaj ndërmarrjeve publike, të cilat merren me veprimtari publike nga fusha e ujësjellësit dhe kanalizimit.

Avokati i Popullit konstatoi se ka raste kur sipërmarrjet publike, disa qytetarëve ua pamundësojnë furnizimin me ujë edhe përkundër faktit se faturat e papaguara janë me datë të skaduar, përkatësisht ka hyrë në fuqi parashkrimi i kërkesës. Vërejtjet e bëra të Avokatit të Popullit janë pranuar nga ana e sipërmarrjeve publike veçanërisht nga ana e NP "Ujësjellësi dhe kanalizimi" – Shkup.

Përndryshe, Avokati i Popullit konstaton se qytetarët e kanë për detyrë që me kohë dhe në rregull t'i paguajnë faturat e shërbimeve komunale pasiqë në të kundërtën, dhënësit e shërbimeve kanë të drejtë të kërkojnë arkëtim të dhunshëm për kërkesat e tyre para organeve kompetente gjyqësore.

Për disa informata të shpallura nëpër media, Avokati i Popullit hapi procedurë me iniciativë vetjake gjatë së cilës nga provat e siguruara shtesë ka konstatuar se NP "Ujësjellësi dhe kanalizimi" ka dërguar shkresë pranë kryetarit të Qytetit të Shkupit dhe pranë SHA "Banka postare" që të mos ju lëshojnë qytetarëve dokumente përkatëse në qoftë se si provë nuk i paraqesin faturat e paguara të ujit dhe hedhurinave. Njëkohësisht sipas vlerësimit të tij, për arkëtim më efikas të faturave ndërmarrja publike ka kërkuar nga kryetari i Qytetit të Shkupit t'ua ndal një pjesë të pagës punonjësve të shërbimeve profesionale.

Avokati i Popullit reagoi në media dhe dërgoi vërejtje me shkrim deri te ndërmarrja publike duke ia bërë me dije se sjellja e cekur krijon mundësinë për cenimin e të drejtave të qytetarëve dhe se arkëtimi duhet të zbatohet në mënyrë ligjore dhe vërejtja e tij u pranua.

**0,62 %**

nga numri i  
përgjithshëm i  
parashtresave të  
pranuara

## Financat

Gjatë vitit 2005, qytetarët shprehën pakënaqësi nga puna e Ministrisë së Financave, përkatësisht nga Drejtoria e të Hyrave Publike në përputhje me Ligjin për tatimin mbi pronë, për lartësinë e tij apo bazën për caktimin e arkëtimit të tatimeve.

Një pjesë e parashtresave kanë të bëjnë me obligimin për pagimin e tatimit mbi qarkullimin e patundshmërive dhe me të drejtat e marrëveshjeve të lidhura për shitblerje të banesave shoqërore, në të cilat si shitës paraqitet organi i administratës shtetërore kurse si blerës personi fizik, përkatësisht qytetari. Në këto lëndë, në përputhje me dispozitat e Ligjit për tatimin mbi pronë, në mënyrë formale në aktet - aktvendimet e miratuara, shitësit, përkatësisht organet e administratës shtetërore u obliguan me tatimin e qarkullimit mbi patundshmëritë dhe të drejtat, por aktvendimet nuk u janë dërguar për shkak se tatimi mbi qarkullimin ka ngelur i papaguar. Në një situatë të këtillë, duke e pasur parasysh faktin se nuk kanë mund t'i realizojnë të drejtat në procedurat para Entit Shtetërorë Gjeodezik, në lidhje me regjistrimin e të drejtave në librat publik, qytetarët kanë qenë të detyruar ta



paguajnë tatimin e caktuar. Avokati i Popullit duke vepruar mbi këto lëndë dhe duke pasur parasysh normat ligjore konsideroi se blerësit nuk e kanë për detyrë ta paguajnë tatimin, përkatësisht se nuk e kanë cilësinë e tatimpaguesit. Sipas kësaj, Avokati i Popullit dërgoi rekomandime pranë Ministrisë së Financave dhe pranë Drejtorisë së të Hyrave Publike që aktvendimet të dërgohen pranë organeve të përmendura. Pas rekomandimeve të bëra me këtë qëndrim ranë dakord edhe përfaqësuesit e Ministrisë së Financave dhe Drejtorisë së të Hyrave Publike.

Duke vepruar në këtë drejtim, parashtresat që kishin të bënin me procedurën për caktimin dhe arkëtimin e tatimeve në bazë të tatimit mbi pronë, tatimeve mbi trashëgiminë dhe dhuratën dhe tatimin e qarkullimit mbi patundshmëritë dhe të drejtat, të cilat kanë filluar para datës 01.07.2005, Avokati i Popullit konstatoi zvarritje të pajustificueshme të procedurave të cilat shkaktonin pasoja të dëmshme.

Kjo për shkak të faktit se ekziston jokoordinim ndërmjet Ministrisë së Financave, Drejtorisë së të Hyrave Publike, Drejtorisë Rajonale Shkup dhe Sektorit të financave – Seksioni për përcaktimin dhe arkëtimin e tatimeve dhe taksave në Qytetin e Shkupit, pasi që edhe pse ka kaluar një periudhë bukur e gjatë nuk është bërë pranim – dorëzimi i këtyre lëndëve.

Në të vërtetë, në përputhje me nenin 26 paragrafin 1 të Ligjit për tatimin mbi pronë ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 61/04), caktimin e arkëtimit të tatimeve mbi pronë e bën administrata komunale, administrata e komunave të Qytetit të Shkupit dhe rajoni i komunës, aty ku ndodhet prona.

Avokati i Popullit konsideron se sjellja e këtillë e Ministrisë së Financave, Drejtorisë së të Hyrave Publike, Drejtorisë rajonale – Shkup dhe Sektorit të financave, Seksionit për caktimin dhe arkëtimin e tatimeve dhe taksave në Qytetin e Shkupit, sigurisht se nuk është në favor të ndërtimit të shtetit ligjor, zhvillimit dhe përforcimit të marrëdhënieve demokratike dhe sigurisë ligjore të qytetarëve dhe besimit për veprim ligjor të organeve të administratës shtetërore dhe fundja është në kundërshtim edhe me parimin e realizimit efikas të të drejtave dhe interesave të palëve në procedurën administrative.

Duke u nisur nga situata e këtillë faktike ligjore dhe në përputhje me kompetencën e përcaktuar, Avokati i Popullit vuri në dukje nevojën që Ministria e Financave, Drejtorja e të Hyrave Publike, Drejtorja rajonale – Shkup dhe Sektori i financave – Seksioni për caktimin dhe arkëtimin e tatimeve dhe taksave në Qytetin e Shkupit, që me prioritet të bëjnë pranim – dorëzimin e lëndëve që kanë të bëjnë me tatimet mbi pronën me sektorin e financave – Seksionin për caktimin dhe arkëtimin e tatimeve dhe taksave në Qytetin e Shkupit, me qëllim që qytetarët të mos pësojnë dëme dhe pasoja të mëtutjeshme.

**4,45 %**

nga numri i  
përgjithshëm i  
parashtresave të  
pranuara

## Fusha të tjera

Në një pjesë të parashtresave të parashtuara, gjatë vitit 2005, qytetarët shprehnin pakënaqësinë e tyre nga procedura e zbatuar lidhur me transformimin e ndërmarrjeve me kapital shoqëror. Në këtë drejtim Avokati i Popullit i këshillonte qytetarët që nëse konsiderojnë se me procedurat e transformimit janë bërë cenime thelbësore të dispozitave ligjore, e që rezultojnë me dëmtimin e kapitalit shoqëror, t'i drejtohen Avokati i Publik dhe Avokatit Publik, nga të cilët mund të kërkojnë kontroll juridik dhe financiar të kontabilitetit mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e zbatimit të procedurave në përputhje me dispozitat e nenit 52, të Ligjit për transformimin e ndërmarrjeve me kapital shoqëror.

# Çka konstatuam dhe çka duhet bërë

## Konstatuam

Gjatë vitit për të cilin raportojnë në mënyrë dramatike është rritur numri i parashtresave, që do të thotë se qytetarët çdo ditë e më tepër binden se përmes Institucionit Avokati i Popullit, në mënyrë efektive mund t'i mbrojnë të drejtat e tyre dhe kjo i referohet edhe mënyrës së re të punës, si dhe shfrytëzimit të instrumentit "kritikë publike".

Procedimi sipas parashtresave dëshmoi se:

- Administrata publike edhe më tej shfaq elemente të sjelljes burokratike, joefektivitet, pasivitet dhe paineresim si dhe mungesë të vetëdijes për të drejtat e tyre. Nga këto arsye, qytetarët të drejtat e tyre i realizojnë me vështirësi, jo në kohë dhe përmes procedurave të stërzgjatura administrative, ndërkohë që ballafaqohen me keqpërdorimin e autorizimeve zyrtare, sjelljen me papërgjegjësi dhe pandërgjegjshmëri me mosrespektimin e dinjitetit njerëzor dhe të dispozitave ligjore dhe me zbatimin e tyre jopërkates.
- Proceset gjyqësore, ndër vite, janë të avashta dhe joefektive e që pjesërisht është rezultat i dobësive subjektive për shkak të sjelljes joprofesionale dhe të pandërgjegjshme, aftësimi të pamjaftueshëm të personelit gjyqësor dhe administrativ, por edhe rezultat i kushteve dhe mundësive objektive në të cilin funksionon sistemi gjyqësor. Për këtë shkak palët nuk mund ta realizojnë të drejtën e gjykimit brenda afatit të arsyeshëm.
- Në procedurat policore janë konstatuar cenime të të drejtave të njeriut me përdorim jashtë mase të mjeteve të dhunës dhe abuzimin me autorizimet e ndryshme zyrtare nga ana e personave zyrtarë.
- Sektori për kontroll të brendshëm dhe standarde profesionale, manifeston sjellje joprofionale gjatë realizimit të funksionit – mekanizëm i brendshëm kontrollues, me fshehjen e situatave negative gjatë veprimit, e që e pengon punën e Avokatit të Popullit.
- Sistemi penitenciar është i ngarkuar dhe funksionon me probleme të shumta dhe dukuri të vrasjeve dhe vetëvrasjeve për shkak të gjendjes së përkeqësuar të sigurisë, menaxhimit joprofional të institucioneve ndëshkimore – përmirësuese dhe kushteve të këqija materiale dhe nuk mund të sigurojë trajtim dhe qëndrim dinjitoz të personave të dënuar dhe kështu kjo popullatë vihet në margjinat e shoqërisë.
- Denacionalizimi – kthimi i pronave tek personat e mëparshëm ka ngecur për shkak të mosfunksionimit dhe qasjes seleksionuese të Komisionit për vendosje në procedurë administrative të shkallës së dytë sipas lëndëve në fushën e denacionalizimit e që tërë procesin e vë në pikëpyetje.
- Nuk përmbahen aktet administrative për shembjen e ndërtimeve pa leje, ndërsa për qindja e vogël që përmbahet, bëhet në mënyrë seleksionuese.
- Mungon vetëdija dhe ndërgjegjja për mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe nuk zbatohen masat për mbrojtjen e tij.

- Ekzistojnë lëshime dhe veprime të paligjshme në procedurat e realizimit të të drejtave nga marrëdhënia e punës, sidomos gjatë transferimit të punonjësve nga niveli qendrorë në atë lokal.
- Komisioni për çështje strehimore, pranë Qeverisë së Republikës së Maqedonisë nuk vepron në kohë sipas kërkesave të qytetarëve.
- Niveli i sigurisë sociale nuk kënaq, ai ballafaqohet me vështirësi, jokonsekuencë, paligjshmëri dhe veprim jo në kohë gjatë organizimit të të drejtave, që kanë të bëjnë me mbrojtjen sociale, sigurimin pensional dhe invalidor dhe mbrojtjen shëndetësore, si edhe veprimi jo në kohë, jobjektiv dhe sjellje korruptive të komisioneve për vlerësimin e aftësisë së punës.
- Nuk ekzistojnë kushte përkatëse dhe mundësi të barabarta për realizimin konsekuent të të drejtave të çdo fëmije në Republikën e Maqedonisë, ndërkohë që është rritur numri edhe i dhunës mbi fëmijët.
- Ligji për arsim të lartë, zbatohet në mënyrë jo konsekuente gjatë ngarkimit dhe lirimit nga shpenzimet e studimit, ndërkohë që standardi i studentëve nuk kënaq.
- Shkalla e komunikimit ndërmjet dhënësve të shërbimeve dhe qytetarëve – shfrytëzues është joprofesional, i pakënaqshëm, ndërkohë që mungojnë edhe normat përkatëse, me të cilat do të sigurohej mbrojtje dhe kontroll përkatës mbi monopolet në treg.
- Mungesa e një ligji të veçantë për mbrojtje nga diskriminimi nuk mundëson të verifikohen dukuritë e diskriminimit dhe të sigurohet mbrojtje përkatëse e viktimave nga diskriminimi.
- Në mënyrë jokonsekuente zbatohet parimi i përfaqësimit të drejtë dhe adekuat i pjesëtarëve të bashkësive.
- Bashkëpunimi me Avokatin e Popullit gjatë vitit 2005, ishte në nivel më të lartë krahasuar me vitet e kaluar, mirëpo kishte edhe raste të mosbashkëpunimit dhe mosjetësismit të rekomandimeve të dërguara e që rezultonin me pengimin në punë.
- Mosbashkëpunimi ishte i shprehur sidomos me Ministrinë për Punë të Brendshme – Sektorin për kontroll të brendshëm dhe standarde profesionale, për shkak të mungesës së informacioneve dhe të dhënave sipas parashtresave që kishin të bënin me cenimin e të drejtave me tejkalimin e autorizimeve zyrtare dhe përdorimin jashtë mase të dhunës.
- Mosveprimi i Komisionit për vendosje në procedurë administrative të shkallës së dytë, sipas lëndëve nga fusha e denacionalizimit, sipas rekomandimeve të Avokatit të Popullit, tërësisht e frenoi procesin e denacionalizimit, realizimin e të drejtave mbi këtë bazë dhe pengoi punën e Avokatit të Popullit.
- Sjellje jokorrekte dhe mosbashkëpunim u shënuan edhe nga komisionet e shkallës së dytë të Qeverisë, të cilat vendosin sipas lëndëve nga fusha e marrëdhënieve pronësore – juridike dh ndarjes së tokave për ndërtim, matjes, kadastrës dhe regjistrimit të të drejtës mbi patundshmëri, nga ana e Ministrisë së Transportit dhe Ndërlidhjeve dhe Ministrisë së Mjedisit, nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Punës dhe Politikës Sociale, Komisionit për denacionalizim i Ministrisë së Financave, Sektorit për rregullimin dhe dokumentimin e tokës për ndërtim në Ministrinë e Transportit dhe Ndërlidhjeve dhe Sektorit për matje dhe kadastrë të Entit Shtetëror për Punë Gjeodezie.

## Çka duhet bërë

Nga gjendjet e konstatuara Avokati i Popullit konsideron se është e domosdoshme që organet kompetente të ndërmarrin masa dhe aktivitete për shmangien e parregullsive dhe dukurive të tjera negative në punë.

Pikërisht për këtë, organet kompetente duhet të sigurojnë:

- Superstrukturim të kornizës ligjore të Republikës së Maqedonisë, me jetësimin e plotë të dispozitave kushtetuese dhe standardeve ndërkombëtare për mosrespektimin e të drejtave dhe lirive;
- Përshejtimin e procesit të filluar të reformës në administratën publike dhe transformimin e saj në shërbim të mirëfilltë të qytetarëve;
- Procedimin me kohë, me përgjegjësi dhe ndërgjegjshmëri sipas kërkesave të qytetarëve për realizimin e të drejtave dhe lirive të tyre;
- Respektimin e parimeve kushtetuese për mosdiskriminim dhe përfaqësim të drejtë dhe adekuat të pjesëtarëve të të gjitha bashkësive në organet e pushtetit, organet e njësive të vetadministrimit lokal dhe institucionet e shërbimit publike;
- Hapje më e madhe e punës së organeve të pushtetit shtetëror, organeve të njësive të vetadministrimit lokal dhe shërbimeve të institucioneve publike;
- Trajnimin në vazhdimësi të nëpunësve shtetërorë për zbatimin e normave ligjore dhe përmirësimin e raportit të tyre me qytetarët dhe
- Hapje më e madhe, përgjegjësi dhe respektim konsekuent ndaj kërkesave, rekomandimeve dhe ndërhyrjeve të tjera që bën Avokati i Popullit.

Duke e pasur parasysh gjendjen e konstatuar në planin e realizimit të të drejtave të qytetarëve në disa fusha, Avokati i Popullit konsideron se nevojitet:

Përmbyllja e procesit të reformave në sistemin e jurisprudencës me operacionalizim të amendamenteve kushtetuese me qëllim të sigurimit të kushteve për realizim efikas dhe efektiv të të drejtave të qytetarëve dhe sundimit të ligjit.

Trajnim në vazhdimësi dhe edukim i personave të autorizuar zyrtarë për të arritur nivel më të lartë të profesionalizmit gjatë kryerjes së punëve policore, transformimin e Sektorit për kontroll të brendshëm dhe standarde profesionale dhe braktisjen e njëanshmërisë gjatë procedurave për verifikimin e përgjegjësisë së personave të autorizuar zyrtarë, të cilët kanë bërë tejkalim të autorizimeve zyrtare.

Sektori për kontroll të brendshëm dhe standarde profesionale me konsekuencë t'i respektojë kërkesat dhe rekomandimet e Avokatit të Popullit, pa marrë parasysh nivelin e fshehtësisë, me çka do të mundësohej realizimi pa pengesë i funksionit të Avokatit të Popullit.

Marrje urgjente e masave për rregullimin e gjendjes së përkeqësuar të sigurisë dhe përforsim të profesionalizmit gjatë menaxhimit me institucionet, përmirësim të kushteve të qëndrimit, me qëllim të respektimit të të drejtave të personave të dënuar dhe të paraburgosur, në përputhje me rregullat e institucionit dhe standardet ndërkombëtare, si dhe performancën e mekanizmave kontrollues, veçmas në planin e sigurisë, në mënyrë që t'u garantohet e drejta për jetë.

Ndërmarrje e masave për zhblokimin e procesit të denacionalizimit, sidomos në procedurat e vendimmarrjes në shkallë të dytë sipas lëndëve dhe hapje të procedurave për verifikimin e gjendjes së këtyre.

Komisionet e shkallës së dytë të Qeverisë, të cilat vendosin sipas lëndëve nga fusha e çështjeve pronësore – juridike dhe ndarjen e tokës për ndërtim, matje dhe kadastër dhe regjistrimin e të drejtave të patundshmërive, si edhe nga fusha e transportit dhe ndërlidhjeve dhe mjedisit jetësor, t'i respektojnë afatet ligjore për vendimmarrje dhe të sillen me përgjegjësi ndaj ndërhyrjeve të Avokatit të Popullit.

Ministria e Arsimit, komisionet për denacionalizim të Ministrisë së Financave, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Sektori për rregullimin dhe dokumentimin e tokës për ndërtim i Ministrisë së Transportit dhe Ndërlidhjeve dhe Sektori për matje dhe kadastër i Entit Shtetëror për Punë Gjeodezike, të veprojnë dhe punojnë në mënyrë më efektive si dhe ta përmirësojnë bashkëpunimin me Avokatin e Popullit.

Inspektorati Shtetëror për Mbrojtjen e Mjedisit në mënyrë të vazhdueshme ta përcjellë gjendjen e mjedisit, ndërsa Shërbimet e mjedisit nuk duhet të japin leje për punë, pa u siguruar elaborati ekologjik – teknologjik.

Ndërmarrje në vazhdimësi e aktiviteteve nga kompetenca e institucioneve shtetërore dhe organeve të njësive të vetadministrimit lokal për përparimin e gjendjes së mjedisit dhe ngritjes së vetëdijes që qytetarëve.

Respektim i dispozitave ligjore, të cilat e rregullojnë materien e marrëdhënies së punës gjatë realizimit të të drejtave nga ana e punëdhënësve dhe angazhimin më të madh të inspeksionit të punës sidomos për sektorin privat.

Sigurim i kushteve për akomodimin e personave të rrezikuar social – personave që nuk e kanë të zgjidhur çështjen strehimore.

Shpërndarje ligjore e ndihmës sociale për qytetarët, të cilët realisht kanë nevojë, me çka do të krijohen kushte për rritjen e shumës së ndihmës.

Procedim me kohë dhe ligjor sipas kërkesave të qytetarëve për realizimin e të drejtave nga sigurimi pensional dhe invalidor, sidomos gjatë procedurave pranë Komisioneve të shkallës së dytë të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe eliminimin e dukurive të korrupsionit gjatë vlerësimit të aftësisë për punë.

Zbatim konsekuent i normave ligjore për realizimin e të drejtave të mbrojtjes shëndetësore të çdo qytetari dhe respektim i kodeksit të mjekut, gjatë dhënies së shërbimeve shëndetësore.

Interesi më i mirë i fëmijës të jetë prioritet absolut gjatë krijimit të politikës së mbrojtjes të të drejtave të fëmijës, të sigurohen parakushte dhe mjete për përmbushjen e nevojave të të gjithë fëmijëve me respektimin e: mosdiskriminimit, interesit më të mirë dhe pjesëmarrjes së fëmijëve në çështjet që janë në interes të tyre. Zbatimi i efektshëm i masave për mbrojtjen e fëmijëve nga çdo lloj i dhunës.

Vendimmarrje ligjore dhe respektim i afateve gjatë realizimit të të drejtave të qytetarëve në fushën e arsimit dhe mbrojtjen e avancimin e standardit të nxënësve dhe studentëve.

Veprim më efikas i Komisionit për mbrojtjen e konkurrencës në parandalimin e keqpërdorimit të pozicionit monopolistik të dhënësve të shërbimeve dhe hartimit të normave komplete për liberalizimin e tregut të telefonisë fikse.

Zbatim konsekuent të obligimit kushtetues për përfaqësimin e drejtë dhe adekuat të qytetarëve, të cilët u përkasin të gjitha bashkësive në organet e shtetit dhe institucionet publike në të gjitha nivelet, si edhe realizim i planeve vjetore për përfaqësim të drejtë dhe adekuat.

Miratim i Ligjit të veçantë për mbrojtje nga diskriminimi që do të krijonte kornizë ligjore për jetësimin e parimit kushtetues dhe standardeve ndërkombëtare nga kjo fushë.

Përsheptim i aktiviteteve për përmbylljen e procesit të decentralizimit, informimin e qytetarëve për realizimin e të drejtave të tyre pranë organeve të vetadministrimit dhe avancimin e bashkëpunimit me Avokatin e Popullit.

# AVOKATI I POPULLIT NË VITIN 2006

Në vitin 2006, Avokati i Popullit do të vazhdojë t'i drejtojë aktivitetet në radhë të parë drejtë realizimit dhe mbrojtjes të të drejtave të qytetarëve, në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, ligjet dhe standardet ndërkombëtare.

Avokati i Popullit do të merr pjesë dhe do të kontribuojë për mbindërtimin e normave ligjore për shkak të zbatimit të suksesshëm të procesit të evrointegrimit të Republikës së Maqedonisë dhe harmonizimin e legjislaturës së vendit me atë të Bashkimit Evropian.

Do të përshpejtohet metoda për kryerjen e inspektimeve të drejtpërdrejta mbi punën e organeve, ndaj të cilave Avokati i Popullit vepron me kompetencë me qëllim të hulumtimit të drejtpërdrejt të cenimeve të të drejtave të qytetarëve.

Rëndësi e veçantë do t'i kushtohet përcjelljes së gjendjes në realizimin dhe mbrojtjen e parimeve të mosdiskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë dhe adekuat.

Avokati i Popullit do të vazhdojë të gjejë forma dhe metoda të reja për bashkëpunim dhe komunikim më të ngushtë me organet e institucioneve të pushtetit qendror dhe lokal, si dhe me organizatat joqeveritare për veprim të përbashkët në planin e parandalimit, mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut.

Do të vazhdojnë aktivitetet për afirmimin e Institucionit dhe edukimin e qytetarëve për rolin dhe rëndësinë me programimin e aktiviteteve për promovimin e të drejtave të qytetarëve.

Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet edhe bashkëpunimit dhe shfrytëzimit të mjeteve të informimit publikë, si instrument tejet i rëndësishëm dhe efektiv i funksionimit të Avokatit të Popullit.

Në planin organizativ do të vazhdojnë aktivitetet për avancimin e kushteve teknike dhe të lokaleve për punën e Institucionit.

Me rëndësi të veçantë për Institucionin, gjatë vitit 2006, do të jetë realizimi i projekti për ndihmë teknike të Avokatit të Popullit, i financuar nga Qeveria e Suedisë, me mbështetje të Misionit të OSBE-së në Shkup. Me realizimin e këtij projekti pritet të sigurohet avancimi i superstrukturimit të punonjësve në Institucion dhe njohja me standardet dhe përvojat ndërkombëtare në fushën e të drejtave dhe lirive të njeriut.

Avokati i Popullit do ta vazhdojë bashkëpunimin në nivelin dypalësh, rajonal dhe ndërkombëtar me ombudsmanët e vendeve të tjera dhe me institucionet e ngjashme, qëllimi primar i të cilit është mbrojtja dhe avancimi i lirive dhe të drejtave të njeriut, me pjesëmarrje nëpër seminare, konferenca dhe evenimente të tjera me interes për avancimin e punës. Me vëmendje të veçantë do të shqyrtohen dhe pranohen projektet dhe programet e ofruara, të cilat do të jenë të rëndësishme për avancimin e të drejtave të njeriut. Në bashkëpunim me Ombudsmanin e Greqisë, do të realizohet projekti "Ombudsmani dhe administrata publike" dhe me mbështetje të Komisionit Evropian do të realizohet edhe projekti "Realizimi dhe mbrojtja e të drejtës së mosdiskriminimit".

Si anëtar i Sekretariatit të Asociacionit Ombudsman të Frankofonisë, Institutit Ombudsman të Evropës, Institutit Ombudsman Ndërkombëtar dhe të Rrjetit të Ombudsmanëve për Fëmijë të Evropës, Avokati i Popullit do të vazhdojë në mënyrë aktive të merr pjesë në punën e këtyre organizatave prestigjioze.

# AVOKATI I POPULLIT NË PRAKTIKË

## Mosdiskriminimi

### AP nr. 420/05

Pranë Avokatit të Popullit parashtresë ka parashtruar I. Ll. nga Shkupi, e cila ka potencuar se i janë cenuar të drejtat nga NP "Hekurudhat e Maqedonisë" – Shkup, për shkak të mosrespektimit të të drejtës kushtetuese dhe ligjore të përfaqësimit të drejtë dhe adekuat të pjesëtarëve të bashkësive në organet e pushtetit lokal dhe institucionet e tjera publike

Nga parashtresa rezultoi se Ndërmarrja Publike ka marrë Aktvendim për pushim nga marrëdhënia e punës me përjashtim, për arsye të ndryshimeve ekonomike, teknike, strukturore dhe ndryshimeve të tjera për çka parashtruesja ka paraqitur kundërshtim deri te Komisioni për Marrëdhënie të Punës të NP "Hekurudhat e Maqedonisë".

Avokati i Popullit, konstatoi cenim të të drejtave ndaj parashtrueses, ngaqë Këshilli Drejtues i Ndërmarrjes Publike, gjatë vendimmarrjes nuk ka vepruar në kuptimin e Amendamentit VI të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, në të cilin si vlerë themelore e rregullimit kushtetues është paraparë edhe përfaqësimi i drejtë dhe adekuat i qytetarëve, të cilët u përkasin të gjitha bashkësive në organet e pushtetit shtetëror dhe institucionet e tjera në të gjitha nivelet.

Duke i pasur parasysh kompetencat, të cilat i dalin nga Amendamenti VI i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë dhe dispozitat e Ligjit për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit me disa shkresa u drejtua pranë Ndërmarrjes Publike "Hekurudhat e Maqedonisë" – Shkup dhe kërkoi që në tërësi të pranohet kundërshtimi i parashtrueses, dhe në kontekst të kësaj të anulohet aktvendimi për pushim nga marrëdhënia e punës dhe pas kësaj të merret aktvendim i ri, sipas të cilit parashtruesja do të sistematizohet në vendin e punës që i përgjigjet përgatitjes së saj profesionale.

NP "Hekurudhat e Maqedonisë" e njoftuan Avokatin e Popullit se kundërshtimi është marrë në konsideratë dhe se parashtruesja është sistematizuar në vend përkatës të punës.

## Procedimi policor

### AP nr. 153/05

S. R. nga Shkupi paraqiti parashtresë për cenim të të drejtave të tij nga ana e Njesisë për Detyra Speciale pranë Ministrisë për Punë të Brendshme, gjatë aksionit policor për burgimin e vëllait të tij I. R., me ç'rast ndaj tij është përdorë dhunë jashtë mase e që ka rezultuar me lëndime fizike.

Gjatë procedurës, Avokati i Popullit konstatoi se të dhënat kanë bazë prandaj dhe nga Sektori për kontroll të brendshëm dhe standarde profesionale kërkoi zbatimin e kontrollit të brendshëm, zbulimin e identitetit të personave zyrtarë, të cilët parashtruesit të parashtresës i kanë shkaktuar lëndime, hapje të procedurës përkatëse kundër tyre, si dhe Avokatit të Popullit t'ia dërgojnë informatat për identitetin e tyre.

Sektori për kontroll të brendshëm dhe standarde profesionale, nuk i mori parasysh faktet për tejkalimin e autorizimeve zyrtare dhe përdorimin jashtë mase të forcës dhe nuk e zbuloi identitetin e personave zyrtarë, duke iu referuar Ligjit për informata të klasifikuara.

Për Avokatin e Popullit, ky mosveprim ishte pengim në punë, sepse kërkesa për të pasur certifikatë sigurie për shkak të qasjes deri te informatat e klasifikuara është në kundërshtim me nenin 27 të Ligjit për Avokatin e Popullit, sipas të cilit, organet e administratës shtetërore dhe organet e organizatat e tjera shtetërore obligohen që Avokatit të Popullit t'ia sigurojnë të gjitha të dhënat dhe informatat që ai i kërkoi, pa marrë parasysh shkallën e besueshmërisë si dhe t'i mundësojnë zbatim të procedurës.

Për të gjitha aspektet e problemit, me të cilat u ballafaqua Avokati i Popullit, me informatë e njoftoi ministrin e Punëve të Brendshme, por meqë edhe kjo nuk dha rezultate të pritura, Avokati i Popullit rastin ia dorëzoi Prokurorit Publik, deri te i cili paraqiti Kërkesë për hapje të procedurës për shkak të verifikimit të përgjegjësisë kundër

personave të panjohur zyrtarë të Ministrisë për Punë të Brendshme.

Sipas informatave që kanë arritur nga Prokuroria Publike, kërkesa është pranuar dhe në rrjedhë është procedura parapenale pranë Prokurorisë Publike Themelore në Shkup.

### **AP nr. 2257/05**

Parashtruesi i parashtresës T. A. nga Shkupi, nga Avokati i Popullit kërkoi që të ndërhyjë në Sektorin e Punëve të Brendshme në Shkup, që t'i kthehen çiftja dhe leja për posedimin dhe mbajtjen e të njëjtës.

Pasi që konstatoi se sendet e përmendura të parashtruesit të parashtresës, me aktvendim të Sektorit, janë marrë përkohësisht për shkak të dyshimit për vepër penale të kryer, ndërkaq kallëzimi penal nga ana e Prokurorisë Themelore Publike është hedhur poshtë, Avokati i Popullit pranë Sektorit të Punëve të Brendshme dërgoi sugjerim, me të cilin kërkoi që të rishqyrtohet aktvendimi për sendet përkohësisht të marra nga parashtruesi i parashtresës dhe të vendoset në përputhje dhe Ligjin, si dhe të merret parasysh fakti se kallëzimi penal, që ka qenë shkak i marrjes së sendeve është hedhur poshtë nga ana e Prokurorisë Publike Themelore të Shkupit.

Në bazë të sugjerimit të bërë, Sektori i Punëve të Brendshme, me informatë kthyesë e informoi Avokatin e Popullit se ka marrë aktvendimin, për ndërprerje të procedurës, ndërkaq parashtruesi i parashtresës e njoftoi se sendet që i janë marrë përkohësisht, tanimë i janë kthyer.

## **Jurisprudenca**

### **AP nr. 67/05**

I dënuari A. D. në parashtresën e tij theksoi se për shkak të gjendjes së përkeqësuar shëndetësore deri te Drejtoria e Institucionit Ndëshkimor – Përmirësues “Idrizovë”, ka paraqitur kërkesë që t'i mundësohet mjekim në institucion shëndetësor përkatës, por për këtë kërkesë një kohë të gjatë nuk është marrë vendim.

Pasi që konstatoi se të dhënat janë të bazuara, Avokati i Popullit dërgoi rekomandim pranë Institucionit dhe kërkoi që personi i dënuar të dërgohet deri te personi profesionist – specialist, i cili do ta vlerësojë nevojën dhe domosdoshmërinë për mbrojtje shëndetësore jashtë institucionit.

Sugjerimet e Avokatit të Popullit të dhëna në rekomandim u pranuan nga mjeku i institucionit ndërkaq, personi i dënuar u dërgua në Entin për terapi fizike dhe rehabilitim ku iu ofrua mbrojtje shëndetësore përkatëse.

### **AP nr. 109/05**

Në parashtresën e personit M. T. nga Strumica potencohet se mbi pesë vjet, në mënyrë të padrejtë shtyhet procedura sipas aneksës në Gjykatën e Apelit në Shtip sipas lëndës Gzh. Nr. 84700 në të cilën paraqitet si palë.

Pasi që bëhej fjalë për cenim serioz të të drejtës së gjykimit brenda afatit të arsyeshëm, Avokati i Popullit pas inspektimit të drejtpërdrejtë në lëndën gjyqësore, konstatoi se parashtresa në tërësi është e bazuar dhe se lënda në fjalë për këtë kohë nuk është marrë në punim, për këtë gjë kërkoi procedim urgjent. Për shkak të konstatimit të cenimit flagrant të parimit të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm, Avokati i Popullit për parregullsitë në punimet e gjyqtarit, i cili është dashtë të procedojë sipas lëndës, e njoftoi Këshillin Gjyqësor Republikan dhe kërkoi hapje të procedurës për verifikimin e profesionalizmit dhe ndërgjegjshmërisë së tij gjatë ushtrimit të profesionit gjyqtar.

Në bazë të kësaj ndërhyrjeje, pas procedurës së zbatuar nga ana e Këshillit Gjyqësor Republika, gjyqtari i Gjykatës së Apelit në Shtip u shkarkua nga funksioni.

## **Marrëdhëniet pronësore – juridike**

### **AP nr. 1729/03**

Qytetari M. R. nga Gostivari, pranë Komisionit për denacionalizim në Gostivar ka paraqitur Kërkesë për denacionalizim më datë 12.10.200, sipas së cilës nuk është marrë fare aktvendim i shkallës së parë. Prandaj, më datë 29.10.2003, qytetari ka paraqitur parashtresë, sipas së cilës Avokati i Popullit pranë organit të shkallës së parë dërgoi rekomandimin që me urgjencë të vendoset për lëndën në fjalë, me paralajmërim se për rastin, të parëndësishme janë rrethanat të cilat sa i përkasin lëndës – pronë e denacionalizimit me vendim përkatës të gjykatës përkatëse është përcaktuar kompensim. Kjo, sepse ndër të tjerash, send i denacionalizimit është prona e marrë për të cilën është paguar, përkatësisht është dhënë kompensim, ndërsa në rastin konkret, kompensimi i caktuar nuk është paguar fare, përkatësisht nuk është dhënë, prandaj dhe rrethanat se personi në fjalë ka mund ta bëjë arkëtimin për kompensim përmes procedurave eventuale gjyqësore nuk janë të rëndësishme.

Avokati i Popullit është informuar se pranohet rekomandimi i dërguar sepse nga ana e organit administrativ të shkallës së parë është hartuar propozim aktvendimi, me të cilin kërkesa në fjalë merret në konsideratë, por në ndërkohë aktvendimin e këtyre e ka kthyer Komisioni për kontroll me vërejtje që kërkesa të refuzohet sepse qytetari nuk ka qenë i ndërgjegjshëm gjatë periudhës së kaluar dhe se pagesën e caktuar për



pronën e marrë ka mundur ta realizojë duke hapur procedurë gjyqësore, duke iu referuar edhe përmbajtjes së Udhëzimit për punë të lëshuar nga Komisioni për koordinimin e punës së komisioneve, të cilat vendosin sipas kërkesave për denacionalizim.

Duke pasur parasysh situatën e këtyllë, Avokati i Popullit gjatë rrjedhës së mëtutjeshme të procedurës dërgoi mendim juridik deri te ministri i Financave, me ç'rast nga Komisioni për koordinim u njoftua se organi për denacionalizim në tërësi do ta ketë parasysh përmbajtjen e mendimit, por Komisioni për kontroll edhe më tej nuk e miraton propozim aktvendimin, edhe pse Komisioni i cili vendos sipas Kërkesës për denacionalizim duke iu referuar mes të tjerash edhe përmbajtjes së shkresës së Avokatit të Popullit vazhdimisht kërkon miratimin e tij, e që është konfirmuar edhe me inspektimin e drejtpërdrejtë nga lënda.

Pikërisht për shkak të një moskoordinimi të këtyllë të punës, organi për denacionalizim akoma nuk ka marrë aktvendimin administrativ të shkallës së parë, edhe pse nga paraqitja e kërkesës kanë kaluar thuaja se 5 vjet.

### **AP nr. 509/05**

Qytetari D. K. nga Shkupi, në parashtresën e tij nga Avokati i Popullit kërkoi që të ndërmerr veprime pranë Sekretariatit për matje dhe kadastrë – Shkup në Entin shtetëror për punë gjeodezie për shkak të cenimit të të drejtës në pronësi të garantuar me kushtetutë, duke pasur parasysh faktin se, pas skadimit të një periudhe kohore më të gjatë, nuk është vepruar sipas Kërkesës për ndryshim në kadastrën e patundshmërive për KK "Kisella Voda II".

Duke vepruar sipas lëndës së formuar, Avokati i Popullit konstatoi se parashtresa ka bazë, sepse mënyra e këtyllë e veprimit, përkatësisht mosveprimit është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative, si edhe dispozitat përkatëse, me të cilat rregullohet fusha e matjes, kadastrës dhe regjistrimit të të drejtave të patundshmërive.

Përkatësisht, së pari e pakontestueshme ishte se në rastin konkret, fare nuk është respektuar afati i caktuar ligjor për marrjen e aktvendimit, në përputhje me nenin 218 të Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative, i cili zgjatë më së shumti dy muaj, duke llogaritur nga dita e paraqitjes së rregullt të kërkesës, ndërkaq nga dita e paraqitjes së kërkesës në fjalë kishin kaluar gjashtë muaj.

Nga ana tjetër, nga vetë parashtresa, rrethanat, faktet dhe provat e bashkangjitura, gjithashtu në mënyrë të pakontestueshme rezultoi se e drejta në pronësi, sa u përket patundshmërisë që janë lëndë shqyrtimit, del nga përmbajtja e dokumentit të besueshëm – Marrëveshjes për shitblerje të pronës së patundshme të vërtetuar nga noteri kompetent, e që në përputhje me dispozitat juridike – materiale nga fusha e matjes, kadastrës

dhe regjistrimit të të drejtave të patundshmërive, paraqet bazë ligjore për ndryshim në kadastrën e patundshmërive. Për shkak të gjendjes së këtyllë ligjore dhe faktike, Avokati i Popullit deri te organi i përmendur dërgoi shkresë, me të cilën rekomandoi që me prioritet të procedohet dhe vendoset për punën konkrete administrative me atë që do të merret në konsideratë kërkesa e paraqitur nga personi i përmendur, parashtresës.

Brenda afatit të caktuar, organi kompetent veproi sipas gjithë asaj që ishte potencuar në përmbajtjen e dhënë nga Avokati i Popullit dhe qytetari e realizoi të drejtën e tij.

## **Urbanizëm dhe ndërtimtari**

### **AP nr. 2525/05**

Lidhur me parashtresën e V. dhe D. N. nga Gostivari, Avokati i Popullit iu drejtua kryetarit të Komunës së Gostivarit dhe kërkoi që procedura për përbarimin e dhunshëm të Aktvendimit për shembje, përkohësisht të ndërpritet derisa të përfundohet procedura administrative sipas aktvendimit, përkatësisht deri në marrjen e vendimit nga organi i shkallës së dytë sipas ankesës së paraqitur dhe me qëllim që me shembjen e parakohshme dhe shpërnguljen, të mos shkaktohet dëm material vështirë i kompensueshëm, e që do të paraqitej nëse organi kompetent i shkallës së dytë eventualisht e shfuqizonte aktvendimin e përmendur. Të njëjtën ditë u pranua një njoftim, nga i cili mund të konstatohej se kryetari i komunës është i gatshëm ta respektojë kërkesën e Avokatit të Popullit për ndërprerje të përkohshme të përbarimit, derisa aktvendimi nuk bëhet i plotfuqishëm dhe përbarues, përkatësisht deri në marrjen e aktvendimit të shkallës së dytë sipas ankesës.

## **Mjedisi jetësor**

### **AP nr.499/05**

Avokati i Popullit me iniciativë të vetë hapi procedurë në bazë të një artikulli të botuar në shtypin e përditshëm për shkatërrimin e raritetit natyror, Rezervat rreptësisht natyror "Ezerani" në Liqenin e Prespës.

Gjatë procedurës, Avokati Popullit u drejtua dhe realizoi më shumë kontakte me persona zyrtarë nga më shumë organe kompetente. Nga Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor-Inspektoratit shtetëror për mjedisin jetësor, u kërkua që të bëhet mbikëqyrje inspektuese mbi lokalitetin në fjalë dhe në bazë të gjendjes së konstatuar të merret vendim përkatës. Kërkesa me përmbajtjen e njëjtë iu dërgua edhe Inspektoratit Shtetëror të Bujqësisë. Inspektorati

Shtetëror i Mjedisit Jetësor e njoftoi Avokatin e Popullit se pas mbikëqyrjes inspektuese dhe gjendjes së konstatuar faktike ka marrë aktvendim, me të cilin personit S. A. nga fshati Asamati i Prespës i është ndaluar kryerja e aktiviteteve bujqësore në parcelën e tokës bujqësore në territorin e rezervatit rreptësishtë natyror "Ezerani". Nga përgjigjja e Inspektoratit Shtetërorë të Bujqësisë, Avokati i Popullit, konstatoi se është konfirmuar gjendje e njëjtë faktike dhe së në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave, në rrjedhë është procedura sipas kërkesës së personit S. A. për ndarjen e truallit me qiramarrje afatgjate.

Në rrjedhën e mëtutjeshme të procedurës, në lidhje me kërkesën për ndarjen e truallit në fjalë me qiramarrje afatgjate, Avokati i Popullit paraqiti mendim deri te Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave, në të cilin theksoi se nuk ka bazë ligjore që truallit bujqësor, i cili është lëndë e procedurës për dhënie me qira afatgjate të jetë send i vënë në dispozicion për dhënie me qira afatgjate, ngaqë i nënshtrohet mbrojtës së rreptë.

Për epilogun e procedurës sipas kësaj kërkesë, Avokati i Popullit akoma nuk është informuar, sepse lënda e kësaj procedure paraqet rrezikim dhe degradim të një pjese të truallit që është pronë e Republikës së Maqedonisë. Avokati i Popullit u drejtua edhe pranë Avokatit Publik për rajonin e Manastirit dhe Resnjës me kërkesë që kundër personit S. A. të ndërmerren masa ligjore për mbrojtje nga uzurpimi, ndërsa ata e kanë informuar se sipas kërkesës është vepruar.

Procedura për këtë lëndë është në rrjedhë.

## Marrëdhëniet e punës

### AP nr. 1732/05

Parashtruesi i parashtresës kërkoj intervenim për procedurën e themelimit të marrëdhënies së punës në Institucionin Ndëshkimor – Përmirësues në Tetovë, për vendin e punë bashkëpunëtor më i ri, në bazë të trajnimit të kryer me sukses në pjesën praktike si kursist i programit "PACE". Afati për themelimin e marrëdhënies së punës, ka qenë deri më 01.02.2005, ndërsa organi i cekur nuk ka vepruar më gjatë se shtatë muaj.

Pas dërgimit të sugjerimit për cenim të bërë, mbi të drejtën e marrëdhënies së punës, ndaj parashtruesve të parashtresës nga ana Minsitrisë së Drejtësisë, për shkak të moszbatimit të obligimit ligjor për themelimin e marrëdhënies së punës me kursistët e programit "PACE" dhe duke pasur parasysh periudhën e kaluar, kur është dashur të bëhet kjo marrëveshje, Avokati i Popullit mori njoftimin se parashtruesit e parashtresës, më datë 20.09.2005 i kanë marrë vendimet, përkatësisht i kanë nënshkruar marrëveshjet për punë në Institucionin Ndëshkimor – Përmirësues në Tetovë.

## Çështjet strehimore

### AP nr. 688/05

Pranë Avokatit të Popullit parashtresë parashtrroi E. S. nga Shtipi, në të cilën kërkoj ndërhyrje pranë Ndërmarrjes Publike për Ekonomizim me Lokale Banimi dhe Afariste të Republikës së Maqedonisë – Njësia rajonale e Shtipit, për shkak të moszbatimit të Marrëveshjes për qiramarrje të banesës, nga shkak se në banesë pa leje ka banuar person tjetër.

Meqë edhe përkrah kërkesave të shumta për të marrë masa përkatëse për shpërnguljen e personit që banon pa leje, Ndërmarrja Publike nuk ka vepruar, Avokati i Popullit dërgoi shkresë pranë Ndërmarrjes, me të cilën rekomandoi që të veprohë në përputhje me dispozitat e Ligjit për banim, sipas të cilit qiradhënësi obligohet që qiramarrësit t'ia mundësojë shfrytëzimin e pa pengesë të banesës, me kushtet e përcaktuara me Marrëveshjen për qiramarrje. Gjithashtu, Avokati i Popullit paralajmëroi se në ligjin e njëjtë janë parashikuar edhe dispozita ndëshkuese për personin juridik, i cili nuk ia mundëson qiramarrësit shfrytëzimin pa pengesë të banesës ose nuk e jep banesë në shfrytëzim dhe kërkoj që brenda afatit sa më të shkurtër të ndërmerren masa dhe aktivitete përkatëse për realizimin e të drejtave ligjore të parashtruesit të parashtresës, në drejtim të krijimit të kushteve për dorëzim faktik të banesës në zotërim të tij.

Duke vepruar sipas rekomandimit të dërguar, Ndërmarrja Publike për Ekonomizim me Lokale Banimi dhe Afariste e Republikës së Maqedonisë – Njësia rajonale në Shtip, e informoi Avokatin e Popullit se banesa në fjalë është dorëzuar në zotërim të drejtpërdrejtë të parashtruesit.

## Mbrojtja dhe sigurimi social

### AP nr. 1032/04

Parashtruesi i parashtresës R. J. disa herë, që nga viti 2002 është drejtuar me kërkesë për realizimin e të drejtës për kompensim në para për ndihmë dhe përkujdesje nga person tjetër pranë Qendrës ndërkomunale për punë sociale – Tetovë, por sipas kërkesës nuk është vepruar.

Avokati i Popullit intervenoi disa herë, fillimisht pranë Qendrës për punë sociale e pastaj edhe pranë komisioneve kompetente për vlerësimin e aftësisë së punës, me qëllim të vendimmarrjes më të shpejtë sipas kërkesës së qytetarit, duke e potencuar faktin se bëhet fjalë për person më të vjetër se 80 vjeç, i cili sipas

vlerësimeve të mjekut amë dhe mjekut specialist, ka nevojë për ndihmë dhe përkujdesje nga person tjetër.

Duke e pasur parasysh se parashtruesi i parashtrësës disa vjet kërkonte realizimin e kompensimit dhe përkujdesjes nga person tjetër, por për shkak të moskoordinimit të organeve kompetente dhe kryerjes së kontrollit jo me kohë të Komisionit për vlerësimin e aftësisë së punës, nuk mundi ta realizonte të drejtën. Avokati i Popullit konsideroi se organet kompetente pa arsye e zvarrisin procedurën për vendimmarrje sipas kërkesës së tij. Prandaj Avokati i Popullit intervenoi pranë organeve kompetente që ato menjëherë të veprojnë sipas kërkesës së parashtruesit, Komisioni për vlerësimin e aftësisë për punë menjëherë të bëjë inspektimin edhe të jep rezultatin dhe mendimin, ndërsa Qendra për punë sociale, pa zvarritje, në bazë të rezulttit të Komisionit të merr aktvendim përkatës.

Duke vepruar sipas këtyre kërkesave dhe ndërhyrjeve, Qendra për punë sociale, pas rezulttit të marrë nga komisioni kompetent, mori aktvendimin me të cilin ia njohu të drejtën për kompensim në para për ndihmë dhe përkujdesje nga person tjetër edhe atë në mënyrë retroaktive për disa vjet, në fakt që nga dita e parashtrimit të kërkesës.

## Sigurimi pensional dhe invalidior

### AP nr. 2102/05

Qytetari R. D. nga Shkupi paraqiti parashtrësë pranë Avokatit të Popullit, në të cilën theksoi se i janë cenuar të drejtat nga sigurimi pensional dhe invalidor sepse organet kompetente nuk i kanë mundur ta realizojë të drejtën e kompensimit për dëmtim fizik për çka është detyruar të hap edhe kontest administrativ, i cili ka përfunduar me aktgjykimin e Gjykatës Supreme, me të cilin kërkesëpadia e tij është marrë në konsideratë.

Pas shqyrtimit të të dhënave të përmendura dhe dokumentacionit të bashkangjitur, Avokati i Popullit konstatoi se janë cenuar të drejtat e parashtruesit të parashtrësës, prandaj dhe pranë organit të shkallës së dytë dërgoi sugjerim që menjëherë të ndërmerren masa përkatëse në drejtim të marrjes së aktvendimit ligjor duke i respektuar në mënyrë konsekuente udhëzimet e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë.

Gjatë rrjedhës së mëtutjeshme të procedurës, sipas urgjencës së dërguar deri te organi i shkallës së dytë, u mor aktvendimi, me të cilin parashtruesi i parashtrësës e realizoi të drejtën e kompensimit në para për dëmtim fizik.

## Mbrojtja shëndetësore

### AP nr. 470/05

Pranë Avokatit të Popullit u paraqitë parashtrësë nga qytetari A. P. nga Strumica, në të cilën u vu në dukje cenimi i të drejtave të sigurimit shëndetësor nga ana e Fondit për Sigurim Shëndetësor i Republikës së Maqedonisë, për shkak të moslëshimit të kartonëve të kaltër.

Pas shqyrtimit të të dhënave të prezantuara në parashtrësë dhe dokumentacionit të bashkangjitur, Avokati i Popullit vlerësoi se janë cenuar të drejtat e parashtruesit të parashtrësës nga ana e Fondit për Sigurim Shëndetësor të Maqedonisë, i cili nuk i ka dhënë kartonë të kaltër për shkak të borxhit të pashlyer me kohë nga ana e punëdhënësit, prandaj dhe dërgoi rekomandim me të cilin nga Fondi kërkoi që ta paraqesë si të siguruar mbi bazë të re dhe t'i lëshojë kartonë të kaltër, ndërsa për periudhën paraprake të përmendur të ngarkohet për t'i paguar kontributet. Në të kundërtën, në qoftë se nuk ka gatishmëri për arkëtim vullnetar për pagimin e tyre, të hapet procedurë e paraparë me ligj.

Fondi e informoi Avokatin e Popullit se pas sugjerimit të tij është vepruar, përkatësisht parashtruesi i parashtrësës e ka siguruar të drejtën e sigurimit shëndetësorë.

### AP nr. 363/05

G. A. K. nga Shkupi, në parashtrësën e tij theksoi se gjatë procedurës për njohjen e kompensimit për pagë gjatë kohës së pengimit për punë, për shkak të shtatzënësisë, lindjes apo lehonisë, pranë Fondit për Sigurim Shëndetësor i janë cenuar të drejtat kushtetuese dhe ligjore me mospagesë të plotë të kompensimit në para të pagës, gjatë kohës që ka qenë e penguar të punojë.

Avokati i Popullit konstatoi se parashtrësja ka bazë dhe në sugjerimin që ia dërgoi Fondit potencoi se nuk ekzistojnë pengesa ligjore, që kërkesa e parashtrueses të plotësohet dhe kërkoi që me aktvendim ligjor t'i mundësohet ta fitojë kompensimin, i cili korrespondon me pagat e saj. Fondi për Sigurim Shëndetësor, Shërbimi rajonal – Shkup sërish mori aktvendim negativ.

Gjatë rrjedhës së mëtutjeshme të procedurës, Avokati i Popullit intervenoi disa herë deri te ministri i Shëndetësisë duke ia bërë me dije se janë përmbushur të gjitha parashikimet ligjore për marrjen e aktvendimit ligjor, me të cilin parashtruesja do ta realizonte të drejtën e kompensimit përkatës.

Sugjerimi i Avokatit të Popullit u respektua në tërësi me miratimin e aktit, me të cilin parashtruesja e parashtrësës e fitoi kompensimin e kërkuar për kohën e pengimit nga puna për shkak të shtatzënësisë, lindjes dhe lehonisë.

## Të drejtat e fëmijës

### AP nr. 665/05

Parashtruesi i parashtresës S. A., kërkoi mbrojtje të të drejtave të fëmijës së tij të mitur, gjatë procedurës për rregullimin e kontakteve personale ndërmjet fëmijës dhe nënës, me të cilën nuk jetonte fëmija, përkatësisht kërkoi ndërhyrje nga Avokati i Popullit për shkak se gjatë marrjes së aktvendimit, nga ana e Qendrës për punë sociale, nuk është marrë parasysh mendimi dhe qëndrimi i fëmijës në lidhje me realizimin e të drejtës së tij për mbajtje të kontakteve personale me nënën e vet. Duke vlerësuar se të drejtat e fëmijës janë cenuar, i cili sipas moshës dhe pjekurisë ka qenë i aftë që ta shprehë mendimin e vet, Avokati i Popullit organeve kompetente ju sugjeroi se në përputhje me Konventën për të drejtat e fëmijës dhe Ligjit për familjen, gjatë rregullimit të mënyrës së realizimit të kontakteve personale, ndërmjet fëmijës dhe nënës, duhet të merret parasysh mendimi dhe qëndrimi i fëmijës dhe detyrimisht mendimit të tij duhet t'i kushtohet rëndësi, duke mbajtur llogari për interesat më të mira të fëmijës.

Duke vepruar sipas sugjerimeve të Avokatit të Popullit, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, pranë së cilën ishte paraqitur ankesa, e anuloi aktvendimin e Qendrës ndërkomunale për punë sociale dhe lëndën e ktheu në rishqyrtim dhe vendimarrje.

## Arsimi

### AP nr. 1173/05

Parashtruesi i parashtresës M. K. kërkoi mbrojtje të të drejtave për shkak të moszbatimit të vendimit gjyqësor, me të cilin Fakulteti në të cilin studion ngarkohet t'ia kthejë shumën në emër të participimit me kamatë ligjore dhe t'ia kompensojë shpenzimet për studime. Njëkohësisht, kundër parashtruesit të parashtresës ishte hapur procedurë disiplinore, pas së cilës i ishte kumtuar masa disiplinore, me të cilën e kishte humbur statusin e studentit për vitin shkollor, në të cilin i ishte kumtuar masa.

Avokati i Popullit duke vënë në dukje pacenueshmërinë dhe detyrimin e vendimeve gjyqësore, nga Fakulteti kërkoi që ta zbatojë vendimin gjyqësor dhe ta rishqyrtojë vlefshmërinë e masës së shqiptuar disiplinore, sepse bëhej fjalë vetëm për vitin shkollor kur ajo është shqiptuar.

Në kontekst të kësaj, Avokati i Popullit, i sugjeroi Fakultetit se masa disiplinore ka përfunduar, duke pasur parasysh se ka filluar viti i ri shkollor dhe nga dekani kërkoi që të vendosë që parashtruesi i parashtresës sërish ta fitojë statusin e studentit.

Sugjerimet e Avokatit të Popullit u pranuan dhe u mor aktvendim për fitimin e serishëm të statusit student dhe njëkohësisht mjetet iu paguan në përputhje me vendimin gjyqësor.

## Të drejtat e konsumatorëve

### AP nr. 1668/05

Qytetari V. S. nga Strumica iu drejtua Avokatit të Popullit me kërkesë që t'i mbrohet e drejta, për të cilën konsideronte se i është cenuar nga ana e "Elektrodistribucionit" - Strumicë.

Nga parashtruesi dhe provat e bashkangjitura, rezultoi se parashtruesi ka fituar të drejtën e pronës për banesë, në përputhje me marrëveshjen përkatëse për shitblerje dhe për këtë shkak është drejtuar pranë Filialit të "Elektrodistribucionit" – Strumicë me kërkesë që të evidentohet si shfrytëzues i energjisë elektrike për banesën në fjalë, por, atij i kanë thënë se për shkak të faturave të pashlyera, për periudhën kohore derisa banesa nuk ka qenë në zotërim të tij, përkatësisht pronë e tij, sahatët dhe faturat edhe më tej do jenë të evidentuara me emrin e shfrytëzuesit të mëparshëm.

Gjithashtu, parashtruesi detyrohet që t'i paguajë të gjitha faturat e pashlyera për periudhën kur nuk ka qenë pronar.

Avokati i Popullit, në përputhje me Ligjin për marrëdhënie të obligacionit, dërgoi rekomandim pranë Filialit në Strumicë me kërkesë që brenda afatit sa më të shkurtër, parashtruesit t'i mundësohet shfrytëzim papengesë i shërbimeve, përkatësisht të evidentohet si shfrytëzues dhe të mos obligohet me borxhin kontestues.

Rekomandimi u përkrah.

## Financat dhe puna financiare

### AP nr. 426/05

Qytetari V. I. nga Shkupi parashtrroi parashtruesë, në të cilën përmendi se në cilësi të blerësit me SHA "Promet Tutun" – Shkup ka lidhur Kontratë për shitblerje të pronës së patundshme – lokal afarist në Kumanovë. Njëherit parashtruesi ka përmendur se edhe përkundër faktit se e ka paguar tatimin në fitim të patundshmërisë, Ministria e Financave – Drejtoria për të Hyra Publike – Drejtoria rajonale – Shtip, Seksioni tatimor, nuk ia vërteton marrëveshjen dhe kjo është arsyeja që parashtruesi konsideron se i janë cenuar të drejtat kushtetuese dhe ligjore.

Pas analizimit të të dhënave të paraqitura në parashtruesë dhe provat e bashkangjitura materiale, Avokati i Popullit, në përputhje me autorizimet e nenit 24, paragrafit 1, alinesë 3 të

Ligjit për Avokatin e Popullit, realizoi takim me udhëheqësin e Seksionit tatimor në Kumanovë, me ç'rast konstatoi se parashtruesit të parashtrësës nuk i vërtetohet marrëveshja e shitblerjes sepse SHA "Promet Tutun" –Shkup ka detyrime të pashlyera mbi baza të ndyshme (TVSH, tatimin personal dhe tatime të tjera) dhe se në të vërtetë kjo rezulton nga Konkluzioni i Drejtorisë për të Hyra Publike, i miratuar në muajin nëntor të vitit 2004, me të cilin nuk lejohet vërtetimi i marrëveshjes për shitblerje, përderisa blerësi apo shitësi, nuk i shlyen të gjitha detyrimet ndaj Drejtorisë të të Hyrave Publike.

Avokati i Popullit, në përputhje me autorizimet e tij, drejtoi rekomandim deri te Drejtoria e të Hyrave Publike, që ajo ta vërtetojë marrëveshjen e shitblerjes, me qëllim që qytetari ta sigurojë të drejtën e bartjes së pronësisë së patundshme në kadastër dhe libra të tjerë publik.

Gjatë rrjedhës së mëtutjeshme të procedurës, Avokati i Popullit konstatoi se është vepruar sipas rekomandimit.

## Fusha të tjera

### **AP nr. 224/05**

Pranë Avokatit të Popullit parashtrësë parashtroi personi S. I. nga fshati Pirok i Tetovës, në të cilën potencoi se nga ana e Minsitrisë për Punë të Brendshme – Seksioni për krime të organizuara – Tetovë, i janë cenar të drejtat kushtetuese dhe ligjore, sepse nuk ka dërguar mendim pranë Ministrisë së Financave – Shkup se nga aspekti i sigurisë, a ekzistojnë pengesa për kryerje të veprimtarisë për organizimin e lojërave të fatit dhe lojërave argëtuese në objektin "Gold Klub", që gjendet në rrugën "Todor Cipovski – Merxhan" p.n. në Tetovë.

Avokati i Popullit, në përputhje me autorizimet, vuri në dukje nevojën për veprim në kontekst të kësaj që u tha më lartë, përkatësisht sugjeroi që Ministria për Punë të Brendshme – Seksioni për krime të organizuara deri te Ministria e Financave në Shkup, të dërgojë mendim, i cili në përputhje me Ligjin për lojëra të fatit dhe lojëra argëtuese paraqet kusht që organi kompetent, qytetarit të përmendur t'i lëshojnë licencë për organizimin e lojërave të fatit dhe lojërave argëtuese, gjë e cila disa herë nga ana e Ministrisë së Financave – Seksionit për lojëra të fatit dhe lojërave zbavitëse është kërkuar me shkresë.

Gjatë rrjedhës së mëtutjeshme të procedurës, Avokati i Popullit ka konstatuar se Ministria për Punë të Brendshme ka vepruar sipas sugjerimit të Avokatit të Popullit.

# NË INSTITUCION

## Organizimi dhe mënyra e punës

Organizimi i punës së Avokatit të Popullit, bashkërenditet me kompetencat e përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë dhe Ligjin për Avokatin e Popullit. Në funksion të sigurimit të sistematizimit të punës dhe në drejtim të realizimit të detyrave të programuara, Avokati e Popullit fushëveprimin e punës e zhvillon përmes njësive organizative në selinë e Institucionit në Shkup dhe përmes zyrave rajonale në: Manastir, Kërçovë, Kumanovë, Strumicë, Tetovë dhe Shtip.

## Ekipimi kadrovik

Gjatë gjysmës së parë të vitit 2005, Avokati i Popullit, funksiononte me gjithsej 45 kryerës të Shërbimit profesionistë, me bartësin e funksionit Avokat i Popullit dhe katër zëvendësit e tij në selinë e Institucionit. Gjatë gjysmës së dytë të vitit 2005, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, zgjodhi katër zëvendës Avokat të Popullit për zyrat rajonale në: Manastir, Kërçovë, Kumanovë, Strumicë, Tetovë dhe Shtip.

Kah fundi i vitit 2005, pjesërisht u rrumbullakësua ekipimi kadrovik i Shërbimit profesionistë, me punësimin e 12 kryerësve, kështu që nga fundi i periudhës për të cilën raportojmë, Institucioni fushëveprimin e punëve e realizon me 10 zëvendës të Avokatit të Popullit dhe 57 kryerës të Shërbimit profesionistë.

Sipas kualifikimit, struktura e punonjësve është: 49 me arsim të lartë, 18 me përgatitje të mesme profesioniste dhe një me shkollë filllore. Nga ky numër, 42 janë femra ndërsa 26 janë meshkuj.

Në Shërbimin profesionistë ka 30 maqedonas, 20 shqiptarë, nga dy serb, romë, vllleh dhe një pjesëtar i bashkësisë turke.


## Mjetet e punës

Mjetet e punës së Avokatit të Popullit sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë. Në vitin 2005, Avokati i Popullit aktivitetet e programuara, në përputhje me rregullat pozitive, i realizoi me 17.972.00,00 denarë, e që nuk ishin të mjaftueshme për funksionimin e suksesshëm të Institucionit.

Për shkak të mungesës së mjeteve financiare, nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë për përfundimin e pjeshëm të detyrave programore, dukshëm ndihmuan donacionet nga Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim – Misioni në Shkup (OSBE) dhe Instituti Shoqëria e Hapur në Republikën e Maqedonisë – SOROS.

Sikurse edhe në vitet e kaluara, edhe një herë mund të konstatohet se mënyra e këtillë e financimit nuk është adekuate me pozicionin dhe kompetencat e Avokatit të Popullit në sistemin kushtetues – ligjor të Republikës së Maqedonisë, sepse varësia nga pushteti ekzekutiv, në kuptimin e mjeteve financiare, e zvogëlon autonominë dhe pavarësinë dhe paraqet pengesë për realizimin e funksionit.

Për këtë arsye, nevojitet zgjidhje e kësaj çështje me inkorporimin e një sistemi bashkëkohor, transparent dhe të pavarur të financimit të Avokatit të Popullit.



\* Katër zëvendës në zyrën në Shkup dhe nga një zëvendës nëpër zyrat rajonale në: Manastir, Kërçovë, Kumanovë, Strumicë, Tetovë dhe Shtip